



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 QERSHOR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 30.05.2019 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Mocioni me debat, i kërkuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, “Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” *(nenet 48, 98 dhe 99 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Paraqitja e mocionit nga kërkuesi

Debati i përgjithshëm *(sipas kohës së caktuar në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve)*

Votimi i projektrezolutës

Gramoz Ruçi – Të nderuar kolegë deputetë, uluni!

Të futet media brenda!

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Lidhur me procesverbalin, a ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Nga Këshilli i Ministrave janë depozituar 5 projektligje.

Një projektligj është depozituar nga deputetë.

Nga deputeti Lefter Maliqi është depozituar një kërkesë për interpelancë me Kryeministrin e Shqipërisë, zotin Edi Rama.

Nga Presidenti i Republikës është depozituar dekreti për rishqyrtimin e ligjit “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

Materialet, si gjithnjë, do t’i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është depozituar në Kuvend vendimi nr. 730/2019 “Për dhënien e mandatit të deputetit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integritet, qarku Tiranë, zotit Ramazan Gjuzi”.

Ju njoftoj se ditën e hënë është mbledhur Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të verifikuar mandatin e deputetit të shpallur i zgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, zoti Ramazan Gjuzi, nga subjekti politik LSI, qarku Tiranë.

Raportin e keni të gjithë para, a ka nevojë të lexohet? Nuk ka nevojë.

Kush është dakord me raportin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin? Ju lutem, votoni me kartonë!

Miratohet.

Në mbështetje të nenit 4, pika 3, të Rregullores unë do të lexoj tekstin e betimit, ndërsa zotëria, do të ngrihet në këmbë dhe do të deklarojë: “Betohe!”.

Teksti i betimit është: “Betohe me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të punoj me

të gjitha fuqitë e mia për përparimin e Atdheut dhe mirëqenien e popullit tim.”

Zoti Ramazan Gjuzi.

Ramazan Gjuzi – Betohe!

Gramoz Ruçi – Urime!

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit mocion me debat, i kërkuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, “Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.

Ashtu siç ju thashë, kryetari i Grupit të Parlamentar Partisë Socialiste, zoti Balla, në mbështetje të nenit 98 të Rregullores, ka kërkuar mocion me debat “Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” dhe e ka shoqëruar këtë me një rezolutë.

Në mbështetje të nenit 98, pika 2, duke pasur parasysh detyrimet e Kryetarit të Kuvendit, është mbledhur Konferenca e Kryetarëve brenda afrit 3-ditor të përcaktuar në Rregullore për të caktuar datën e zhvillimit të mocionit në seancë plenare, si edhe ndarjen e kohës për debat.

Konferenca me unanimitet ra dakord për zhvillimin e mocionit në seancën e sotme, datë 13.06.2019, dhe rendi i ditës së kësaj date, i përcaktuar sipas kalendarit 3-javor, të shtyhet për datën 17.06.2019, ora 10:00, ditën e hënë.

Në lidhje me kohën e zhvillimit të debatit, Konferenca, në mbështetje të nenit 48 të Rregullores, ra dakord që koha totale të jetë 300 minuta, nga këto 170 minuta maxhoranca, 130 minuta opozita, prej të cilave 50 minuta Grupi Demokrat, 50 minuta Grupi i Pavarur dhe 30 minuta deputetët jashtë grupeve parlamentare.

Para se të hap debatin, fjalën e ka kërkuari për mocion dhe propozuesi i rezolutës, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zoti Taulant Balla.

Taulant Balla – Zonja dhe zotërinj deputetë,

Anëtarë të Këshillit Ministrave,

Pasi u njohëm me aktin e paprecedent të Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” dhe, duke e vlerësuar këtë akt si absolutisht të pavlefshëm, i marrë në

kapërcim të kompetencave të institucionit të Presidentit dhe në kundërshtim flagrant me parimet kushtetuese dhe demokratike, si dhe duke e konsideruar këtë akt, që synon të pengojë në mënyrë të kundërligjshme realizimin e të drejtës kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur me votën e tyre përfaqësuesit në pushtetin vendor, bazuar në nenin 98 të Rregullores së Kuvendit, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, kam kërkuar këtë mocion, që, në fakt, për thelbin është hera e parë që mbahet në 28 vjet të demokracisë së re shqiptare, në përfundim të të cilit ju kërkoj të gjithëve, pa asnjë dallim dhe pa asnjë ndryshim të krahëve politikë që kemi dhe të partive nga të cilat vijmë, të miratojmë së bashku një rezolutë sipas draftit që keni përpara.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Dekreti i datës 10 qershor është haptazi antikushtetues. Zgjedhjet do të mbahen me 30 qershor. Kompetencat për caktimin e datës së zgjedhjeve, po ashtu edhe mungesat e kompetencës për zhdekretim dua t'i sqaroj si më poshtë:

Në raport me zgjedhjet, Presidenti i Republikës ka vetëm një kompetencë, atë të caktimit të datës së zgjedhjeve. Kjo për të ruajtur neutralitetin dhe për të mos e komprometuar më politikën e ditës, me grindjet apo debatet zgjedhore, me konkurrencën zgjedhore, me akuzat reciproke, me rezultatin zgjedhor apo kontestimin e tij. Presidentin, për fat të mirë, e kemi çliruar me ligj nga çdo përfshirje në procesin zgjedhor. Rreth 10 vjet më parë, ai kishte të drejtën e emërimit të një pjese të anëtarëve të KQZ-së, ndërsa sot nuk e ka. Që nga viti 2008 ai nuk e gëzon më këtë prerogativë, sepse i gjithë procesi zgjedhor qeveriset tërësisht vetëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që në Shqipëri është "Qeveria e zgjedhjeve". Caktimi i datës së zgjedhjeve është kompetencë e Presidentit, por jo privilegj i tij. E thënë ndryshe, është detyrim, por jo e drejtë. Kjo kompetencë nuk është diskrecionale dhe nuk varet nga vullneti i tij, por është e lidhur me kushte rigoroze ligjore.

Presidenti nuk mund dhe nuk e zgjedh dot periudhën zgjedhore, brenda së cilës të caktojë datën e zgjedhjeve. Periudha zgjedhore është përcaktuar me ligj dhe varet vetëm nga data e përfundimit të mandatit të organeve të zgjedhura

në detyrë. Brenda periudhës zgjedhore, Presidenti i Republikës mund të përzgjedhë vetëm dy të diela të njëpasnjëshme, më të afërtat me datën e përfundimit të mandatit, për t'i konsideruar si data të mundshme për zhvillimin e zgjedhjeve. Identifikimin e datës më të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve Presidenti i Republikës është i detyruar ta bëjë në konsultë me partitë parlamentare. Procedura kushtetuese, në fakt, e normuar me zakon kushtetues, pasi nuk është e shkruar në Kushtetutë, parashikon konsultën me kryetarët e grupeve parlamentare. Si rregull, caktimi i datës së zgjedhjeve është rezultat i një procesi konsensual, por, nëse grupet parlamentare nuk shfaqin konsensus, atëherë caktimi i datës së zgjedhjeve bëhet duke respektuar në mënyrë të paanshme vendimin e Presidentit të Republikës, i cili ka detyrën që të gjejë midis palëve peshën e argumentit të përfaqësuar prej tyre. Kjo është pjesa e normuar nga zakoni kushtetues.

Meqenëse ka ardhur koha që të zbardhen të gjitha bisedat, që zhvillohen me Presidentin e Republikës, dua t'ju informoj se para 8 muajsh kryetari i shtetit, Presidenti i Republikës, e ka kryer këtë procedurë. Dua t'ju them në mënyrë të sigurtë se unë, si kryetar i grupit, kam propozuar datën 9 qershor, por Presidenti i Republikës me të drejtë tha: "Janë vetëm dy data, ose data 23, ose 30 qershor". Data 9 ishte brenda kuadrit të sezonit turistik dhe arsyetimi im ishte që zgjedhjet të mos ndiknin aspak në sezonin turistik, si një kërkesë e shumicës së kompanive turistike, që operojnë në Shqipëri, por Presidenti i Republikës më bindi. Unë u binda që data 30 qershor, si datë e propozuar edhe nga grupet parlamentare të opozitës, ishte e vetmja datë dhe data e fundit e zhvillimit të zgjedhjeve vendore, sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Kriteret, që vendosin për datën e zgjedhjeve, nuk mund të jenë kritere, të cilat bazohen në interesa politike. Ato mund të ndikohen nga interesat e konkurruesve, por janë kritere që lidhen me interesin më të mirë të zgjedhësve shqiptarë. Data e zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës, duke i dhënë përgjigje pyetjes se cila është data më e mirë për zgjedhësit për votime. Sqarimi i kuadrit kushtetues për kompetencën e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve ka rëndësi për të kuptuar se sa shumë e kanë kufizuar Kushtetuta

dhe ligji Presidentin në ushtrimin e kësaj kompetence, e cila, për nga natyra e saj, hyn në grupin e kompetencave formale të Presidentit të Republikës.

Neni 92, germa “gj”, i Kushtetutës i njeh Presidentit të Republikës kompetencën për dekretimin e datës së zgjedhjeve, por kjo nuk përkthehet dot në kompetencë për zhdekretim. Dekretimi i datës së zgjedhjeve është një akt me efekt të menjëhershëm. Ngjarja ndodh dhe kryhet, ajo nuk zgjat, nuk vazhdon dhe nuk është proces. Dekretimi nuk është hapi i parë i vendimmarrjes së Presidentit, por është edhe hapi i parë dhe i fundit i saj. Menjëherë me dekretimin fillojnë efektet ligjore të aktit. Dekretimi i hap rrugën procesit, mekanizmat ligjorë dhe administrativë vihen në lëvizje në mënyrë të pavarur dhe pa asnjë detyrim ligjor dhe administrativ ndaj dekretuesit. Neni 92, germa “gj”, i Kushtetutës nuk mund të shërbejë si kompetencë për zhdekretimin e zgjedhjeve, sepse për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor kjo kompetence është ushtruar një herë.

Presidenti i Republikës e ka këtë kompetencë vetëm një herë, dhe ai e ka ezauruar këtë kompetencë.

Kompetenca e ushtruar i ka ezauruar efektet e veta që ditën kur dekreti ka hyrë në fuqi. Pasojat juridike të parashikuara dhe, që priteshin prej tij, kanë ndodhur pothuajse në pjesën dërrmuese.

Deri më datën 10 qershor, datën e dekretimit, janë konsumuar të gjitha procedurat për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, procedurat për ndarjen e financimit publik, për ndarjen e kohës televizive, për ngritjen e administratës zgjedhore, për hartimin dhe publikimin e listave të zgjedhësve, për infrastrukturën monitoruese e vëzhguese të zgjedhjeve, për përgatitjen e bazës materiale të zgjedhjeve. Janë miratuar fletët e votimit dhe është kontraktuar shtypshkrimi i tyre.

Pra, procesi është në fazën e fundit, në raundin e fundit, në ditën kur zgjedhësve duhet t’u respektohet e drejta për të zgjedhur, e drejtë e mbrojtur me Kushtetutë.

Të gjitha këto hapa, i gjithë ky mobilizim burimesh, më së shumti edhe financiar, e gjithë kjo kosto e madhe që ka lidhje procedurale me dekretin e përcaktimit të datës së zgjedhjeve, nuk mund të zhbëhen me zhdekretim.

Presidenti i Republikës referohet në disa precedent. Sipas tij, në disa raste të mëparshme janë shtyrë zgjedhjet nga një javë deri në një muaj, duke lënë mënjanë faktin se kuadri ligjor ka qenë i ndryshëm në precedentë të ndryshëm, gjë e cila përjashton listimin e tyre si precedentë.

Nuk mund të marrësh si precedent një rast, kur kuadri ligjor është tërësisht i ndryshëm nga kuadri ligjor që i referohet. Të gjitha rastet e tjera, qoftë ai i vitit 2007 apo ai i vitit 2017, jo vetëm që kanë qenë brenda kuadrit të përcaktuar. Në rastin e vitit 2007, kam qenë edhe asokohe anëtar i Kuvendit të Shqipërisë, dispozitën kalimtare për t’i mundësuar Presidentit të Republikës, zotit Moisiu, për të ridekretuar një datë të re për zgjedhjet vendore, e kemi votuar afër mesnatës së datës 30 dhjetor 2006. Kuvendi qëndroi i mbledhur derisa konsensusi politik dhe marrëveshja politike të firmosej në Presidencë. Vetëm pasi Kuvendi kishte miratuar dispozitën kalimtare, Presidenti mund të dekretonte një datë të re zgjedhjesh.

Në të gjithë precedentët, fakti juridik, pra konsensusi politik i ka paraprirë dekretit. Në rastin e zhdekretimit ka ndodhur e kundërta. Sipas Presidentit, zgjedhjet janë anuluar me synimin që bllokimi i procesit t’i ulë palët në dialog, me shpresën se dialogu do të prodhojë konsensus. Domethënë, nuk është ngjarja që sjell aktin, por është akti ai që kërkon të prodhojë ngjarjen.

Në analizë juridike, natyra, shkaku ligjor, nisma apo efektet, dekreti për shtyrjen e zgjedhjeve, janë të krahasueshme jo me dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve, po me dekretin për përsëritjen e zgjedhjeve, ndërkohë që dekreti i datës 10 qershor nuk ka asnjë lidhje as me dekretin për shtyrjen e zgjedhjeve, as me dekretin për përsëritjen e tyre.

Në të gjitha rastet e tjera të dekretimeve, që Presidenti i Republikës i citon si precedentë, nuk është vënë në lëvizje me kërkesë të palëve të treta, asnjëherë kryesisht.

Më tej, shtyrja e zgjedhjeve dhe përsëritja janë mekanizma ligjorë, që shpëtojnë nga pamundësia për të prodhuar rezultat, ndërsa dekreti i datës 10 qershor bllokoi mundësinë për të prodhuar rezultat. Tek shtyrja dhe përsëritja shkaku lidhet gjithmonë me një pengesë apo nevojë ligjore, asnjëherë me një pengesë apo nevojë politike.

Më shtyrjen dhe përsëritjen, zgjedhjet zhvillohen në një datë tjetër, brenda limitit të caktuar nga Kushtetuta ose nga ligji, kurse dekreti i datës 10 qershor thyen çdo limit, qoftë ligjor, qoftë kushtetues.

Sqarimi *modus operandi* i Presidentit dhe krahasimi me precedentët kanë rëndësi jo vetëm për të zbuluar abuzimin me referencën të precedentit, por edhe për të qartësuar kapërcimin e rëndë të parimit të neutralitetit, që është parim bazë i funksionimit dhe veprimtarisë së Presidentit të Republikës.

Zonja e zotërinj deputetë,

Kjo ishte pjesa që lidhej me afatet dhe me antikushtetutshmërinë e të ashtuquajturit zhdekret.

Cilat janë pasojat antikushtetuese të zhdekretimit të datës së zgjedhjeve? Në tentativën për anulimin e zhvillimit të zgjedhjeve, Presidenti i Republikës ka cenuar të drejtën themelore të shtetasve për të zgjedhur, gjithashtu, edhe për t'u zgjedhur, atë të drejtë që rreket të argumentojë se është motivi i tij për anulim.

Pra, motivi i Presidentit për anulim na qenka: t'u heqim të drejtën për t'u zgjedhur, sikundër u heqim të drejtën edhe për të zgjedhur.

E drejta aktive dhe pasive e zgjedhjeve është e drejtë individuale dhe aspak kolektive. Ajo u përket individëve, jo partive, ashtu sikundër dorëheqjet nga mandatet e deputetëve ishin dhe duhej të mbaheshin si dorëheqje individuale, jo si dorëheqje kolektive. Ajo u përket individëve, jo partive. Kjo e drejtë cenohet kur shtetasve u hiqet mundësia për ta ushtruar atë, dhe jo ku për arsye, që nuk lidhen me rendin kushtetues, por me interesat politikë të palëve, oferta e zgjedhjeve reduktohet prej të ashtuquajturave standarde të Presidentit. Këtë të drejtë e shkel kush nuk lejon zhvillimin e zgjedhjeve, jo kush kërkon që ato të zhvillohen sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Më tej, në arsyetimin e dekretit të datës 10 qershor, Presidenti i Republikës thekson se mospjesëmarrja në zgjedhje e disa partive opozitare është, sipas tij, *de facto* mohim i së drejtës për t'u zgjedhur. Mospjesëmarrja në garë ditën e caktuar për zhvillimin e garës, është zgjedhja e lojtarëve, të cilët kanë vendosur të bojkotojnë, por që në asnjë rast nuk u është mohuar e drejta për të garuar.

Në këtë proces zgjedhor, të gjithë individët, që deshën të regjistroheshin, u regjistruan si kandidatë partish, si kandidatë koalicionesh apo si kandidatë të pavarur. Nëse ky numër nuk ishte shumë i madh, pavarësisht se me 38 parti politike radhitemi ndër vendet, që kanë më shumë parti garuese në procese zgjedhore, kjo erdhi për shkak të presionit, pasigurisë dhe frikës që mbolli opozita bojkotuese në periudhën e regjistrimit.

Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë bërë presion ndaj subjekteve të ndryshme zgjedhore, prej të cilëve ka edhe këtu në sallë, për të mos u regjistruar në zgjedhje.

Presidenti i Republikës e di fare mirë se ky akt është në vetvete një akt i paligjshëm, që Kodi Penal, me të gjitha normat e veta, e ka sanksionuar si pengim i të drejtës së një subjekti zgjedhor për të marrë pjesë apo për të bërë fushatë zgjedhore, një akt i dënueshëm dhe vepër penale, e cila dënohet deri në pesë vjet burg.

Zhdekretimi i datës së zgjedhjeve ka nxjerrë jashtë afatit kushtetues mandatin e organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore, domethënë shkel paragrafin 1 të nenit 109 të Kushtetutës: "Organet e qeverisjes vendore në largim nuk mund të ushtrojnë tagër pushteti pas përfundimit të mandatit të tyre si organe të zgjedhura." Me mbarimin e mandatit katërvjeçar në Shqipëri, nuk mund të ketë më as kryetarë e as këshilla bashkie. Prandaj, dekreti ka pasojë të drejtpërdrejtë të tij edhe shkeljen e pikës 3 të nenit 1 të Kushtetutës: "Qeveri ose qeverisje pa zgjedhje nuk mund të ketë". Po ashtu, edhe pikat 1 e 2 të nenit 2 të Kushtetutës: "Parimi i sovranitetit popullor dhe parimi i përfaqësimit."

Dekreti bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor në tërësinë e tij, për shkak se synon zhbërjen pa shkak ligjor të procesit zgjedhor, i cili është konsumuar në 90 % të ecurisë së tij.

Dekreti nxirret nga Presidenti, por për zbatimin e tij ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është organi që ka kompetencën ekskluzive të drejtimit e të menaxhimit të zgjedhjeve në Shqipëri.

Nëse KQZ-ja do të pranonte të zbatonte dekretin, kjo do ta ngarkonte KQZ-në me përgjegjësi penale. "Zbatimi i një akti të paligjshëm është përgjegjësi penale" – thuhet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, akt i cili shtrihet nga pengimi i zgjedhësve për të

votuar e deri te shpërdorimi i detyrës. Do të ishte vepër penale nëse do të zbatohet një akt i paligjshëm, dhe jo e kundërta.

Përse dekreti i datës 10 qershor është absolutisht i pavlefshëm? Dekreti i datës 10 qershor, zonja e zotërinj deputetë, është një akt që nuk mund të nxirret, por, nëse nxirret, nuk mund të zbatohet, sepse është absolutisht i pavlefshëm, zoti President!

Pavlefshmëria absolute e akteve administrative rregullohet nga neni 108 e në vijim, i Kodit të Procedurës Administrative, i cili është akti i vetëm ligjor, që jo vetëm normon kualifikimin ligjor të pavlefshmërisë absolute, por edhe që përcakton kompetencën për konstatimin e saj dhe detyrimin e organeve publike për të vepruar kryesisht, sa here vihet në dijeni të shkaqeve për pavlefshmëri.

Që akti administrativ të jetë absolutisht i pavlefshëm, duhen të verifikohen disa rrethana, konkurrese me njëra-tjetrën, çdonjëra prej të cilave e bën aktin absolutisht të pavlefshëm. Në rastin e dekretit të datës 10 qershor, janë verifikuar më shumë se një prej tyre.

Kodi i Procedurës Administrative nuk lejon që akti administrativ të vijë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë-urdhëruese të legjislacionit në fuqi, lidhur me kompetencën e organit publik ose me procedurën për nxjerrjen e aktit, neni 108, shkronja 'a', pika 1 dhe pika 2.

Dekreti bie në kundërshtim të hapur dhe flagrant me nenin 92, shkronja 'gj', të Kushtetutës, si për kompetencën, ashtu edhe për procedurën. Domethënë, shkelja e kësaj shkronje të nenit, është bërë dy herë nga akti i Presidentit.

Kodi i Procedurës Administrative përcakton se akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm dhe në rastin kur ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal.

Dekreti i datës 10 qershor ngarkon për ekzekutimin e tij Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nëse KQZ-ja e zbaton atë, atëherë KQZ-ja shkel rëndë tërësinë e Kodit Zgjedhor dhe konsumon automatikisht atë që cituam më sipër, veprën penale.

Zonja e zotërinj, a e ka detyrim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për ta konstatuar pavlefshmërinë absolute? Ky është një diskutim, i cili patjetër do të jetë edhe pjesë e debatit në këtë seancë, por, në vlerësimin tim, organi

kompetent administrativ për të shqyrtuar mjetet ligjore administrative në fushën e zgjedhjeve, listat e zgjedhësve apo dokumentet e tjerë, është vetëm KQZ-ja. Neni 21, pika 17, i Kodit Zgjedhor.

Lënda e dekretit të datës 10 qershor, caktimi i datës së zgjedhjeve, është lëndë zgjedhore, prandaj në kompetencën lëndore të KQZ-së përfshihet edhe kompetenca për konstatimin e pavlefshmërisë.

Ndërsa neni 111 i Kodit të Procedurës Administrative sqaron se konstatimi i pavlefshmërisë absolute nuk është tagër, të cilin organi publik e ushtron në mënyrë diskrecionale.

Zonja e zotërinj deputetë,

Përpara jush, për herë të parë, keni një rezolutë, e cila synon më së miri që t'i japë përgjigje një akti të paprecedent, i cili është absolutisht i pavlefshëm.

Unë kam besim tek të gjithë deputetët e këtij Kuvendi, kam bindjen e thellë se Kuvendi i Shqipërisë është autoriteti më i lartë në një republikë parlamentare të pasur, si kjo e jona. Ndaj, dua t'ju bëj thirrje që, të gjithë së bashku, ta votojmë rezolutën, për të qartësuar këdo, por, pikë së pari, për të qartësuar çdo shtetas shqiptar, se e drejta e fituar me kaq mund, që çdo shqiptar, qoftë për zgjedhjet vendore, qoftë për zgjedhje të përgjithshme, një herë në katër vjet, pa asnjë ditë më shumë, të zgjedhë përfaqësuesit e vet, të jetë një e drejtë e garantuar. Zgjedhjet do të zhvillohen më 30 qershor.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Para se të hap debatin...

(Ndërhyrje nga salla)

Të lutem, prit! Shënoje emrin atje, dhe do të ta jap fjalën!

Para se të hap debatin, po bëj të qartë emrat e diskutantëve në lidhje me debatin. Nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste janë regjistruar deputetët: Klotilda Bushka 7 minuta, Erion Braçe 6 minuta, Bashkim Fino 6 minuta, Elisa Spiropali 5 minuta, Mimi Kodheli 5 minuta, Fatmir Xhafaj 8 minuta, Ulsi Manja 7 minuta, Blerina Gjylameti 5 minuta, Bledar Çuçi, Damian Gjikhuri, Ditmir Bushati, Blendi Klosi, Alket Hyseni, Eduard Shalsi, Ermonela Felaj, Arben Ahmetaj, Lindita Nikolla, Niko Peleshi, Senida Mesi, Etilda Gjonaj, Vasilika Hysi, Sandër Lleshaj, Pandeli Majko, Besa Shahini,

Belinda Balluku, të gjithë nga 5 minuta, dhe Edi Rama 35 minuta.

Nga Grupi Parlamentar opozitar, Demokrat janë regjistruar deputetët: Rudina Hajdari 14 minuta, Myslim Murrizi 16 minuta, Korab Lita 6 minuta, Halil Jakimi 8 minuta, Halit Valteri 6 minuta.

Nga Grupi i Pavarur janë regjistruar deputetët: Nimet Musaj 15 minuta, Ralf Gjoni 15 minuta, Enver Roshi 13 minuta.

Nga deputetët jashtë grupeve janë regjistruar deputetët: Andi Përmeti, Kujtim Gjuzi, Zef Shtjefni, Selami Janishi, Lefter Maliqi, Elda Hoti, Artur Roshi, Kostaq Papa, Ligoraq Karamelo, Ervis Meço, të gjithë nga 3 minuta.

Fjala për zotin Karamelo. Përse e keni fjalën?

Ligoraq Karamelo - Faleminderit, zoti Kryetar!

E di që ju karakterizoheni nga korrektësia dhe saktësia matematikore në respektimin e kohës, por unë gjykoj që, meqenëse ne deputetët, që nuk bëjmë pjesë në grupet parlamentare, jemi shumë dhe koha jonë për të folur është shumë e paktë, ndoshta do të ekzistonte mundësia që ju të tregoheni më tolerant për të shtuar kohën e diskutimit, të paktën 1 ose 2 minuta më tepër për të gjithë ne.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Koha nuk është kompetencë imja, por është kompetencë e Konferencës së Kryetarëve, është brenda Rregullores së Kuvendit. Thelbi nuk është sesa flet, por çfarë thua kur flet. Ne kemi kohën në dispozicion për të folur, qoftë edhe 3 minuta për të thënë gjënë e duhur në vendin e duhur.

Po, zoti Maliqi.

Lefter Maliqi – Në mbështetje të fjalës së deputetit Karamelo, nuk është parë ndonjëherë në historinë e parlamentit të flasësh 3 minuta, aq më tepër për një çështje të rëndësishme.

Sot dëgjuam edhe diskutimin e recituar nga sekretari i Përgjithshëm, zoti Balla, i cili kërkon me këtë akt, me këtë parodi, me këtë arrogancë të maxhorancës të marrë edhe institucionin e fundit atë të Presidentit, sepse së shpejti do të rrëzoni edhe kryetarin e KQZ-së.

Gramoz Ruçi - Ju lutem? Çfarë keni për të thënë për procedurë?

Lefter Maliqi – Zoti Balla na tregoi këtu Kodin Penal. Ndërkohë, kryetari i KQZ-së nuk zbatoi dekretin e Presidentit, a mos ka ndërmend ta fusë në burg? Këto janë turpe, skandale dhe sot shqiptarët do të shikojnë një parodi. Unë po pres të vijë Kryeministri dhe do të kem punë për procedurë edhe me të.

Gramoz Ruçi – Me Kryeministrin nuk ke punë procedure, Kryeministri ka debat me fakte e të tjera. Ju keni kërkuar interpelancë me Kryeministrin dhe do të keni të gjithë kohën e duhur për të dialoguar me të.

Ju lutem, kolegë deputetë, ju kërkoj vetëm një gjë. Ka parlamente, qoftë edhe Parlamenti Europian, ku çdo diskutant nuk flet më shumë se 5 minuta. Jo rastësisht isha në një aktivitet, ku merrnin pjesë të gjithë kryetarët e parlamenteve të BE-së, si dhe kryetarët e parlamenteve aspirantë për në BE dhe koha në dispozicion për diskutimet e tyre ishte vetëm 3 minuta. Prandaj, të mos e kthejmë çështjen e kohës në debat.

Fjalën e ka Rudina Hajdari. Të përgatitet zonja Bushka.

Rudina Hajdari - Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Këtu para nesh kemi një rezolutë, e cila nuk ka ndonjë vlerë juridike, por është thjesht një rezolutë, që për mendimin tonë, thjesht ngre presionin, shantazhin ndaj Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Dua ta filloj fjalën time me arsyetimin pse ky akt i Presidentit të Republikës është një akt, që ne thjesht mund ta konstatojmë si Kuvend i Shqipërisë, pasi gjykimin e vendimit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë e bën vetëm Gjykata Kushtetuese. Ne duhet të jemi shumë të qartë me qytetarët shqiptarë.

Sipas nenit 90, pika 2, mocioni për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë bëhet me një të katërtën e deputetëve të Kuvendit, pra me firmat e 35 deputetëve dhe i depozitohet Kryetarit të Kuvendit, i cili ka për detyrë të ngrejë një Komision Hetimor dhe më pas të verifikojë pse Presidenti i Republikës së Shqipërisë e ka marrë këtë vendim. Pasi Komisioni Hetimor të verifikojë dhe të konstatojë për veprimin që ka ndërmarrë Presidenti i Republikës së Shqipërisë, si dhe të dëgjojë Presidentin e Republikës së Shqipërisë,

përpilon një raport, i cili mund të diskutohet në parlament dhe të depotizohet në Gjykatën Kushtetuese.

Fakti që ne nuk kemi Gjykatë Kushtetuese është një fatkeqësi e madhe. Ky është thelbi i të gjithë debatit, ky është thelbi pse shqiptarët po shikojnë një lojë të shëmtuar, një tragjedi që vazhdon dhe na merr zvarrë të gjithëve.

E theksoj edhe njëherë, Gjykata Kushtetuese është organi i vetëm që konstaton këtë lloj shkeljeje, por është detyra ime të listoj arsytet pse mendoj se ky President ka marrë një vendim, i cili vë në pikëpyetje veprimet e tij. Këto pikëpyetje i ngre për tri arsye.

Pse mendon Presidenti i Republikës së Shqipërisë që me këtë veprim e zgjidh krizën? Nëse ai thotë se ky vendim është bërë si një akt patriotik, që zgjidh krizën dhe i vë palët përpara përgjegjësisë, atëherë më thoni ju: nëse palët nuk ulen bashkë dhe nuk arrijnë konsensus për një datë tjetër: a nuk e fusim vendin akoma më shumë në krizë? A nuk e fusim vendin në më shumë pasiguri? Çfarë do të ndodhë, nëse ne nuk arrijmë të gjejmë një zgjidhje? Nëse ne kemi një opozitë jashtë parlamentit shqiptar, që ka si kusht të vetëm që të largohet Kryeministri, atëherë çfarë negociatash do të arrijnë këto dy palë? Unë nuk e shikoj të mundur, është gati e pamundur!

Më falni, zoti President, nëse gruaja juaj është palë e opozitës dhe kjo palë ka ngritur këtë padi, është bërë pjesë e këtij konflikti, atëherë: a nuk është ky një konflikt i pastër personal?

Unë e ngre pyetjen, ju mund të përgjigjeni. Qytetarët duan përgjigje për këtë gjë. Unë e ngre pyetjen. Ai duhet të ulet me të gjitha palët, duhet të ulet me opozitën. Ndërkohë që zonja Kryemadhi është bashkëkryetare e opozitës, atëherë duhet të ulet edhe me të dhe të shikojë se kur do të jetë data tjetër e zgjedhjeve. A nuk ishte ky debat edhe në momentin kur zoti Meta u zgjodh nga ky parlament President i Republikës së Shqipërisë? A nuk ishte ky parlament që e zgjodhi atë me vota?

Më falni, pse e zgjodhët zotin Meta si President të Republikës së Shqipërisë? Për një fakt të vetëm: donit të zgjasnit jetëgjatësinë e tij politike dhe pushtetin e tij. Donit të forconit pozitën e LSI-së. Donit të vazhdonin të kishin pushtet përsëri brenda këtij vendi, apo jo?

Me çfarë kredencialesh e zgjodhët zotin President? A nuk ishte ai në konflikt interesi,

ndërkohë që zgjodhi gruan e tij kryetare të LSI-së? Pse nuk e ngritët këtë problem? Pse nuk bëtë një mocion me debat në atë kohë dhe të thoshit: “Prisni, se kjo nuk bëhet. Ky është një akt i paprecedent. Ky është një akt që nuk duhet të ndodhë në një vend demokratik!”.

Pra, ju, maxhoranca u bëtë palë me LSI-në, me opozitën, ju bëtë marrëveshje me njëri-tjetrin. Për çarë? Për një arsye të vetme: që të zgjasnit pushtetin tuaj, sepse nuk ju intereson fare se çfarë bëhet me Shqipërinë.

Presidenti nuk dha një datë tjetër. Po ta lexosh Kushtetutën siç duhet lexuar, ai duhet ta japë datën. Përsëri e theksoj, unë kam rol verifikues dhe konstatues, nuk jap dot vendime apo gjykime që të shprehem se Presidenti ka kryer një akt të rëndë apo të lehtë. Këtë le ta vendosë Gjykata Kushtetuese. Por unë kam të drejtën time qytetare të ngre pikëpyetjen: nëse unë nuk jam në gjendje ta bëj këtë gjë, atëherë çfarë bëj unë në këtë parlament? Pra, kjo është demokraci, unë të ngre pyetjen: pse i bën ai këto gjëra? Presidenti bën një dekret, e formalizon atë dhe arrin të bëjë zhdekretim të dekretit të tij! Edhe këtë gjë se kemi parë ndonjëherë. Por le ta verifikojë Gjykata Kushtetuese edhe këtë akt.

Të dalim tek arsyetimi i Presidentit. E kam dëgjuar shpesh, nuk ndodh vetëm këtu, ndodh dhe në vendet e tjera, këtë xhest, këtë populizëm: “Ne po e bëjmë këtë gjë për hir të kombit”. Bën akt patriotik, gjë që, në fakt, është e gabuar. Ai xhest bëhet në një vend jashtë Shqipërisë, për të dalluar veten nga një person i huaj, për të treguar patriotizëm, nuk bëhet ndaj shqiptarëve. Nuk mund të më thotë Presidenti: “Unë jam më patriotik se ti, se po bëj këtë akt”. Është një akt i shëmtuar, që të vjen për të qeshur kur e shikon dhe e dëgjon.

Por, gjithsesi, dua t’ju sjell në vëmendje një shembull, sepse duhet të kuptojmë thelbin. Qytetarët duhet të kuptojnë thelbin e aktit të Presidentit që thotë se ky është një akt për hir të kombit. Atëherë, nëse e argumentojmë në mënyrë juridike, sot Presidenti, pas takimeve me njerëz të ndryshëm, të cilët mund t’i thonë: “Kriminaliteti është rritur në Shqipëri, njerëzit po vriten e të tjera”, mund të thotë: “Unë, për hir të Shqipërisë, mendoj se ne duhet të rikthejmë dënimin me vdekje”. Ai mund ta bëjë, pra për shkak se është rritur kriminaliteti, për hir të sigurisë kombëtare e të tjera. A mendoni ju se

organet e drejtësisë do ta zbatonin këtë dekret? Kështu bëhet kjo punë? Ku jemi këtu? Para të Drejtës Romake? Pra, nuk dimë të ndajmë *jus-privatum* dhe *jus-publicum*? Domethënë, ky njeri po bën akte në saj të interesit të tij, apo në saj të interesit publik?

Unë këtë nuk di ta ndaj dot, sepse e keni bërë ju këtë gjë. Maxhoranca e ka votuar me vetëdijen, që Presidenti e ka ende gruan në një parti tjetër, që do t'i shërbejë interesit të vet. Sot ju çuditeni! Normale, që do të bëhet kjo gjë. Vetë e çuat në këtë derexhe.

Po pse na intereson mua dhe grupit parlamentar? Ne nuk duam krizë, nuk duam luftë civile, nuk e duam më Shqipërinë në destabilitet. Jemi lodhur me këtë gjendje.

Të dashur shqiptarë, të dashur qytetarë që na ndiqni, e dini çfarë mund të ndodhë?! Më e mira e mundshme është që zgjedhjet do të shtyhen vetëm me një muaj. Ja këtu do të jemi! Muajin tjetër do të keni zgjedhje. E vetmja pyetje që i bëj vetes është: a ia vlejti barra qiranë? A ia vlejti që opozita të digjte mandatet? A ia vlejti gjithë ky bojkot, që kanë bërë në këta 2-3 vjet? A ia vlejti që ne të bllokoni reformën në drejtësi? A ia vlejti që t'i mbyllim dyert për në Europë? Absolutisht jo!

Po përse bëhet kjo? Në më të mirën e mundshme, kjo bëhet që këta të tre të ulen bashkë me njëri-tjetrin dhe të arrijnë një tjetër konsensus: zgjatjen e pushtetit të tyre. Të vazhdojnë akoma më shumë, të vazhdojnë të njëjtin film, me të njëjtët aktorë, thjesht ndryshojnë rolet me njëri-tjetrin.

Të dashur shqiptarë, ja se çfarë bëjnë politikanët në Shqipëri!

Dua ta mbyll, duke thënë se është koha që populli shqiptar t'i mbyllë perden kësaj shfaqjeje të shëmtuar. Është koha që ne të largohemi nga këta njerëz dhe, kur të vija koha e votimeve, të mos i votojmë më këta njerëz.

Faleminderit shumë dhe uroj që shqiptarët të më kenë dëgjuar!

Gramoz Ruçi - Fjalën e ka deputetja Klotilda Bushka

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Ndërsa të gjithë presin me padurim fillimin e bisedimeve për anëtarësimin në BE, ndërsa

progresraporti i muajit maj i BE-së thotë se Shqipëria i ka përmbushur të gjitha detyrimet që duhet të realizonte në kuadër të integritetit në Bashkimin Europian dhe nëse vendet skeptike nuk do të japin miratimin e tyre, kjo nuk ka të bëjë me problemet e Shqipërisë, por me problemet që vetë ato vende kanë. Ndërsa në Shqipëri po zbatohet një reformë unike, e thellë, për reformimin e sistemit gjyqësor, e cila ka filluar të japë rezultatet e para në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kur nga zbatimi i reformës në drejtësi janë ngritur të gjitha organet e reja të drejtësisë dhe pritet që shumë shpejt të plotësohen vakancat në Gjykatën Kushtetuese dhe në organet e specializuara të luftës kundër krimit dhe korrupsionit dhe kur, në fakt, jemi 12 ditë pas fillimit të fushatës zgjedhore dhe shumë muaj pas dekretit të Presidentit, të nëntorit 2018, në bazë të të cilit u caktua data 30 qershor, si datë e zgjedhjeve vendore, si rrufe në qiell të pastër, vetë Presidenti nxjerr një dekret që zgjedhjet anulohen. Pra, u thotë shqiptarëve: ju nuk do të votoni.

Për mua, problemi nuk qëndron vetëm te fakti se ky akt i Presidentit është absolutisht i pavlefshëm, sepse del në kapërcim të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore dhe, si i tillë, është nul dhe nuk ka se si të gjejë zbatim, prandaj edhe unë e përshëndes vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që vijoi procesin zgjedhor, duke garantuar të drejtën e shtetasve për të votuar dhe zbatoi kështu drejtë parimin e ligshmërisë, por qëndron edhe te fakti se kreu i shtetit ka cenuar rëndë parimet e demokracisë. Është pikërisht kreu i shtetit që ka marrë besimin nga ky Kuvend në vitin 2017, për efekt të një reforme thelbësore që kemi ndërmarrë, për efekt të zbatimit të reformës në drejtësi, sepse, në qoftë se nuk do të bëhej ajo marrëveshje, nuk do të kishim sot zbatimin e reformës në drejtësi, nuk do të ishin ngritur organet e vettingut. Në fakt, vetingu, si proces, nuk është reforma në drejtësi, por është zemra e reformës në drejtësi dhe reforma në drejtësi është hapi kyç për shtetin ligjor, për demokracinë funksionale dhe për perspektivën europiane të Shqipërisë.

Presidenti, në fakt, ka shkelur betimin e tij, duke cenuar parimin e unitetit kombëtar dhe ka tentuar të ndërhyjë në të drejtën e zgjedhësve për

të votuar. Këto janë për mua, si përfaqësuese e sovranitetit popullor, dy shqetësimet kryesore në lidhje me këtë dekret, pavarësisht shkeljeve të tjera, që janë, gjithashtu, shqetësuese dhe janë kryer nga kreu i shtetit. Zgjedhjet janë e drejtë e qytetarëve për të zgjedhur në mënyrë periodike përfaqësuesit e tyre dhe mundësia e partive politike për të garuar dhe për të fituar cilësinë e përfaqësuesit të popullit nëpërmjet votës.

Sipas Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor, Presidenti në procesin zgjedhor ka vetëm një të drejtë: atë të caktimit të datës së zgjedhjeve. Me caktimin e kësaj të fundit, e ka mbaruar detyrën e tij dhe nuk mund të kryejë asnjë detyrë tjetër, aq më tepër të anulohet zgjedhjet. Prandaj, të mohosh realizimin e së drejtës kushtetuese të shtetasve shqiptarë është një shkelje e rëndë, është një cenim i rëndë i të drejtave, që, në fakt, janë themelore në demokraci dhe, pa ekzistencën e tyre, demokracia nuk mund të funksionojë, aq më tepër kur ne jemi sot në 80% të realizimit të procesit të zgjedhjeve vendore të vitit 2019, ku kanë ardhur një sërë pasojash për subjektet zgjedhore: si për ato që kanë të drejtën për t'u zgjedhur, ashtu edhe për qytetarët, që kanë të drejtën për të zgjedhur.

Pasojat, në fakt, nuk janë vetëm materializim i të drejtave të qytetarëve për zgjedhjet vendore 2019, por kanë edhe efekte financiare dhe materiale, të cilat cenojnë të gjithë veprimtarinë e shtetit. Kështu që nuk janë menduar mirë as këto pasoja.

Nga ana tjetër, Presidenti deklaroi se ka marrë si arsye në aktin e tij faktin se disa parti jashtëparlamentare nuk janë regjistruar në këto zgjedhje. Por a mund të jetë kjo një arsye e logjishme për një burrë shteti?

Zgjedhjet janë për popullin, jo për partitë!

Një shtetar i përgjegjshëm duhet të kujdeset që çdo shtetasi t'i krijohet e drejta për të votuar dhe subjekteve politike t'u krijohet mundësia reale për të marrë pjesë dhe për të garuar. Nëse subjektet politike nuk duan, nuk mund të përfshihen me zor në një proces zgjedhor, sepse kështu funksionon demokracia funksionale; këtë sistem kemi zgjedhur të gjithë së bashku.

Në këto kushte, me keqardhje konstatoj që, përveç cenimit të së drejtës së zgjedhjeve, Presidenti ka prekur dhe cenuar edhe parimin e mishëruar në Kushtetutë, që ka të bëjë me faktin se Presidenti është përfaqësues i unitetit

kombëtar. Presidenti ka vendosur të anulohet zgjedhjet, dhe kjo është kërkesë e një grupi të opozitës jashtëparlamentare, e cila ka djegur mandatet dhe ka dalë në rrugë, nuk ka përdorur mekanizmat parlamentarë, madje kërkon të mos bëhen zgjedhjet; kërkon të ikë Kryeministri dhe qeveria. Çuditërisht, të njëjtën kërkesë ka sot edhe Presidenti.

Në kuptim të parimit të unitetit kombëtar, Presidenti qëndron mbi palët, që do të thotë se ai nuk mban anë politike, nuk mban kahe politike, nuk vepron në asnjë moment për njëherë ose tjetrën palë politike, por duhet të jetë neutral në vendimmarrjen e tij. Me këtë veprim ka marrë një vendim politik, i cili del jashtë kompetencave të tij, madje ka cenuar rëndë parimet e funksionimit të shtetit tonë. Ne jemi një Republikë Parlamentare me kompetenca të qarta për të gjitha institucionet.

"Krizë parlamentare, - thotë Presidenti, - është, gjithashtu, një arsye". Ky është parlamenti, këtu janë deputetët e maxhorancës, këtu janë deputetët e opozitës, pra ia kemi dalë të plotësojmë vakancat e krijuara nga veprimet e paprecedenta të opozitës jashtëparlamentare, madje së bashku ia kemi dalë që, si një parlament legjitim, të jemi edhe funksionalë, të marrim vendime dhe të ecim përpara me reformat, siç i pranon edhe Bashkimi Europian, edhe të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë. Pra, nëse këtu ka një krizë, ka vetëm një krizë të opozitës jashtëparlamentare, e cila po tenton që këtë krizë ta injektojë në shtet. Fatkeqësisht, palë me këtë po bëhet edhe Presidenti, i cili ka thyer rëndë besimin tonë, se është përfaqësues i unitetit kombëtar, pasi mban anën e opozitës jashtëparlamentare.

Në përfundim të fjalës sime, dua të shpreh mbështetjen time për draftrezolutën dhe kërkoj nga institucionet, që kanë kompetenca për mbarëvajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve, të vijojnë procesin duke garantuar të drejtën e shtetasve për të votuar.

Madje, kërkoj nga të gjithë ju, kolegë, në këtë sallë që, nëpërmjet mekanizmave demokratikë dhe parlamentarë, të bëjmë ç'është e mundur që zgjedhjet e 30 qershorit...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka deputeti Nimet Musaj.

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Shqipërisë,

Ditën kur kam marrë mandatin e deputetit, kam dashur të largoj modën dhe metodën e vjetër të shkrirjes së këtij mandati për ndërhyrje ekstraligjore për çështje emërimesh, punësimesh e të tjera. E kisha të qartë në kokën time idenë se me këto çështje nuk do të përzihesha kurrë.

Ndaj, që në krye të herës, deklaroj se sot jam këtu për të diskutuar rreth pikës së rendit të ditës: mocion me debat.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, më duhet t'ju kujtoj që Kushtetuta është ai dokument para të cilit jo vetëm kam bërë betimin, por kam dhënë besimin tim për punët që na presin të gjithëve bashkë këtu. Ndaj, jam thjesht duke bërë detyrën time, pa cenuar atë të askujt. Në fakt, cënues më duket keqinformimi dhe keqinterpretimi që po shpërndahet jashtë kësaj sale. Sot jam para jush për të diskutuar lidhur me kushtetutshmërinë e një akti presidencial, jo për karrigen presidenciale. Karriget presidenciale në këtë vend shqetësojnë vetëm partitë dhe kryetarët e tyre, ndonjëherë edhe kryeministër dhe ish-kryeministra.

Kur them që jam këtu për të diskutuar për këtë çështje, besomëni që nuk e bëj me qejf shumë të madh. Do të doja të diskutoja sot për të gjitha çështjet, si, për shembull, për disa ndryshime në ligjin e nëpunësit civil dhe të administratës shtetërore, për reformën në drejtësi, për të cilën, të nderuar kolegë, ju, që keni marrë pjesë dhe keni arritur deri te kjo ditë, keni bërë një punë për t'u vlerësuar; për sistemin zgjedhor, duke përfshirë bashkë me të Kodin Zgjedhor, ndryshimin e Kodit të Punës e të tjera probleme jetike për shqiptarët. Këto janë çështjet që i shqetësojnë të gjithë shqiptarët.

Të nderuar kolegë,

Presidentin nuk e kam votuar, pasi nuk kam qenë pjesë e këtij parlamenti, por nuk kam pasur mundësi ta votoj as si qytetar, sepse nuk më ka lejuar ky Kod Zgjedhor, të cilin ne të gjithë së bashku po kërkojmë t'i bëjmë ndryshime të thella dhe esenciale.

Nëse ka diçka për karrigen presidenciale, që ia vlen t'i marrim kaq shumë kohë publikut, është si do të veprojmë ne, në mënyrë që sovranit ta zgjedhë vetë Presidentin e Republikës së

Shqipërisë. A kemi ne mundësi? Ky parlament ka vlera.

Ju, të nderuar kolegë, me eksperiencën tuaj në gjithë këto vite, mendoj se në të ardhmen e afërt do të sillni këtu në Komisionin Zgjedhor dhe në këtë parlament ndryshimet e kërkuara, që gjithçka të hyjë në hullinë e dëshiruar nga të gjithë qytetarët shqiptarë.

Do të dëshiroja që, nëpërmjet ndryshimit të Kodit Zgjedhor, të shqyrtonim mundësitë se si partitë t'i bënim me një drejtim më demokratik dhe t'i oksigjenonim. Partitë janë pasuri publike që, në mënyrë jo demokratike, po administrohen, siç e dimë të gjithë, për interesa private.

Do të doja të diskutonim se si qytetarët në Fier, me emra "Aliu", "Lori", "Aureli" e të tjerë, të zgjidhnin Presidentin e tyre, të zgjidhnin kryetarët e partisë. Por jo, artificet e stisura e pengojnë këtë gjë! Për çudi, penguesit kryesorë janë ata që, formalisht, do të duhej të ishin përballë këtyre propozimeve. Të jemi të ndërgjegjshëm se për një opozitë demokracia e brendshme është ilaçi më i mirë, që shëron besimin e humbur te votuesit.

Sot të gjithë bashkë këtu, si temë të ditës për qytetarin shqiptar, kemi karrigen presidenciale, për të cilën ai qytetar as voton! Kjo temë u serviret sot!

Unë do të ngre disa pyetje: Çfarë presim? Le ta bëjmë kodin që të votojnë qytetarët për zgjedhjen e Presidentit. Si mund t'u marrin qytetarëve pesë orë nga jeta e tyre me këtë diskutim? Çfarë presim që të ulemi e të reformojmë sistemin dhe Kodin Zgjedhor?! Ç'presim që të shpiem përpara reformat që kërkojnë gjithëpërfshirje? A i meriton vërtet pesë orë ky diskutim për karrigen e Presidentit? Personalisht, mendoj se jo! Ndërkohë, Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor flasin qartë, madje flasin edhe duke mos folur.

Zhvillimi i zgjedhjeve parlamentare dhe lokale është i përcaktuar qartë në Kushtetutë. Për këtë unë kam një qëndrim vetjak të pashprehur më parë. Po, argumentet e Presidentit për një tjetër datë zgjedhjesh janë arsye pse përpjekjet me bazë sheshimin e potencialit destruktiv duheshin bërë që në nëntor të vitit 2018, siç e tha kolegu Balla këtu më parë.

Nuk di të them nëse Presidenti veproi me nxitim apo me vonesë. Opozita jashtëparlamentare e kuptoi që kapitalizimi i

protestës studentore i nëntorit dhe dhjetorit 2018 ishte tërësisht i pamundur dhe se djegia e mandateve nuk gjeti mbështetje jo vetëm në këtë sallë, por edhe jashtë në opinionin e gjerë. Opozita e djeshme dhe ata që sot nuk ndodhen më këtu, që e braktisën këtë sallë (e kam shprehur edhe herët e tjera), kanë shprehur mosdakordësinë për gjithçka që ka ndodhur në këtë situatë për vendin tonë.

Unë gjej edhe një herë rastin t'ju them të gjithëve se prioritetet e mëdha të këtij Kuvendi, tuajat, të nderuar kolegë dhe kolege, janë: SPAK-u; rikthimi në normalitet i Gjykatës Kushtetuese; ndryshimet kushtetuese që demokratizojnë sistemin tonë; ndryshimet në Kodin Zgjedhor, që e afrojnë qytetarin me politikën. Këto çështje meritojnë një debat jo vetëm prej 5 orësh, por shumë më të gjatë. Pjesa tjetër, edhe si vëmendje, është e pamërituar kur gjërat, paçka tymnajës politike që vjen nga jashtë kësaj sale, ia dalin të ndikojnë në axhendën e diskutimeve.

Janë të qarta. Kushtetuta është shkelur. Kështu do të vazhdojë të shkelet përherë?! Nëse ne, të nderuar kolegë, nuk do të punojmë së bashku që, nëpërmjet Kodit, të mos shkelen as statutet e partive, kur demokracia mungon, as marrëveshjet me votuesit.

Mendoj se jo vetëm vlerat e kolegëve të maxhorancës, por edhe të kolegëve të opozitës janë të tilla që ta kalojmë së bashku këtë ngërç të krijuar, t'u sjellim qytetarëve të Shqipërisë jo vetëm këto ndryshime të mëdha që i mirëpresim, por të mos na krijohen më situata të tilla në të ardhmen.

Faleminderit!

Ju uroj suksese!

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka Andi Përmeti!

Të përgatitet Erion Braçe!

Andi Përmeti – Të nderuar kolegë,

Këto ditë jemi njohur me një akt të paprecedentë politik dhe ligjor të Presidentit të Shqipërisë, një akt të cilin e kanë diskutuar të gjithë juristët e Shqipërisë nëse është ligjor apo jo.

Unë si jurist do të ndaja 2 pika themelore në arsyetimin që bëj për të treguar paligjshmërinë e këtij akti.

Së pari, shkelja e nenit 90 të Kushtetutës, i cili përcakton qartë, se Presidenti dekreton datën e zgjedhjeve. Pa dekretin e Presidentit nuk mund

të ketë zgjedhje. Presidenti e ka dekretuar datën e zgjedhjeve më 30 qershor. Në bazë të dekretit të Presidentit kanë filluar të gjitha pasojat juridike për të ardhur në këto zgjedhje, pra Presidenti e ka kryer të plotë funksionin e tij kushtetues për të dekretuar një datë zgjedhjesh.

Së dyti, neni 108 i Kodit të Procedurës Administrative, që thotë se çdo akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm, kur del në konflikt interesi.

Tani është e tepërt t'i shtrosh pyetjen publikut, nëse ka konflikt interesi Presidenti me opozitën. Edhe një student i vitit të parë të Drejtësisë, e di se çdo akt i nxjerrë nga bashkëshorti në favor të bashkëshortes së tij është një akt absolutisht i pavlefshëm.

Pyetja që mua më shqetëson më shumë është: përse Presidenti e ka bërë këtë akt? Pse ne gjendemi këtu? Ky akt e ka thelluar krizën dhe do ta çojë vendin në një konflikt civil. Presidenti thotë se e ka bërë për dashurinë ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë.

I nderuar zoti President, do ta kishe më të thjeshtë sikur pas orarit të punës të shkoje në shtëpi dhe me dashurinë e Presidentit për Shqipërinë dhe shqiptarët, t'i kërkoje bashkëshortes të hiqte dorë nga kjo marrëzi, ta ndalte këtë rrugë, të hynte në zgjedhje dhe të mos e shpinte vendin në konflikt civil.

Presidenti nuk e bëri këtë dhe bëri këtë akt të paprecedentë, që për disa që janë jashtë, e bëri hero e për disa që janë këtu, e bëri armik.

Njerëz, mos u gënjeni! Nuk është armik e aq më pak, hero. Ai është thjesht një nga tre këmbët e sistemit, njësoj si ky mbrapa dhe si ai jashtë. Është një nga tre këmbët, që mbajnë këtë sistem, që është në grahamat e tij të fundit.

Mos harroni se ne shqiptarët, për fat të keq, e kemi kujtesën pak të shkurtër! Dua t'ju kujtoj se në janar 2011 Edi Rama deklaronte para të gjithë shqiptarëve, se Ilir Meta është hajduti i shqiptarëve, i regjistruar në video me zë e me figurë, ndërsa Ilir Meta deklaronte se Edi Rama është një fundërrinë e pashembullt e shoqërisë shqiptare. Pas dy vjetëve u bënë të dy bashkë, pa asnjë skrupull moral vetëm e vetëm për pushtetin e tyre.

Para 2 vjetësh ai që është jashtë, deklaronte se Ilir Meta është stacioni i fundit i maskarenjve, se Ilir Meta drejtonte sh.p.k.- në e vjedhjes së votave në Shqipëri, ndërsa Ilir Meta deklaronte

se Basha ka vjedhur 250 milionë euro vetëm nga Rruga e Kombit. Pas 2 muajsh u bënë bashkë, duke bërë teatër për shqiptarët e duke u thënë se janë bashkë për të mirën e shqiptarëve.

Jepini fund këtij teatri! Mos u gënjeni, njerëz! Pas disa muajsh do t'i shikoni të tre bashkë kundër SPAK-ut dhe kundër sistemit të drejtësisë, sepse e ndiejnë fundin që u ka ardhur dhe kjo ditë nuk është e largët.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Erion Braçe!

Të përgatitet Bashkim Fino!

Erion Braçe – Në këtë vend ka pak ditë që është bërë e modës ta kërkosht Kushtetutën në ato rafte dhe në dollapë, madje në ata që deri dje ose ishin bosh, ose mbahej verë, shampanjë, pije alkoolike, uiski, xhin, madje edhe para të pista.

Ta mbash në dorë Kushtetutën, ta tregosh atë dhe të bësh poza me Kushtetutën, të flasësh për të, të komentosh mbi Kushtetutën, të thuash me pasion e me forcë gënjeshtër për Kushtetutën, aq sa të dukesh si i ditur, i drejtë, i ndershëm në atë që bën. Vetëm një gjë nuk e bën: të lexosh Kushtetutën.

Unë dua të lexoj disa nga nenet e saj, pa i komentuar fare ato. Për hatër të të gjithë këtij debati dhe për hatër të shqiptarëve, po u referohem këtyre neneve:

“Neni 1

1. Shqipëria është republikë parlamentare.

2. Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm.

3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.

Neni 2

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.

2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij, ose drejtpërsëdrejti.

Neni 45

Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.

4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

Neni 65

1. Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të

njëjtë muaj, të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë. Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur.

Neni 109

1. Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilët zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

2. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.”

Neni 92 përcakton se Presidenti ushtron edhe këto kompetenca (janë 12 të tilla), njëra prej të cilave (në germën “gj”), është caktimi i datës së zgjedhjeve. Pra, Presidenti cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin.

Neni 9 i Kushtetutës thotë:

“1. Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.

2. Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë, janë të ndaluara sipas ligjit.”

Neni 18. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

Sikur kaq të kishte lexuar, natyrisht që do të kishte shumë më tepër përgjegjësi dhe përgjegjshmëri për njoftimet e nxjerra publikisht.

Referuar këtyre neneve dua të ndalem në dy çështje:

E para, e drejta themelore për të votuar, zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Pushtet pa zgjedhje nuk ka, pushtet pa zgjedhje sa të duash dhe me kë të duash nuk ka, nuk duhet të ketë dhe nuk do të ketë. E drejta për të zgjedhur me votë përfaqësuesit në Kuvend, qeverisjen qendrore dhe qeverisjen vendore nuk mund të pezullohet, të shfuqizohet jo e jo, nga kurrkush, pavarësisht ofiqit dhe madhësisë së zyrës që ka.

Kjo është risia kushtetuese që kërciti pesë ditë më parë direkt nga selia e Presidentit të Republikës. Krim kushtetues më të madh se ky nuk ka, deformim më të rëndë të demokracisë nuk ka tentuar të bëjë kush.

Po, zgjedhjet në këtë vend na japin edhe aktin më të rëndë kundër zgjedhjeve në këtë vend. Në vitin 1996 zgjedhjet janë dhunuar, manipuluar dhe shkatërruar, por e drejta themelore e shtetasve për të votuar nuk është pezulluar dhe shfuqizuar as atëherë.

Imagjinoni që në vitin 2021, sipas këtij precedenti, PS-ja të thotë që nuk e dua këtë datë për zgjedhje, madje nuk marr pjesë në zgjedhje në këtë datë. I bie që të rrijë pa fund në pushtet ose deri kur të gjithë të binden dhe të bëjnë zgjedhje siç i do Partia Socialiste.

Precedenti i rëndë i krijuar nga Presidenti nuk duhet legjitimuar. Mbyllini pak sytë dhe kthehuni pas në kohë në vitin 2013. PS-ja hyri në zgjedhje pasi e “vranë” pikërisht këta që sot duan të krijojnë këtë precedent.

PS-ja hyri në zgjedhje pasi e vodhën pikërisht këta që duan të krijojnë këtë precedent. I morën pushtetin e dhënë prej popullit përtej zgjedhjeve duke i shfuqizuar ato, po përsëri këta që duan të krijojnë këtë precedent.

PS-ja hyri në zgjedhje pa pasur kurrkënd në KQZ. Ne nuk jemi këta, ne nuk duam pushtet pa zgjedhje, ne kurrë nuk e kemi bërë dhe kurrë nuk do të ndodh që të shfuqizojmë shqiptarët nga e drejta për të zgjedhur, ndaj 30 qershori është rrugë e nisur kushtetutshmërisht dhe ligjërisht, e cila nuk ndalet dhe shfuqizohet. Është e drejtë themelore. Pushtet pa zgjedhje nuk ka më. Ka vdekur që në vitin 2017. Kurrkush nuk mund t'i imponojë maxhorancës një krim kushtetues. Kjo duhet të marrë fund në 30 qershor.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka zoti Fino. Të përgatitet deputeti Halit Valteri.

Bashkim Fino – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Miq dhe shqiptarë kudo që jetoni,

Ju që sot keni humbur arsyen dhe nga rruga apo zyra shtetërore po përdhosni shqiponjën dykrenare me keqpërdorimin që i bëni asaj si simbol i bashkimit, ju drejtohem të gjithëve, sepse sot nuk ka shqiptar, që i thotë vetes patriot, që nuk po ndjek me shqetësim teatrin presidencial, që, prej disa muajsh, vijon me skena të reja të së shkuarës njëra pas tjetrës me shpresën e radhës se ngjarjet mund t'i udhëheqë

drejt një finaleje të lumtur, një teatër për të cilin dramaturgu kryesor ka zgjedhur si skenë Shqipërinë, që në 30 qershor ka zgjedhjet e veta për pushtetin vendor.

Të nderuar deputetë,

Data 30 qershor nuk është caktuar as nga Edi Rama, as nga Lulzim Basha, Monika Kryemadhi dhe aq më tepër nga Ilir Meta. Ajo është thjesht një nga dy datat që të gjithë në konsultë me njëri-tjetrin mund ta zgjidhnin si datën më të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve lokale. Kjo është datë kushtetuese. Neni 92, germa “gj”, e Kushtetutës, ngarkon me detyrë Presidentin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe shpalljen e kësaj date me dekret. Pas daljes së dekretit Presidenti e ka ezauruar detyrimin e vet kushtetues për caktimin e datës. Siç do të thotë dikush, Presidenti ka kryer punë.

Presidenti ka caktuar datën e zgjedhjeve dhe ka kryer punë me zgjedhjet sa herë afrohen afatet kushtetuese dhe ato të Kodit Zgjedhor dhe sa herë që, për shkak të zgjedhjeve të radhës, Presidenti merr letrat, afatet e radhës dhe kalkulon datën e zgjedhjeve të radhës.

Për të ripërdorur dispozitën e nenit 92 të Kushtetutës, Presidenti duhet të presë afrimin e zgjedhjeve të Kuvendit të vitit 2021. Të shkosh nga detyrimi kushtetues për caktimin e datës së zgjedhjeve drejt arsyetimit se pasi ke caktuar datën mund edhe të ndërrosh mendje dhe pastaj të nxjerrësh një letër, që e quan dekret për shfuqizimin e dekretit, është njësoj sikur të pretendosh se mjafton të grisësh kalendarin e varur në murin e shtëpisë dhe data zhduket nga qarkullimi. Presidenti e ka lexuar detyrën kushtetuese të parashikuar në nenin 92, germa “gj”, si privilegj kushtetues, i cili nuk zbatohet po nuk i deshi qejfi atij. Me këtë lexim që i ka bërë Kushtetutës Presidenti parashikon të na thotë që, po nuk e nxori ai dekretin, ky vend nuk ka zgjedhje.

Mbështetur në këtë arsyetim Presidenti na njoftoi për shfuqizimin e datës 30 qershor, me logjikën që po nuk nxora unë dekret, nuk ka zgjedhje në Shqipëri.

Të nderuar kolegë,

Ka një arsyetim pse Kushtetuta dhe Kodi i kanë lënë në dorë Presidentit të zgjedhë vetëm një nga dy data. A e dini cila është arsyeja? Jua them unë.

Arsyeja është se në historinë e këtij vendi ka pasur edhe presidentë të tjerë, që njëlloj si ky i sotmi, besonin se caktimi i datës është privilegj i tyre.

Sigurisht, Kushtetuta nuk mund të parashikonte që dikush mund të arrinte që, pasi të kishte mbaruar detyrën kushtetuese, të bëhej pishman dhe t'i kthehej me grusht kalendarit të radhës. Kushtetuta nuk autorizon që Presidenti të zgjedhë datën e zgjedhjeve pasi ai të verifikojë, siç thotë Presidenti, nëse lista e subjekteve zgjedhore të regjistruara plotëson ose jo mjaftueshëm konceptin presidencial mbi numrin e subjekteve zgjedhore që do të marrin pjesë në zgjedhje. Data e zgjedhjeve vendoset disa muaj përpara, sepse ajo është start i një serie afatesh dhe detyrimesh të subjekteve të tjera që nuk kanë lidhje me Presidentin.

Caktimin e asaj date duhet ta bëjë Presidenti, sepse presupozohet që ai nuk ka lidhje me subjektet e përfshira në zgjedhje. Kodi Zgjedhor është dëshmitar i faktit që Presidenti nuk ka asnjë kompetencë mbi zgjedhjet, sepse Presidenti nuk është palë në zgjedhje. Kur Presidenti të bëhet palë në zgjedhje, luan brenda subjekteve zgjedhore, por jo nga zyra presidenciale dhe nëse ajo zyrë nuk të pëlqen për këtë, nuk është faji i zyrës që ti ke.

Të nderuar miq, demokracia është vullnet i votuesit dhe nuk lidhet me marrjen leje nga Presidenti për të shkuar në zgjedhje ose jo, sepse pa datën e Presidentit nuk paska zgjedhje, me fjali që do të na i shesë si halli që e paska krijuar si një konflikt civil, i cili përbën rrezik serioz për demtimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, stabilitetit demokratik të vendit, unitetit të popullit dhe rendit kushtetues, Presidenti, në fakt, ka kërcënuar të gjithë shqiptarët duke lajmëruar nga podiumi presidencial se, nëse PD-ja dhe LSI-ja nuk hyjnë në zgjedhje, do të ketë luftë. Po si mund të pretendosh se po përfaqëson unitetin e popullit, zoti President, duke kërcënuar popullin tënd? Vetëm Presidenti ynë mund ta imagjinojë dhe kuptojë këtë.

Si ish- kryeministër në një moment të vështirë dhe si deputet me eksperiencë unë di që pluralizmi është instrumenti i sovranitetit popullor, që ushtrohet nëpërmjet zgjedhjeve. Një listë e gjatë me parimet themelore kushtetuese e futur kuturu në supën presidenciale dhe janë kthyer përmbys që me to të artikullohet nevoja e

zhdekretimit të zgjedhjeve, që është atentati, për mendimin tim, më i madh që në këtë vend i është bërë sovranitetit, sepse synon t'i heqë popullit të drejtën ta ushtrojë këtë sovranitet. Pluralizëm pa zgjedhje dhe pa parlament nuk ka. Kjo është teoria e sovranitetit, teoritë e tjera janë si të shesësh prej floriri monedhat kalpe.

Të nderuar miq të partisë sime dhe deputetë të maxhorancës, jemi mbledhur sot për një rend dite, mocion-debat për zallamahinë presidenciale. Shumë prej nesh do të donin që Presidenti të shkarkohej sot dhe unë e mirëkuptoj presionin e bazës së militantëve të partisë për të shkuar drejt procedurave të shkarkimit të Presidentit Meta. Janë po ata militantë dhe po ajo bazë që na pa me inat kur e votuam Presidentin, por unë sot them se gabimin që kemi bërë dikur nuk mund ta thellojmë duke e shkarkuar. A e dini pse? Le ta lëmë t'i shkojë deri në fund, për aq sa mundet, teorisë dhe teatrit të tij presidencial. Ne duhet ta lëmë që skenën kriminale të atij teatri ta luajë nga zyra e Presidentit.

(Zoti Fino flet pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Zoti Fino, faleminderit!

Fjala për deputetin Halit Valteri.

Zoti Fino, të mbaroi koha.

Nuk ka asnjë minutë.

IT-ja të ndërpresë foninë.

(Zoti Fino flet pa mikrofon)

Zoti Fino, uluni, ju lutem!

Fjala për Halit Valterin.

Halit Valteri – Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Kur ju shoh ju, më vijnë ndër mend 300 mijë shqiptarët që kanë ikur nga sytë këmbët, natën dhe me kokën në torbë vetëm për të mos parë surretërit tuaj. Nëse nuk e keni kuptuar ende, ato janë vota kundër jush, janë 300 mijë shuplaka, 300 mijë grushte, 300 mijë përbuzje, përçmime, që ju vijnë sapo shfaqen surretërit tuaj në ekran, pa harruar edhe ato qindra mijëra që ju duan duke ju urreyer.

Mjaftojnë 300 mijë votat e tyre si klithmat e fundit të vuajtësve ndaj një pushteti që jo vetëm nuk funksionon, por duket me milje larg që është shkalafitur dhe rrënuar, që mezi mbahet në këmbë, madje po na bën gazin e botës. 300 mijë vota janë kundër talljes që u bëni çdo të enjte shqiptarëve, të cilët, kur dëgjojnë se keni zgjedhur presidentin më të mirë të të gjitha

kohërave që ka ky vend, siç e reklamonte edhe zoti Kryeministër, i cili nuk është këtu sot, ose më saktë kryetari i sektit të spiunëve, siç e cilësonte Ilir Meta, para se ta zgjidhte president, si të mos ikin? Si të mos ikin kur dëgjojnë deklaratat e fundërrinës së pashembullt morale, nëse memoria nuk gabon, të paktën kështu deklaronte dikur presidenti i zgjedhur prej tij, të cilin na e shitët për burrë zotni dhe ajkën e presidentëve që ka pasur Shqipëria. Të gjithë e mbajnë mend kur me paturpësinë më të madhe na e zgjodhët presidentin më të mirë që keni pasur ndonjëherë, me plot 88 vota, kur salla buçiste nga duartrokitjet, shtrëngimet e duarve, puthjet, përqafimet, ndërsa shqiptarët e neveritur nga buzagazi juaj ndiqnin teatrin e radhës nga shtëpia, të pafuqishëm për të reaguar, të prerë në besë nga premtimet me fund të lumtur, se me ju do të bëhej drejtësi. Madje tentuat t'u hidhnit edhe trutë e gomarit duke vënë në skenë aktin e radhës, teksa aktori juaj i dështuar, presidenti i ri, lëvizte truprëndë në sallë i ngrysur pse e zgjodhët president, ndërsa ju, heronjtë, kapardiseshit se ia punuat, e larguat me bisht ndër shalë, e dënuat dhe e internuat në Presidencë.

Atyre që ju kishin votëbesuar iu zotuat që do ta çonit para drejtësisë, por çfarë bëtë? E graduat president. E internuat si president, apo e dënuat si president? Kurse ata që ndoqën shfaqjen tuaj të turpit mblodhën plaçkat, mendjen, rrobat, ato pak kurse dhe u larguan nga ky vend, për të mos u kthyer më, sepse, të paktën, për sa kohë jeni ju këtu dhe për aq kohë sa do të qeverisin kusarët, hajdutët e shqiptarëve, ata nuk do të kthehen dhe nuk janë pak, janë ajka e shoqërisë, janë rinia e shoqërisë.

Disa nga ju po qeshin, por, në fakt, nuk është për të qeshur, por për të vënë duart në kokë dhe për të qarë. Nëse nuk i trembeni asnjë drejtësie, nga këto që i miratoni edhe me flakadanë, edhe me vota, do t'ju sugjeroja t'i trembeni një drejtësie, asaj të krijuesit të gjithësisë, sepse asaj drejtësie nuk mund t'i shpëtoni as në këtë botë, as në botën tjetër, pa i larë të gjitha haqet.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Valteri!

Fjala për zonjën Spiropali.

Elisa Spiropali - I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Sali Berisha, Ilir Meta, Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi i janë vërsulur shtetit shqiptar me një brutalitet të pashoq, të ngjashëm me kohët më groteske të historisë sonë kombëtare. “Me atdheun në gojë, me helmin në bark”, siç do të thoshte Noli, kjo çetë me 4 vetë kërkon me ngulm t'i vërë minat themelit të bashkëjetesës në sistemin demokratik, të tronditë rendin kushtetues, të mpijë shoqërinë përmes frikës dhe kërcënimeve dhe t'i privojë brutalisht qytetarët nga të drejtat e tyre kushtetuese. Këtë aktivitet kriminal e ideojnë, e planifikojnë dhe e ushtrojnë në bashkëpunim.

Qëllimi: mposhtja e shtetit, rrëzimi i qeverisë dhe kaosi shoqëror.

Mjeti: të gjitha për të justifikuar qëllimin.

Arsyeja madhore: frika nga zgjedhjet, nga drejtësia dhe nga integriteti.

Këta kampionë olimpike të hipokrizisë njerëzore duan të na bindin se molotovi është karamelle; flakadani është qiri për meditim; gazi lotsjellës është armë e shkatërrimit në masë; sulmi ndaj institucioneve është rezistencë gandiste për liri; djegia e mandateve është akt heroik; mospjesëmarrja në zgjedhje është fitore legjendare e paparë dhe e padëgjuar në historinë e planetit; kërcënimi për pengimin e zgjedhjeve është luftë kundër diktaturës; zhdekretimi i Presidentit është akt prej burri shteti.

Në fakt, akti i Ilir Metës është vazhdimi i kësaj lufte primitive me mjete të tjera; akti i Ilir Metës është një atentat i pastër kushtetues që sulmon Republikën duke shkelur harbutërisht një sërë nenesh, ku mishërohen parime të rëndësishme të demokracisë; akti i Ilir Metës cenon rëndë të drejtën e zgjedhjes së shtetasve.

Zgjedhjet janë e drejta e qytetarëve për të zgjedhur në mënyrë periodike përfaqësuesit e tyre. Këta janë mësuar të bëjnë çfarë kanë dashur, si kanë dashur dhe kur kanë dashur, me Kushtetutën, ligjin dhe me vetë Shqipërinë dhe shqiptarët, por jo sot, dhe jo më. Më 30 qershor do të përballen me murin e lartë të ligjit ku do të thejnë hundët.

Ilir Meta shkeli parimin e unitetit kombëtar. Presidenti është neutral, i paanshëm, i pavarur dhe pavarësia e tij garantohet. Ai mishëron të gjithë popullin në unitetin e tij, por me vendimin e tij ai dëshmoi se mund të nxjerrësh Presidentin nga kulla e LSI-së, por nuk mund ta shkulësh LSI-në nga zyrrat më të larta të shtetit.

Shkeli parimin e periodicitetit të zgjedhjeve; shkeli parimin e sovranitetit të popullit; Presidenti u zgjati mandatin tej afatit kushtetues organeve vendore dhe këto organe nuk mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre përtej, po kush do t'ia dijë! Ilir Meta jo, as ata që janë pas tij!

Presidenti synon të zgjidhë një pseudokrizë institucionale duke qenë ideator i kësaj përpjekjeje për mbijetesë të opozitës ekstraparlamentare.

Presidenti deklaroi se nuk mund të bëhen zgjedhje pa pjesëmarrjen në garë të aktorëve politikë, kur e ka të qartë se janë 42 parti të regjistruara. Si mund të shkelë Presidenti të drejtën e këtyre partive për të garuar dhe të drejtën e qytetarëve për të zgjedhur? Ai tenton ta justifikojë aktin e tij duke thënë se po shmang përplasjen civile. Cilën përplasje civile, atë që e ideoi në shtëpi dhe në parti? Atë që e ideojnë miqtë i tij, Sali Berisha me Lulzim Bashën? T'i tërheqë të dy dhe nuk do të ketë përplasje civile.

Por, sigurisht, historia na mëson periodicitet përsëritës dhe përkime të habitshme sa qesharake aq edhe dramatike. Çfarë ju kujton kjo? Janë shkruar disa vargje, në fakt:

“Krisi pushka e gjëmoi moti,
kujton austriaku se u bë kiameti.
Nuk është kiamet, por është murtanë,
vjen Kavaja me gjithë Tiranë
Gajret çuna dhe ju faltë Zoti,
se princ Vidin s’e zë moti.
Se princ Vidin s’e zë moti,
kemi lejnun o prej baroti.
Mal mbi mal këndon bilbili,
trim mbi trima Haxhi Qamili
Haxhi baba me vegjëli, qiti Vidin me 12 mijë”.

Kjo lëvizje, e cila ngjan kryekëput me këtë, sigurisht nuk mund...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjala për zotin Ahmetaj. Të bëhet gati zoti Xhafaj.

Arben Ahmetaj – Dekreti i Presidentit për zhdekretimin e datës së zgjedhjeve nuk besoj se kërkon justifikim juridik. Parafolësit dhe kolegët iu referuan me saktësi të gjitha neneve të Kushtetutës. Për këtë arsye unë do të fokusohem më shumë tek akti politik, siç iu referua edhe Presidenti zhdekretimit. Ta gjejë kushdo një nen

të Kushtetutës, nga Presidenti deri te konsistucionalisti i fundit, ku Presidenti i Republikës ka të drejtë t'u mohojë të drejtën për të votuar qytetarëve të vendit; më gjeni një nen ku të thuhet: “Po, Presidenti i Republikës ka të drejtë t'u thotë qytetarëve të vendit të vet: ju nuk do të votoni në datën kushtetuese”. Të gjitha nenet e tjera justifikuese të zhdekretimit bien automatikisht.

Çfarë tha Presidenti në themel? Duke pretenduar të dilte mbi palët, në fakt, ai u bë palë duke iu referuar dëmit të demokracisë, siç u referua në deklaratën e vet, qetësisë dhe Shqipërisë dhe vendosi të bëhet palë po në dëm të demokracisë.

Shfuqizimi, siç e theksova, është drejtpërdrejt mohimi i së drejtës së shqiptarëve për të votuar. Presidenti politikisht iu referua kërcënimeve të një partie, apo shumë partive opozitare parlamentare ose joparlamentare, për dhunë në ditën e zgjedhjeve.

Imagjinoni, të nderuar qytetarë, Presidenti ka zhdekretuar datën e zgjedhjeve, u ka mohuar shqiptarëve të drejtën për të votuar, sepse një palë ka kërcënuar me dhunë, si rëndom në 30 vjet. Pra, cila është logjika kushtetuese? Një palë nuk do të marrë pjesë, një palë kërcënon me dhunë për arsyet e veta, se nuk është gati, nuk e do Edi Ramën, nuk e do Partinë Socialiste, nuk e do maxhorancën. Patjetër, nëse nuk e do, hajde dhe përballu në zgjedhje. E ka ndaluar kush të marrë pjesë në zgjedhje këtë palë, zoti President? Jo!

Po shqiptarët a i ndaloi ndokush të votojnë? Po, i ndaluar ju dhe kjo nuk është të qetësosh konfliktin, kjo është t'i hedhësh benzinë zjarrit. Pra, sërish jeni bërë palë me një palë që ka lënë institucionet dhe kjo nuk është në favor të demokracisë, kjo është në dëm të demokracisë. Një miku im konstitucionalist më tha dje: (do të doja për një sekondë të kisha vëmendjen e qytetarëve) “Imagjino sikur në vitin 2021 Partia Socialiste të dalë dhe të thotë ne nuk do të hyjmë në zgjedhje me Lulin dhe Saliun se kanë vrarë më 21 janar, se kanë përvëlur në Gërdec, kanë varë në '97-ën, kanë kontribuar kundër popullit të Kosovës dhe pavarësisë së saj, kanë vjedhur shqiptarët në mënyrë të spikatur te Rruga e Kombit. Çfarë do të ndodhë?” Unë iu përgjigja: “Nuk e di, të pyesim Presidentin.”

Zoti President, çfarë do të ndodhte nëse maxhoranca do të thoshte: “Jo, në vitin 2021 ne nuk hyjmë në zgjedhje me këta”? Data 30 qershor nuk është data e askujt, por është data e të gjithë shqiptarëve dhe ju, veç e veç, çdo shqiptari i keni mohuar të drejtën për të votuar, por jo ne, jo kjo maxhorancë dhe fatmirësisht KQZ-ja ka marrë vendimin e duhur, në datën 30 qershor do të shkojmë drejt kutive të votimit.

Ju me të drejtë iu referuat reflektimit, është patjetër koha për reflektim edhe për ju, për të gjitha palët, për këtë krizë që filloi e sajuar artificialisht. Ju iu referuat demokracisë dhe qetësisë së shqiptarëve, pardje kur zhdrekretuat datën e zgjedhjeve. Po ju bëj një pyetje. Ditën që Partia Demokratike dhe LSI-ja dogjën mandatet a e ushtruat ju të drejtën kushtetuese si President mbi palët për t'i ndaluar, sepse kur Shqipëria pret hapjen e negociatave, çdo gjë e tillë jashtë institucioneve dëmton imazhin e Shqipërisë? A mos vallë ishte e qëllimshme?

Gjithsesi, pyetja tjetër është: a jemi ne në të drejtën tonë? A kemi prodhuar ne ndonjë akt që të ndalojmë opozitën të marrë pjesë në zgjedhje? Gara është garë, garën nuk e përcakton refuzimi i një pale për të marrë pjesë, sepse ka 40 e kusur parti që duan të marrin pjesë në garë. Ju ia mohuat të drejtën, ne më 30 qershor në bazë të atij vendimi të drejtë kushtetues të KQZ-së do të shkojmë të votojmë...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Fjalën e ka zoti Xhafaj. Keni 8 minuta në dispozicion.

Të përgatitet Ralf Gjoni.

Fatmir Xhafaj – I nderuar zoti Kryetar, Të nderuar kolegë,

Për dekretin e Presidentit për shfuqizimin e dekretit të mëparshëm për caktimin e datës 30 qershor, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve vendore, duket se shumica dërmuese bie dakord në një gjë, dekreti i Presidentit të Republikës është tërësisht në tejkalim të kompetencave të tij kushtetuese. Presidenti ka ushtruar një kompetencë që Kushtetuta dhe ligjet në fuqi nuk ia japin. Ka ndërhyrë me autoritetin e tij kushtetues në një proces tashmë të filluar. Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor përgjegjësinë e administrimit të procesit ia njohin një tjetër institucioni kushtetues, KQZ-së. Presidenti, si dhe qeveria, nuk kanë asnjë përgjegjësi që lidhet

me administrimin e procesit zgjedhor. Presidenti me shpalljen e datës së zgjedhjeve humb çdo pikë lidhjeje ligjore dhe institucionale me zhvillimin, administrimin dhe ankimin e procesit.

Ndaj, me shumë të drejtë, akti i tij konsiderohet si tejkalim i kompetencave të tij dhe për rrjedhojë një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, që nuk mund të prodhojë efekte për procesin zgjedhor tashmë në fazën e tij vendimtare. Mbështetës të këtij akti po kërkojnë ta justifikojnë atë me qëllimin e mirë në funksion të zgjidhjes së krizës aktuale. Të gjithë e pranojnë dhe e mirëpresin ndikimin dhe rolin e Presidentit të Republikës në trajtimin dhe zgjidhjen e krizave politike, kjo është në përgjegjësinë dhe rolin e tij kushtetues, por në këtë rast kjo nuk ka ndodhur. Në vlerësimin tim Presidenti ka gabuar në rrugën e zgjedhur, jo vetëm se mekanizmi i zbatuar prej tij është në tejkalim kushtetues, por edhe sepse nuk i shërben realisht zgjidhjes së krizës, por acarimit të saj, duke u dhënë një alibi më shumë krijuesve të kësaj krize dhe duke i bërë ata palë në këtë proces.

Presidenti ndërhyri me mjete juridike, imponoi mekanizma juridikë në një krizë politike, në një kohë që do të duhej të përdorte autoritetin e tij kushtetues për të ndërtuar ura dialogu dhe për të mundësuar kompromise politike, gjithmonë në respekt të Kushtetutës dhe të ligjit. Kur kemi vepruar kështu, kemi pasur edhe kompromise të shëndetshme, edhe zgjidhje të mençura. I tillë ka qenë roli ish-presidentit shumë të respektuar, zotit Alfred Moisiu, në krizën e parazgjedhjeve vendore të vitit 2007. Gjithçka u ndërtua mbi një dialog intensiv dhe konstruktiv, gjë që çoi në kompromis dhe kompromisi i palëve imponoi zgjidhjen institucionale, shembull që nuk mund të shërbejë aspak si precedent për rastin konkret, pasi jo vetëm kuadri ligjor zgjedhor në atë kohë ishte i ndryshëm nga ky që kemi sot, por edhe sepse vetë presidenti Moisiu kërkoi parashikimin në ligj të mundësisë së nxjerrjes së dekretit për një datë të re zgjedhore.

Në vlerësimin tim, debati politik dhe parlamentar sot nuk mund të ngushtohet si një debat për një dekret apo për një akt administrativ, qoftë ky edhe i nivelit presidencial. Duhet ta pranojmë me qetësi dhe

kthjelltësi se kemi një situatë të rënduar. E vërteta është se ka një krizë politike të sajuar, e cila ka në thelb të saj një përplasje midis standardeve demokratike dhe anarkisë politike; midis shtetit të së drejtës dhe antishtetit; midis parlamentarizmit dhe partitokracisë. Problemi i vërtetë nuk është aq data e zgjedhjeve në vetvete, por mënyra e sjelljes së lidershit politik me përgjegjësi ndaj vendit, stabilitetit, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Opozita parlamentare jashtë çdo standardi demokratik ka braktisur parlamentin, ka dorëzuar mandatet e përfaqësimit, ka zbritur në rrugë dhe po kërkon të imponohet me mjete të dhunshme. Prej muajsh opozita jashtëparlamentare, tashmë e frymëzuar dhe e dhunuar nga Sali Berisha dhe e veshur me autoritetin fals të Lulzim Bashës, po silltet si një forcë antikushtetuese. Kjo, sepse ka pushuar së funksionuari brenda sistemit demokratik parlamentar dhe me presionin e rrugës po kërkon t'u imponohet autoriteteve të ligjshme kushtetuese me forcën e dhunës, po i shërben destabilitetit dhe cenimit të rendit kushtetues.

Opozita jashtëparlamentare ka një krizë të brendshme, që po kërkon ta imponojë si një krizë të shoqërisë shqiptare. Kjo krizë ka shumë faktorë, por, pa dyshim, një ndër ta dhe më kryesori, sipas meje, është kriza e lidershit të saj politik. Në krye të saj formalisht është imponuar një njeri, që as motivon dhe as frymëzon; një njeri që, siç është thënë shpesh, gënjen edhe për orën e dorës.

Si mund të jetë frymëzim për zgjedhje të lira dhe të ndershme një njeri, që nuk ka mundur të zhvillojë një garë të ndershme brenda forcës së tij politike, një njeri që ka bërë pis zgjedhjet, kudo ku është përfshirë, aq sa është ndër të paktët politikanë të këtij vendi, që është futur në listat e zeza të SHBA-ve për dhunim të standardeve zgjedhore?!

Si mund të ndërtojë një kauzë për luftën kundër krimit ky njeri, kur periudha e të cilit, në funksionin e ministrit të Brendshëm, konsiderohet nga më të errëtat dhe me treguesit më të ulët në luftën kundër të kriminalitetit në vend?! Kjo është e vërtetuar jo me fjalë dhe se kështu duam ta gjykojmë kundërshtarin politik, por me shifra dhe me fakte konkrete.

Si mund të mbrojë dhe të promovojë parimet e shtetit të së drejtës për reformën në drejtësi ky njeri, i cili për herë të dytë në

historinë e këtij vendi, pas asaj të miratimit të Kushtetutës së re shqiptare në vitin 1998, e vendosi PD-në në tentativat pengmarrëse të reformimit të drejtësisë kundër interesave të ligjshme të shqiptarëve, si dhe kundër angazhimit dhe kontributit të jashtëzakonshëm të partnerëve ndërkombëtarë?!

E kam dëgjuar Lulzim Bashën të flasë për kapje të reformës në drejtësi, të institucioneve të reja të drejtësisë, ende të paformatuara mirë. Flet për kapje të sistemit ky njeri, që la fushën e lirë dhe u largua nga angazhimet dhe detyrimet e tij ligjore dhe institucionale në këtë proces dhe jo vetëm nuk kontribuoi në moskapjen e sistemit, përkundrazi, tentoi ta zvarrisë, ta marrë peng dhe, tashmë, ta delegjitimojë.

Kapje të sistemit të drejtësisë! Po, ai sistem është i kapur kokë e këmbë. Nëse nuk do të ishte kapur ai sistem, prokurorët dhe gjyqtarët e tij, deri në nivelet më të larta, Lulzim Basha sot do të ishte në burg e jo për pak, por për tri vepra të rënda penale: vjedhje me pasoja të rënda të pasurisë publike; marrëveshje për dorëzimin e territorit, si cenim i integritetit të vendit; si dhe vrasje e kryer me dashje.

A është ende i kapur sistemi i drejtësisë? Sigurisht, sepse nuk është çliruar ende, sepse, nëse do të kishte ndodhur kjo gjë, ndër të parët që do të shkonte në ndjekje penale për pastrim parash do të ishte Lulzim Basha, për të cilin ka një proces penal, që zvarritet pafund nga Prokuroria e Tiranës.

Zbatimi i reformës në drejtësi është ende në fillimet e saj. Natyrisht, ka gjëra, të cilat nuk po ecin me ritmin e duhur, që mund të bëheshin edhe më mirë, por me vullnet pozitiv ne mund të korrigjojmë se çfarë ka nevojë për t'u korrigjuar në këtë proces. Kjo është një praktikë normale në çdo lloj reforme dhe jo më në një reformë të përmasave të tilla. Së pari, këtu duhej të kishim treguar më shumë angazhim për ringritjen e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Gjithsesi, një gjë është fakt: reforma në drejtësi është në rrugën e duhur.

Përtej shqetësimeve parimore dhe të arsyeshme, përpjekjet për ta delegjitimuar reformën me argumentet se është e kapur nga qeveria janë false dhe thjesht alibi politike apo më keq akoma paranoja apo frikë për të nesërmën. I kam parë dhe i kam ndjerë këto

paranoja, të cilat, për fat të keq, i shikoj edhe sot, djathtas dhe majtas.

Ne kemi dizenuar në arkitekturën e këtij sistemi të ri mekanizma të qartë që minimizojnë ndjeshëm ndikimin e partive politike në ngritjen dhe në vendimmarrjen e institucioneve të reja, dhe kryesorja, në dhënien e drejtësisë, duke u garantuar gjyqtarëve dhe prokurorëve të sistemit të ri që po ngrihet qëndrueshmëri, pavarësi dhe autoritet në zbatimin e ligjit.

Vazhdoj të besoj fort në këtë gjë, besoj fort tek të gjithë ata burra dhe ato gra, djem dhe vajza që, pas kalimit të vetingut, do të dinë të tregojë se meritojnë të jenë pjesë e këtij pushteti të ri gjyqësor, i cili ka për detyrë të balancojë arbitraritetin dhe arrogancën e dy pushteteve të tjera në radhë të parë të politikës, në interes dhe në shërbim të qytetarëve të këtij vendi, të cilët meritojnë të qeverisen shumë më drejtë dhe shumë më mirë se deri më sot.

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zoti Xhafaj!

Fjala për deputetin Ralf Gjoni.

Të përgatitet deputeti Ulsi Manja.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti Kryetar!

Sot po diskutojmë mocionin me debat për aktin e Presidentit të Republikës, por në sallë nuk janë as 19 deputetë të partisë *WhatsApp*-iste. Jeni po aq sa ka pasur ish-Grupi Parlamentar i LSI-së. Ja, ky është serioziteti i këtij parlamenti!

Kryeministri përsëri mungon, zoti Braho, dhe as nuk denjon të vijë në parlament; nuk e çan kokën fare për parlamentin. Ai vjen këtu vetëm për të bërë monologun e radhës, ju dërgon juve *WhatsApp*-in e radhës, ju votoni dhe kështu mbaron filmi. Hajde parlament, hajde!

Kjo që po bëni ju sot është *show* medietik, është teatër, është cirk. Më vjen të qesh kur ju shikoj se si doni të shkarkoni Ilir Metën nga posti i Presidentit të Republikës. Kjo është fantastike! Ju doni të shkarkoni Ilir Metën nga posti i Presidentit! Ju që e votuat të gjithë në rresht me *WhatsApp*. A e votuat, zoti Ulsi?! Më duket se vetëm Adnori nga Skrapari nuk e ka votuar, kurse të gjithë ju të tjerët e votuat.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Kush e votoi?! Unë nuk e kam votuar? Ju e votuat, kështu që ta gëzoni, ta mbani! Unë kam qenë në atë lozhë dhe nga të gjithë këtu në parlament, jam i vetmi që e kam përjetuar ditën e votimit të Ilir Metës si President si një ditë të zezë. Le të flasim sinqerisht, sepse edhe ju, që e

keni votuar, brenda vetes nuk keni dashur ta votoni Ilir Metën si President, por kuptohet për arsye të tjera e votuat. Unë nuk e doja Ilir Metën si President, sepse e dija që largimi i tij nga LSI-ja ishte fillimi i fundit të asaj partie. Nuk e kam besuar kurrë se zgjedhja e Ilir Metës nga PS-ja si President i Republikës ka qenë në shërbim të shqiptarëve.

Ju e dini më mirë se unë që Edi Rama ju urdhëroi ta zgjidhnit Ilir Metën, sepse donte ta hiqte nga politika, ta dërgite atje në Presidencë, që ngjan më shumë me një azil pleqsh, sesa me një godinë, ku duhet të punojë koka e shtetit shqiptar.

O Taulant, çfarë kujtuat ju se Ilir Meta do të ishte President mbi palët?! Po Ilir Meta është bishë politike, more, është makineri politike, i vlon politika në gjak, në vena. Po ku jeton dot Ilir Meta pa politikë! Ju e çuat atje, sepse menduat se do të ishte mbi palët. Hajde mendje, hajde!

Presidenti nuk shfuqizon dot dekrete, të nderuar kolegë, sepse ju e keni zhvlerësuar totalisht rolin e Presidentit të Republikës me ndryshimet e vitit 2008. Presidenti nuk vlen asgjë në këtë vend, jo Ilir Meta, por pozicioni Presidentit, apo jo Ulsi?!

Në këto kushte, unë mendoj se do të ishte më mirë të ishim monarki. Le të flasim hapur! Princi Leka dhe princesha Elia Zaharia janë shumë më dinjitozë se çdo President që ne kemi pasur në këta 10-15 vjetët e fundit. Pse e duam Presidentin, kur ju emëroni dhe e shkarkoni me *WhatsApp*?! Më falni, pse vlen Presidenca në një republikë parlamentare, kur bëhet burim konflikti me maxhorancën?! Gjithmonë ka qenë në konflikt! Kështu ishte edhe Bamir Topi, vetëm Nishani rrinte urtë atje. Nishani ishte më i urtë. Atëherë, çfarë taksirati ju kanë shqiptarët që të merren me tekat tuaja infantile?! Është e qartë se çfarë po ndodh!

Një miku im shkrimtar shkroi shumë bukur dje apo pardje: "*L'état, c'est moi!*". Kështu thoshte Luigji XIV në vitin 1655, si imponim i primacisë së autoritetit mbretëror ndaj parlamentarëve parisienë. "*L'état, c'est moi!*", "Shteti jam unë", kështu thoshte Luigji XIV; "Shteti jam unë", thotë edhe bajraktari tjetër.

Pas 30 vjetësh demokraci, palodemokraci shqiptare, me plot asistencë ndërkombëtare, me miliona euro dhe dollarë të hedhur kot nëpër

konsulenca dhe projekte ndërkombëtare, ne kemi arritur që të ndërtojmë në Shqipëri një “republikë bajraktariste”. E kemi ndarë Shqipërinë në 3 bajraqe.

Bajraktari i parë, në çifligun e tij, sipas shijes dhe dëshirës, ngul dhe çngul dekrete me shpresën se do të bllokojë erërat e fuqishme globale.

Bajraktari i dytë, në bashkëqeverisje me turmat amorfe, monologun për ato të mira që u ka bërë, që po u bën dhe që do t’u bëjë këtyre turmave amorfe me shpresën se do t’u nanurisë dhe do t’i vërë në një gjumë ëndrrash parajsore.

Bajraktari i tretë, plaku i madh, si magjistar manovrues marionetash me një thirrje të vetme i mbledh dhe i bën bashkë të gjitha marionetat e tij dhe i kurdis kur të thërrasin dhe kur të heshtin, kur të ngrenë duart lart dhe kur t’i ulin, kur të marrin armët dhe kur t’i lëshojnë, duke komanduar edhe instinktet e tyre biologjike.

Duam të hyjmë në Bashkimin Europian dhe të bëhemi ortak me Gjermaninë dhe Francën, por jo me Francën e sotme, por me Francën e atëhershme të Luigjit XIV, sepse bajraktarët në Shqipëri mendojnë: “Shteti jam unë”. Kështu thonë të gjithë bajraktarët.

Të nderuar kolegë, doni të bëjmë shtet?! Me kolegët e opozitës jemi të unifikuar këtu, mos na e kini merakun. Kolegë socialistë, duam të bëjmë shtet?! Hajdeni të kthejmë të drejtën e përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë të votuesve shqiptarë me ligj. Këtë kërkojnë aleatët tanë Perëndimorë. Çdo konflikt në Shqipëri ka në thelb zgjedhjet, të drejtën e përfaqësimit, të drejtën e të zgjedhurit. Ky sistem i qelbur politik prodhon kryesisht jeniçerë politikë, otomanë dhe mercenarë mediatikë. Duhet t’i themi disa të vërteta.

Kjo gjendje alarmante imponon riformatim total të republikës, Kushtetutë të re; ndryshim të sistemit zgjedhor; ligj të posaçëm për Presidentin dhe ligj të mirëfilltë për partitë politike. Jam shumë dakord me kolegun Bashkim Fino që duhet një ligj organik për Presidentin. Turp, për faqe të zezë! Nuk kemi një ligj për Presidentin, se si funksion Presidenca. Hajdeni ta bëjmë! Pse bëjmë nocione kot, teatër, cirk?! Hajdeni të bëjmë një ligj!

Reforma në drejtësi nisi, tani ne duhet të reformojmë rregullat bazë të lojës zgjedhore. Ndaj, edhe ky mocion, të cilin e keni pikturuar

me kaq mjeshtëri është nul, nuk ka asnjë vlerë juridike, për më tepër nuk na përket neve, si parlamentarë. Presidenti nuk ka sfiduar autoritetin e këtij parlamenti, sepse, po të sfidojë parlamentin (ta dinë të gjithë shqiptarët, edhe ata që përmendin emrin tim, ata mercenarët e ndyrë medietikë), Presidenti shkarkohet për 2 minuta, pa asnjë lloj problemi. Por nuk e ka etiketuar parlamentin, nuk e ka sfiduar autoritetin e këtij parlamenti. Atëherë, çfarë drejtin keni?!

(Reagim pa mikrofon)

Të drejtën e votës?! Ju thoni se ka marrë vendim KQZ-ja. A e mori vendimin KQZ-ja?! Çfarë keni? Pse duhet të kthehemi ne në Gjykatë Kushtetuese? Doni ta sfidoni Presidentin?! Çojeni në Gjykatë Administrative, meqenëse mendoni që është akt administrativ. Pse nuk e çoni? Shteti flet me akte gjykatash, me gjykata, me të drejtën, jo me pallavra në parlament.

Të nderuar kolegë, dhe Adnori do ta ndiejë shumë thelbin e argumentit, mua më shqetëson sot fakti që Presidenti i Republikës flet për konflikt civil më 30 qershor. Ore, 1 minutë, nga e mori këtë informacion Presidenti?! Nga shërbimet sekrete, nga agjenci ligjzbatuese?! Më falni, nga buron ky rrezik i konfliktit civil, sepse unë nuk shikoj ndonjë konflikt civil në terren? Nga buron? Cilat janë këto shërbime sekrete, që i dhënkuan informacion për vrasje Presidentit dhe nuk ia japin parlamentit apo Kryeministrit?

Më ndjeni që do të nxjerr një sekret, nëpër korridore politike, diplomatike dhe mediatike përflitet se mund të ketë atentate ndaj politikanëve, sepse ky është konflikt civil, apo jo? Pra, do të vriten kandidatë për bashkitë. Pra, po përgatiten celula me snajperë, kështu më tha një gazetar para ca ditësh: “Ore, ata kanë snajperë dhe do t’ju vrasin të gjithë”. Pra, nga buron ky informacion? Cilat janë këto celula? Ku janë këto grupe kriminale, që duan të destabilizojnë Shqipërinë? Ky është një akt shumë i rëndë, në qoftë se është e vërtetë.

Në këtë rast mendoj se duhet të mblidhet menjëherë Këshilli i Sigurisë Kombëtare dhe Komisioni Parlamentar i Sigurisë Kombëtare duhet të thërrasë urgjent ministrin e Brendshëm, drejtorin e SHISH-it dhe t’u kërkojë llogari se çfarë informacionesh kanë për destabilizim më 30 qershor.

Por nuk ka asnjë akt institucional. Vetëm teatër! Ky është krevati juaj teatral, të cilin e

ndani bashkërisht prej vitesh. Ju siguroj se ne, si opozitarë të rinj, nuk kemi dëshirë të hyjmë në krevatin tuaj tresh.

Kryeministri nuk është, por unë po i drejtohem publikisht dhe në emër: Edi, ke vetëm një fije shprese që të rehabilitohesh dhe të hysh në histori, sepse njerëzve u ka ardhur në maje të hundës me këtë mjerim e bataku, ku ka rënë shteti shqiptar; dil nga krevati, bëj një *mea culpa* të sinqertë për vitin 2008, dhe trego se ke këllqe për t'i dhënë fund bajraktarizmit; dil tani këtu, në shesh të burrave, dhe premtë publikisht që je i gatshëm të ndryshosh sistemin zgjedhor dhe të hapësh listat elektorale; zotohu se brenda 28 nëntorit, kur është edhe përfundimi i afatit të Komisionit për Reformën Zgjedhore, ju si grup i Partisë Socialiste do t'i votoni ndryshimet e nevojshme kushtetuese, ndryshimin e Kodit Zgjedhor dhe një ligj të ri për partitë politike, ku e drejta e përfaqësimit të fillojë nga përzgjedhja demokratike e brendshme e partive politike dhe deri tek e drejta e qytetarëve shqiptarë për të zgjedhur deputetin që duan dhe jo listën që do Edi. Propozimet t'i bëjmë ne, pa problem, Taulant, sepse jua bëjmë ne gati, ju thjesht votojini. Mjaft më me letra dashurie për Luljetën, ngeli duke bërë Romeon, çfarë bëhet kështu?! Dashuriçka. Edi, mjaft me flirtime ndaj Ilir Metës, lëre Presidentin të qetë aty ku donte të ishte dhe atje ku ti deshe vetë ta çojë. Edi, mjaft u trembe nga Sali Berisha, ja ku na ke, të pavarur nga çdo lloj linje politike...

Mirëmëngjesi, Kryeministër!

Sa është ora? Ora 12:00. Fantastike, u zgjua Kryeministri!

Edi, po ta përsëris edhe një herë, po të flas në emër dhe me dashamirësi, trego që ke këllqe të ndryshojmë sistemin zgjedhor, që është baza e çdo të keqeje në këtë republikë! Trego se këllqe që t'i japim fund bajraktarizmit!

E thashë edhe më parë, para se të vije, Luigji XIV thoshte: "*L'etat c'est moi*", e kupton vetë në frëngjisht. Nuk ka më bajraktarë në këtë vend që të thonë: "Shteti jam unë". Ja ku na ke, të pavarur e të papërlyer me tendera e pislleqe të së kaluarës dhe, mbi të gjitha, të gatshëm për të ndryshuar sistemin zgjedhor e për të mbështetur plotësisht ngritjen e funksionimin e SPAK-ut brenda këtij viti dhe jo vitin tjetër. Vetëm atëherë, me ndryshimin e sistemit zgjedhor dhe hapjen e listave, ne mund të garojmë të barabartë

në zgjedhje. Unë i siguroj shqiptarët publikisht se ne, jo Edi, do të jemi ata që do t'i çojmë ata të tjerët, që janë jashtë, për skrap. Ne jemi të gatshëm të hyjmë në zgjedhje me një Kod të ri Elektoral. Kjo që ju bëni sot është kot, është teatër, është krevat. Nuk ka vlerë juridike as akti i shfuqizimit të dekretit të Presidentit dhe as kjo rezolutë. Kjo ka vlerë vetëm për ju, sepse, duke bërë cirk e teatër, provokoni sherre të njëpasnjëshme me njëri-tjetrin dhe shqiptarët hipnotizohen e i kthejnë sytë vetëm nga ju dhe harrojnë të gjitha problemet, harrojnë korrupsionin, harrojnë tenderët, harrojnë vjedhjen e pasurisë publike. Ka ish-ministra në këtë sallë që përfliten për korrupsion dhe për vjedhje të pasurisë publike. Ku janë peshqit?! Të mëdhenj jo që nuk ka, por as peshq të vegjël nuk ka në burg.

Kryeministër, askush nuk po ndiqet penalisht. Ju flisni për reformë në drejtësi, por SPAK-u ende nuk është ngritur. Pse nuk ngremë dhe e përshpejtojmë procedurën?! Hajde të marrim një vendim në parlament dhe të përshpejtojmë procedurën e emërimit të prokurorëve në SPAK. Shqiptarët vazhdojnë dhe aplikojnë masivisht për Lotarinë Amerikane, sepse nuk kanë ende besim te drejtësia.

Ju bëni mocion për të qortuar Presidentin, thua sikur ky është halli i shqiptarëve, ndërkohë që ju bashkërisht keni vite që përdhunoni edhe Kushtetutën, edhe Kodin Zgjedhor, edhe votën e shqiptarëve.

Të nderuar kolegë,

Ky parlament nuk mund të jetë as arenë cirku e as sallë gjyqi publik.

Me ndjeni, por është kaq qesharake kjo që po mundoheni të bëni ju sot, sa që unë nuk mund të bëhem dot pjesë e kësaj farse teatrale.

E thashë edhe në fillim, edhe ju, kolegë, e dini, unë kam qenë atje atë ditë kur e keni zgjedhur Ilir Metën President. Kam qenë shumë i mërziur dhe kam qenë kundër Ilir Metës dhe vendimit të tij për të pranuar postin e Presidentit të Republikës, ndërsa ju sot doni ta shkarkoni. Çfarë keni? Pse bëni teatër?! Hajdeni të ndryshojmë Kodin Zgjedhor, bëjmë një ligj për Presidentin, riformatojmë republikën, hapim referendum dhe e bëjmë monarki parlamentare. Do të jetë edhe fjala më seksi në Ballkan: "Kingdom of Albania", është super. Çfarë e duam ne këtë lloj republike?!

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi- Faleminderit, zoti Gjoni!

Fjala për deputetin Ulsi Manja.

Ulsi Manja – Të nderuar kolegë,

Si gjithmonë realiteti politik shqiptar ka aftësinë të prodhojë fenomene, të cilat jo vetëm nuk i gjen në vende të tjera, por janë të një natyre, që u lënë shteg palëve të përfshira për interpretime nga më të skajshmet.

Ajo që vihet re është se në këto interpretime dominant është interesi i grupit, i partisë, por kurrsesi interesi publik.

Debati rreth natyrës së dekretit presidencial, i cili anuloi datën e votimit, 30 qershor, është pikërisht një rast i tillë, ku çoroditja e mendjeve arrin kulmin. Shumë fjalë, shprehje, qëndrime e pozicione me Kushtetutë në dorë e shqiponjë në gjoks po mbahen rreth kësaj çështje. Në të vërtetë po të heqësh nga diskutimet frymën partizane dhe problemi të zhvishet nga lecat e tepërta dhe të reduktohet me terma më të thjeshtë, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë: Cila është natyra juridike e dekretit të Presidentit?! Kjo pyetje nënkupton raportin ndërmjet ligjit dhe politikës. Deri sot ka mbizotëruar elementi politik. Besoj se ju kujtohen tryezat e famshme të partive politike për të zgjidhur ngërçet me natyrë kushtetuese, ku, në fakt, Kushtetuta ekziston për të ofruar zgjidhje në kohë krizash politike. A duhet bërë debat politik rreth një çështjeje kushtetuese, apo debati politik do të mbizotërojë me pikëpamjet e tij, duke përdorur parimet kushtetuese si paterica për të justifikuar pozicionin politik? Kushtetuta, në fakt, është një akt juridik që kuadron zhvillimin politik dhe lojën e të gjitha subjekteve politike. Në këtë binom juridikja është e para dhe e detyron politikën. Në përmbajtjen e deklaratës së Presidentit vlojnë arsytet politike, të sigurisë, integritetit e të tjerë për të mbështetur kushtetutshmërinë e dekretit. Presidenti ka folur njëherësh si aktor kushtetues, si kryetar shteti, si komandant i Forcave të Armatosura, si arbitër mes palëve politike dhe si garantues i unitetit të popullit. Të gjitha këto janë role që i takojnë, por në thelb çështja e dekretit është konkrete dhe e veçantë. Të gjitha këto role, veç aspektit kushtetues, nuk pajtohen mirë me arsyetimin kushtetues. Kjo metodë, ku mobilizohen lloj-lloj faktorësh, me dhe pa natyrë kushtetuese, e errëson çështjen dhe jep zgjidhje të gabuara.

Vlerësimet ekstrakushtetuese janë pronë e autorit që i bën dhe, si të tilla, nuk vlejnë më shumë sesa ato që bëjnë aktorët e tjerë. Atëherë, çfarë natyre ka dekreti i Presidentit?! Kompetenca e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve është normë, ndërsa dekretet, që dalin në zbatim të kësaj kompetence, janë akte individuale. Kjo është e qartë, sepse, përndryshe, do t'i binte që në një dekret Presidenti do të caktonte një datë për çdo proces zgjedhor të ardhshëm, që është absurditet dhe *non sens* juridik. Akti individual për nga natyra e vet nuk varet nga numri i subjekteve të cilave u drejtohet, por nga fakti se veprimi mbaron dhe shteron me zbatimin e tij.

Pas kësaj vjen menjëherë diskutimi rreth vlefshmërisë juridike të dekretit si akt individual nëse është absolutisht apo relativisht i pavlefshëm. Këtu përzihet doktrina kushtetuese dhe administrative. Çfarë natyre ka në vetvete ky dekret?! Ai vendos për një çështje kushtetuese, siç është, në radhë të parë, procesi zgjedhor; zbatim i tij, referuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe subjekteve me natyrë tërësisht administrative. Në një situatë të tillë të jashtëzakonshme vlen parimi kushtetues i shprehur në nenin 4, pika 3, të Kushtetutës, që thotë se dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti.

Të gjitha organet shtetërore, të gjitha institucionet publike, politike, administrative e interpretojnë dhe e zbatojnë Kushtetutën, madje e kanë detyrim këtë.

Edhe parlamenti ka detyrim të mbrojë procesin zgjedhor, duke garantuar një të drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta e votës për qytetarët. Atëherë, organet kushtetuese, që janë të mandatuara me kompetenca në zhvillimin e procesit zgjedhor, kanë të drejtë të mbajnë qëndrimin e tyre. Kriteri i vetëm është vetëm Kushtetuta.

Përveç datës, Presidenti nuk ka asnjë kompetencë tjetër. Në caktimin e datës ai është i detyruar t'i bindet vetëm Kushtetutës. Nuk është argument mungesa në dispozitën e nenit 109, që parashikon afatin për zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor, ajo që thuhet në nenin 65, pika 2, ku përcaktohet llogaritja e afatit për caktimin e datës së zgjedhjeve. Vetë parimi themelor i shprehur në nenin 1, pika 3 të Kushtetutës parashikon natyrën periodike të zgjedhjeve. Në

të kundërt, po të vazhdojmë me shtyrje datash, do të rezultonte, siç ka rezultuar në disa raste, që mandatet të zgjaten deri në 2-fishin e tyre, gjë që është anomali thelbësore kushtetuese.

Përmenda se kompetenca e Presidentit në caktimin e datës së zgjedhjeve përfundon me një dekret individual. Çdo lëvizje e datës jashtë kuadratit kushtetues është kompetencë substanciale, e paautorizuar nga Kushtetuta. Është e tillë, sepse ajo futet në themel të zgjedhjeve politike sipas konsideratave politike, gjë që Presidentit nuk ia jep asnjë parim, asnjë normë kushtetuese.

Të thuash që një akt juridik mund të revokohet, kjo është një e vërtetë thjesht formale, por revokimi ka kufi dhe kushte. Një akt administrativ mund të revokohet, dhe në këtë rast zgjidhen pasojat.

Po çfarë pasojash zgjidhen me zhdekretimin? Janë përmendur shumë argumente dhe arsye nga Presidenti, por të gjitha janë hipotetike ose me karakter ekstrakushtetues, janë thjesht bindja e tij, ndërsa procesi zgjedhor ka filluar, madje është në finishin e tij. Që nga ky moment të gjitha lëvizjet, detyrat, kompetencat u kanë kaluar me Kushtetutë institucioneve dhe subjekteve zgjedhore sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Ndërhyrja e një aktori të jashtëm në këtë procedurë që u takon organeve të tjera, është tërësisht e pavlefshme.

Thonë se Presidenti e ka në dorë datën e zgjedhjeve dhe shtyrjen e saj sipas konsideratave administrative. Po pse nuk thonë se në rastin konkret, zhdekretimi ka fuqi prapavepruese? Zhdekretimi asgjëson gjithçka që organet e tjera kanë ndërmarrë në bazë të dekretit që caktoi datën 30 qershor. Ky akt i Presidentit duket sikur synon të ardhmen, por në fakt synon të asgjësojë të shkuarën. Pavlefshmëria e zhdekretimit është evidente për të gjitha arsyet që përmenda pak më sipër, pra është një nulitet, është një pavlefshmëri absolute. Këtu kemi të bëjmë me një akt të paqenë. Prandaj, zgjedhjet janë më 30 qershor. Çdo shmangie nga kjo datë është shmangie nga zbatimi i Kushtetutës.

Tani më lejoni të nderuar kolegë, meqë jam në sekondat e fundit...

Gramoz Ruçi – Ju ka mbaruar koha, zotëri.
(*Bie gongu*)

Fjalën e ka Kryeministri Rama!

Edi Rama - Ky Kuvend sot duhet të kalonte një rezolutë konsensuale, në vigjilje të debatit mes vendeve anëtare të Bashkimit Europian për çeljen ose jo të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Ky Kuvend sot duhet të ishte Kuvendi i bashkimit dhe i opinionit të njëzëshëm të të gjitha forcave politike, për të tërhequr në emër të popullit shqiptar, të kombit shqiptar, vëmendjen e të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Ky Kuvend sot duhet t'u drejtohej me një rezolutë të gjitha atyre shteteve, për t'u kërkuar as më shumë e as më pak se sa njohjen e meritës së Shqipërisë në përmbushjen e kushteve të vëna prej tyre dhe miratimin e rekomandimit pa kushte të Komisionit Europian për çeljen e negociatave.

Fatkeqësisht dhe jo rastësisht, ky Kuvend sot është i detyruar të merret me një akt brutal, transgresiv, të papërgjegjshëm dhe të patolerueshëm të Ilir Metës.

E pyes shpesh veten: çfarë kërkon më shumë Ilir Meta nga Shqipëria? Kujt i ka bërë Shqipëria më shumë ndere, sesa këtij njeriu, të cilin, pa mbushur ende 50 vjeç, e ka bërë si askënd tjetër në histori, edhe Kryeministër, edhe Kryetar Kuvendi, edhe President të Republikës?

Kujt më shumë se Ilir Metës i janë falur përçarjet, hiletë, skandalet dhe i është dhënë kaq e kaq herë mundësia të rilindë, i penduar, i burrëruar, i kthjelluar?

Kujt përpara Ilir Metës i takon të pyesë veten: çfarë mund të bëj që t'ia laj sadopak Shqipërisë detin me borxhe që i kam, që t'ua laj sadopak shqiptarëve pa dallim, llumin me borxhe që u kam; që t'ua laj sadopak socialistëve dhe zgjedhësve të mi, borxhet e të gjitha moteve dhe rasteve, kur më kanë mbështetur në përpjekjet e mia dhe më kanë toleruar për zararet e mia?

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Gramoz Ruçi – Zoti Maliqi, mos ndërhyini! Ndalohej rreptësisht! Ndryshe, dilni jashtë!

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Edi Rama - Natyrisht, këto janë pyetje retorike.

Historia e shtetit shqiptar nuk e gjen një politikan të dytë me të cilin Shqipëria të ketë qenë kaq zemërgjerë. Si të tilla, këto pyetje retorike na çojnë edhe te përgjigjja për pse-në e

rrëshqitjes më të fundit të Ilir Metës. Iliri është mësuar keq, si s'ka më keq, ta tundojë Zotin e tij, ta përqeshë fatin e tij, ta shkelmojë të mirën e tij, duke u bërë me vend e pa vend protagonist i një skene, ku Metës asnjëherë nuk i mjafton roli që ka, vendi ku ndodhet, maja ku ngjitet.

Jo President të Republikës, por mbret të të gjithë shqiptarëve po ta shpallnin shqiptarët, madje jo vetëm të Shqipërisë, por të të gjitha trojeve dhe viseve shqiptare, prapëseprapë Ilir Meta nuk do ndihej mirë, nuk do qëndronte drejtë, nuk do ndalej së tunduari fatin e vet, me pakënaqësitë e tij të pashërueshme, me pangopësinë e tij të pashpjegueshme, me pagjumësinë e tij të pangushëllueshme. Sot ne jemi këtu dëshmitarë të një tjetër zarari të madh dhe të kotë, të dëmshëm e të papranueshëm të Presidentit të Republikës.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Gramoz Ruçi – Zoti Gjuzi, ju tërheq vëmendjen! Mos ndërhyri nga vendi.

Edi Rama - Për cilën arsye në botë Presidenti i Shqipërisë duhet të bashkohej me zjarrvënësin dhe telashin e saj historik, Sali Berishën, në përpjekjen e dëshpëruar të këtij të fundit për të ridjegur dhe bërë lëmsh Shqipërinë? Për cilën arsye në botë Presidenti i Shqipërisë duhet të merrte përsipër shkeljen më skandaloze të Kushtetutës përmes fshirjes së firmës së tij me vetë firmën e tij? Për cilën arsye në botë Presidenti i Shqipërisë duhet të bëhej një trillues qesharak shkaqesh të paqena, për të justifikuar një budallallëk që do të shënohet si rast unikal në historinë e republikave parlamentare të planetit tonë?

Ka vetëm një arsye që i shpjegon të gjitha me dy fjalë: Ilir Meta. E gjitha në këtë rast përfshihet në këto dy fjalë: Ilir dhe Meta. Të kërkojë jashtë këtyre dy fjalëve shkaqet e kësaj marrëzie antikushtetuese është e tepërt, por, sidoqoftë, kjo punë që po bëjmë sot e kërkon që t'u shpjegohemi shqiptarëve, por edhe miqve e partnerëve tanë ndërkombëtarë se si e qysh erdhi puna deri në këtë pikë vlimi në kazanin e jetës sonë politike.

Pse u përdor, keqpërdor apo vetëpërdor (pak rëndësi ka kjo) Presidenti i Republikës duke kapërcyer mbi Kushtetutën dhe duke fluturuar përtej kufirit të imagjinatës si një plumb qorr, për të vrrarë zgjedhjet në mes të fushatës së zgjedhjeve, dhe pse ne nuk e shfrytëzuan

mundësinë që na dha kjo marrëzi antikushtetuese për të ndaluar fushatën dhe prituri, si gomari që të mbijë bari, ditën kur do t'u mbushej mendja partive të Saliut dhe të Ilirit për të pasur një datë të re zgjedhjesh?

Le të fillojmë nga e dyta, se kështu shpjegojmë më lehtë dhe më mirë të parën. Po e filloj nga vetja.

Meqë bëhet një përpjekje e madhe tribunë më tribunë, kanal më kanal, portal më portal, për të m'i faturuar mua zgjedhjet pa kundërshtarët kryesorë e për ta devijuar krejt logjikën e kësaj që po ndodh, duke e trajtuar si pasojë të kokëfortësisë, autoritarizmit, çmendurisë, madje deri edhe të një qëllimi të fshehtë, djallëzor për të provokuar një konflikt civil në Shqipëri, po e filloj me një pyetje për të gjithë ata që duan të logjikojnë mbi këtë situatë sa të qartë, aq edhe konfuze, sa të lidhur me interesat e një grushti njerëzish, aq dhe të pandashme nga interesi kombëtar dhe publik, sa të kuptueshme, aq edhe absurde: Çfarë interesi vetjak, ngushtësisht personal, politik, kam unë që të jem kaq i patundur dhe i patundshëm nga bindja se kjo nuk është koha për asnjë kompromis, por është koha për fushatë për zgjedhjet e datës 30 qershor?

Këto zgjedhje janë vendore. Partia Socialiste në rang vendor qeveris pothuajse 75% të territorit të vendit dhe drejton pothuajse të gjitha bashkitë kryesore. Shumica jonë parlamentare është solide dhe mbështetja e saj për mua dhe qeverinë është e palëkundur dhe e palëkundshme. Qeveria ka 1001 probleme dhe çështje për të adresuar, ekonomia goditet nga ky tension i lartë artificial, turizmi dëmtohet, besimi i investitorëve po ashtu, qetësimi i situatës, duke shfrytëzuar qoftë edhe skandalin e zhdekretimit të zgjedhjeve, duket si gjëja më e lehtë. Atëherë, për çfarë më duhet mua personalisht, meqë shumëkush preferon të më drejtohet personalisht, një dhimbje jo e vogël koke, si ecja në këto kushte jo normale, drejt, përpara, në rrugën e 30 qershorit, kur nuk kam asnjë lloj interesi të ngushtë, pragmatist, të kthehem në pengesë për qetësimin e kësaj situatë dhe asnjë pengesë në rrugën e qeverisjes sikur zgjedhjet të shtyhen qoftë edhe në pafundësi. Madje-madje, po të isha ngushtësisht i interesuar, për mua personalisht, për rehatinë dhe për karrigen time, por edhe për qeverinë tonë, unë duhej të isha i pari që do të hidhesha përjetë nga gëzimi që Presidenti i

Republikës lëshoi një re kaq të madhe nga pantallonat për datën e zgjedhjeve. E quaja një shpërthim gjenialiteti politik, laja dhe lanim duart me procesin zgjedhor, duke thënë “bravo, zoti President, absolutisht dakord dhe punë e madhe se ne nisëm fushatën me firmën tuaj, çfirma juaj na e hoqi dhimbjen e kokës, prandaj e lëmë këtë punë, këtu jemi, i bëjmë zgjedhjet kur të bien të tërë dakord”. Ose edhe e kundërta, ia lija fajin Ilirit për ndërprerjen brutale të fushatës, duke i thënë “jazëk të qoftë, zoti President”, ngrija duart lart përpara shqiptarëve, u zhdruk data e zgjedhjeve nga horizonti dhe dilja si një burrë i urtë, i pafajshëm, në një lojë marrëzie politike.

Kështu, me thënë të drejtën, për ta çuar deri në fund absurdin, sikur të isha siç dal te filxhani i fallxhore, apo te katrani i plakut dixhital, shpëtoja edhe unë bashkë me Partinë Socialiste nga zgjedhjet e tjera të mëtejshme, sepse me këtë budallallëk, të kthyer në precedent, na jepet mundësia të themi nesër, nuk duam zgjedhje vendore, se ashtu e kemi një punë, madje as zgjedhje të përgjithshme, sepse kemi informacione të sigurta nga disa burime, që nuk i themi dot, për një sulm bërthamor ndaj Shqipërisë.

Kështu që, përderisa zgjedhjet nuk u bëkan po nuk deshi një palë, nuk bëhen kurrë. Mirëpo, shtetet demokratike kanë kushtetuta dhe ligje, nuk funksionojnë përveçse me parimin e barazisë së të gjithëve para ligjit. Prandaj këto lloj aventurash mendore nuk mund të kthehen në veprime politike dhe t'i imponohen një populli të tërë për hesap të njërit apo të tjetrit. Sot hidhet përjetë një grup, nesër hidhet përjetë një tjetër dhe kështu alla shqiptarçe, ky viti i mbrapshtë kadarejan kthehej pa asnjë pengesë në një dekadë të mbrapshtë bastesh politike, duke e bërë Shqipërinë skenën ku e ardhmja luhej si te “Kumarxhiu” i Dostojevskit.

Dikush mund të thotë, fatkeqësisht e thonë jo pak njerëz që marrin përsipër të shpëtojnë Shqipërinë me recetat e tyre politike mediatike, si 1001 mbrapshtitë e Oliver Tuistit, që ne nuk është se e kemi respektuar aq shumë Kushtetutën dhe ligjet, sa të jemi tani kaq të ngurtë për t'i zbatuar, le t'i biem dhe një herë shkurt, siç i kemi rënë 30 vjet, duke hapur përsëri një shteg jashtë rrugës kushtetuese dhe të ligjit, për të ulur tensionin e lartë, pajtuar gjaqet e nxehura dhe

shpëtuar Shqipërinë nga konflikti civil, nga vrasjet e njerëzve të pafajshëm, nga një '97-të tjetër dhe me radhë. '97-të tjetër? Po pse? Çfarë ka ndodhur ndonjë gjë e ngjashme me '97-ën, që tani duhet t'i frikemi, madje të kthehemi mbrapsht dhe të ikim me vrap në të kaluarën, që të na përsëritet një '97-të tjetër? Cilat skema piramidale po bien dhe kursimet e kujt? E gjakut dhe djersës së kujt po digjen, që të digjet Shqipëria si në '97-ën? Në cilat qytete po shfaqen shenjat e kryengritjes popullore për ndonjë hall aq të madh sa ai i '97-ës dhe në cilat depo armatimesh NATO-ja do të hapë dyert për të armatosur shqiptarët kundër njëri – tjetrit? I kujt është xhanëm tamam halli që nxjerr prej muajsh në protesta popullin imagjinat të bashkive blu dhe të ndërmarrjeve të tyre të pastrimit, gjelbërimit, të ujësjellësve, bashkë me grupe të rinjsh me maska, që gjuajnë me molotov, e me kapsolla dhe me fatkeqë që vijnë të ngarkuar dhe urinojnë në derën e Kryeministrit?

Edhe këto janë pyetje retorike natyrisht, por përpara se të vijmë tek halli i madh dhe i vërtetë që ka zallamahisur opozitën e dalë në rrugë, në orvatjen më të dëshpëruar të historisë së ngatërruar të këtyre 30 vjetëve, për të zallamahisur krejt Shqipërinë, dua të bëj sa më të qartë pse ne nuk ka asgjë që na tund nga 30 qershori, pse ne jemi të detyruar ta pranojmë si të keqen më të vogël për demokracinë tonë të re, zgjedhjen fatale, të gabuar, të kundërshtarëve tanë për të na lënë në garën zgjedhore me një kandidat në pjesën më të madhe të bashkive të vendit.

Pse ne, nëse do të tërhiqeshim nga ky proces, në emër të të gjithë atyre arsyeve, që në pamje të parë duken të mirëkuptueshme kur renditen për të argumentuar shtyrjen e zgjedhjeve, do të merrnim përgjegjësinë historike të pranimit të së keqes më të madhe të mundshme, duke i vënë minat shtetit, bazës së rregullave të bashkëjetesës demokratike dhe vetë demokracisë sonë në zhvillim.

Duke shkuar në zgjedhjet e 30 qershorit, me këtë dhimbje koke që ka shkaktuar arratisja e opozitës kryesore nga parlamenti dhe nga vetë zgjedhjet, ne sigurisht që nuk garantojmë dot larminë e plotë pluraliste të produktit të zgjedhjeve. Me shumë gjasa, produkti i këtyre zgjedhjeve do të jetë një hartë elektorale thuajse

100% e purpurt, në rast se nuk do të ketë ndonjë surprizë tek apo tuk, por kjo nuk do të ndodhë, sepse jemi ne që nuk duam të garantojmë larminë e plotë pluraliste të zgjedhjeve, as sepse nuk na pëlqen neve që të ketë garë në çdo bashki dhe as sepse ne po kurorëzojmë ndonjë plan totalitarist asgjësimi të pluralizmit. Nuk është plani ynë ky, kurrësi!

Ky është plani i tyre dhe ne nuk kemi në dorë asgjë tjetër, përveçse ta pranojmë realitetin siç është, duke mos rënë në asnjë mënyrë në kurthin e dritëshkurtësisë fatale të sugjestionimit nga meraku se qëndrimi në proces na bën bashkëfajtor me ta për shkak të produktit njëngjyrësh të këtyre zgjedhjeve pa konkurrentë. Jo, aspak.

Përkundrazi, ne jemi thjesht viktimë e zgjedhjes së lirë të kundërshtarëve tanë kryesorë për të braktisur garën dhe e keqja e këtyre zgjedhjeve të pamohueshme nuk buron nga dëshira jonë, por nga qëllimi i atyre që duan të vrasin zgjedhjet, për ta kthyer humbjen e tyre të paralajmëruar në një fitore kundër Shqipërisë, që pret çeljen e negociatave me Bashkimin Europian.

Akti i Ilir Metës është prova më ulëritëse e lepurit që fle në barkun e frikës, jo vetëm nga zgjedhjet, por në radhë të parë nga drejtësia.

Ne jemi të dënuar ta marrim përsipër këtë kosto të krijuar prej tyre, për të mos lejuar që kostoja t'i kalojë Shqipërisë, së kushedi sa viteve të ardhshme.

Zgjedhjet e 30 qershorit pa ata janë e keqja më e vogël për Shqipërinë, ndërsa shtyrja e këtyre zgjedhjeve, për shkak se ata nuk janë në zgjedhje, do të ishte një e keqe e madhe, me efekt të zgjatur mbi Shqipërinë. Pse? Sepse në emër të shmangies së një palë zgjedhjeve, në këtë problem të pashmangshëm, ne do të ligjëronim faktin që kushedi për sa vite zgjedhjet të mos ishin më e drejta e popullit për të gjykuar dhe detyrimi i partive për t'iu nënshtruar gjykimit të popullit, por e drejta e partive për të vendosur kur bëhen zgjedhjet dhe detyrimi i popullit për t'iu nënshtruar tekave të partive.

Kjo që po ndodh, në fakt, nuk është as e pandodhur, as e papritur në historinë tonë të trazuar të zhvillimeve demokratike, madje kjo është seria e dytë e filmit që ka filluar dy vjet më parë. E mbajnë mend që të gjithë, kur të njëjtët njerëz, të udhëhequr nga i njëjti zjarrvënës dhe

përçarës i këtyre 30 vjetëve demokraci, Sali Berisha, dhe drejtuar nga i njëjti llafazan dembel, Lulzim Basha, ikën nga parlamenti për të mos votuar vetingun dhe u mbyllën në një bunker plastmasi poshtë dritareve të zyrës sime, me të njëjtin avaz “nuk hyjmë në zgjedhje”, “nuk dialogojmë pa ikur Kryeministri”, “nuk do të lejojmë të bëhen zgjedhje” dhe me radhë të gjitha strofat e së njëjtës këngë, nga e njëjta pllakë gramafoni, “*La voce del Padrone*”.

E mbajnë mend të gjithë, besoj, se sa shumë i jam lutur Lulzim Bashës për dialog, mirëkuptim, marrëveshje dhe se si u bë në minutën e fundit marrëveshja. Mori gjithçka kërkoi, me kusht që të dilnin nga bunker i plastmasit, të ktheheshin këtu, të votonin vetingun, të mos kontestonin rezultatin e zgjedhjeve dhe të mos shanin më Shqipërinë në gjuhë të huaj.

Nuk e di, a e mbajnë mend që të gjithë, gjithashtu, se i shtymë zgjedhjet me atë marrëveshje vetëm për 1 javë, brenda afatit që Kushtetuta i lejon Presidentit të Republikës, bazuar në Kodin Zgjedhor të Republikës. Edhe atëherë u kërkua të shtyreshin përtej afatit, madje miqtë ndërkombëtarë që u përpoqën të ndërmjetësonin ishin të gjithë dakord me këtë, Shqipëri hesapi, por unë isha kategorikisht kundër dhe nuk lëviza nga pozicioni deri në fund, sepse isha i bindur, siç jam edhe sot akoma më i bindur, se kur politikanët i lejojnë vetes shkelje të tilla në emër të gjoja mirëkuptimit mes tyre, humbet populli, humbet demokracia, humbet shteti i së drejtës dhe shkelja kthehet nga një gjoja përjashtim për një rast të jashtëzakonshëm, në një rregull që bëhet i zakonshëm.

Ja, urdhëroni tani, është e thjeshtë! Nëse do ta kisha pranuar atë shkelje para dy vjetësh, sot përsëritja e shkeljes, shtyrja e zgjedhjeve për tekat e një pale politike as që nuk do të diskutohej si një e drejtë e çdo pale politike kundër të drejtës së popullit sovran, për të zgjedhur në afatin e përcaktuar nga Kushtetuta dhe të sanksionuar në ligjin e zgjedhjeve. Politikanët nuk janë as mbi Kushtetutën, as mbi ligjin dhe as mbi shtetin. Nëse duam të bëjmë shtet të së drejtës në këtë vend, kurrë s'mund, dhe unë sa të jem këtu kurrë nuk do ta pranoj, që ata politikanë, partitë e tyre, veç e veç apo të gjitha bashkë, ta kthejnë detyrimin e çdokujt për

t'u zgjedhur nga populli në të drejtën e tyre për të vendosur se kur populli mundet dhe kur populli nuk mundet që t'i zgjedhë ata. Ndërsa Presidenti i Republikës jo vetëm që s'mund ta heqë të drejtën popullit të zgjedhë në afatet që Kushtetuta dhe ligji ia japin fjalën popullit sovran, por s'ka të drejtë të vendosë asgjë, zero në këtë mes, përveç asaj që i thotë Kushtetuta dhe asaj që i tregon Kodi Zgjedhor. Ka dy data, zgjidhni një nga të dyja dhe për ato të dyja konsultohuni me partitë politike.

Dy vjet më parë, kur arritëm marrëveshjeje me Lulzim Bashën dhe ramë dakord për shtyrjen me vetëm një javë të zgjedhjeve, paraardhësi i Ilir Metës, Bujar Nishani, na e kërkoi me shkrim dhe me firma në një shkresë dakordësinë për atë shtyrje një javë brenda afatit kushtetues, e cila u krye vetëm pasi shkoi letra e bashkëfirmosur te Presidenti, sepse e vërteta duhet thënë edhe kur mund të mos na vijë për mbarë.

Bujar Nishani nuk interpretonte Kushtetutën sipas dëshirave apo nevojave të partisë, të cilës sado që i shkonte hera-herës pas avazit me deklarata dhe prononcime krejt të anshme dhe deri edhe skandaloze, asnjëherë nuk e vuri Kushtetutën dhe firmën e tij në dispozicion të axhendës politike të asaj partie. U desh të bëhej President Ilir Meta që edhe vetë Bujar Nishanin, Presidentin më partiak dhe më mediokër që ka pasur ky vend, ta kujtojnë sot për mirë në raport me bazën kushtetuese dhe ligjore të dekreteve të tij.

U desh të bëhej President Ilir Meta, që libri i historisë botërore të demokracisë të pasurohej me nocionin befasues të "zhdekretimit" dhe ai i historisë botërore të shtetit të përfshinte në faqet e veta aktin e shfirmosjes.

Unë firmos, unë shfirmos. Domethënë, u desh të bëhej President Ilir Meta, që jo vetëm fjalët t'i marrë era, por dhe firmat të ikin sipas erës. U desh të bëhej President Ilir Meta, që historia e filozofisë botërore të përballej me një zbulim filozofik befasues për njerëzimin, atë të konsensusit mes palëve të arritur te një njeri i vetëm mbi bazën e këmbënguljes të palëve për të mos rënë dakord.

Të gjithë filozofët grekë, jam i sigurt, janë rrotulluar në varret e tyre, kur u ka shkuar fjala për këtë kategori të re të konsensusit. Kjo është vërtetë na shtangësh historinë, demokracinë, filozofinë, duke ngritur absurdin si shtangë me

një shtytje të fortë të logjikës njerëzore dhe të kulturës ligjore përtej çdo caku të vendosur deri këtu me konsensusin e atdheut dhe të njerëzimit. Kështu, vijmë te pyetja kryesore që shtrova në fillim. Pse vallë Ilir Meta e bëri këtë ndërhyrje të hatashme, antikushtetuese dhe antilogjike?

Nuk është thjesht një kërcënim për republikën parlamentare, është kërcënim për logjikën njerëzore; nuk është nën sulm vetëm republika parlamentare, është nën sulm logjika njerëzore. Mu në mes të procesit zgjedhor, kur fushata kishte nisur, e bëri tamam atë ditë kur qeveria e Shteteve të Bashkuara kishte dënuar publikisht përmes një deklarate krejt të pazakontë dhunën, bojkotin e zgjedhjeve, kërcënimin për pengimin e tyre, duke treguar me gisht dy persona: Lulzim Bashën dhe Monika Kryemadhin, si përgjegjësit për gjithçka që do të ndodhte në protestën e 8 qershorit dhe më pas. Disa mendojnë se ai ndërhyri me lajmërimin publik të antidekretit të tij për të shpëtuar fytyrën e revolucionit imagjinar të Lulzim Bashës dhe të Monika Kryemadhit, ku, siç tregoi masa e tkurrur e protestuesve në bulevard, revolucionin po katandisej si kokoshi një thellë dhe prurjet e ujësjetllësve të bashkive blu po shteronin.

Të tjerë mendojnë se Ilir Meta e zhbëri firmën e tij si të ishte një mbetje kafeje e fshirë me gisht në fundin e filxhanit në kërkim të fatit, për të projektuar të ardhmen e tij të afërt në krye të opozitës, duke e turbulluar situatën në një pasdite me një goditje më shumë sesa kishte arritur ta turbullonte Lulzim Basha me tërë gurët, kapsollat, fishekzjarrët, molotovët dhe notat e ngjirura të himnit kombëtar përgjatë tërë mbrëmjeve revolucionare të opozitës. Mund të jenë të dyja të vërteta këto, madje mund të jetë e vërtetë edhe në këtë rast, siç thotë Jacques Lacan: "I marrë nuk është vetëm fukarai që kujton se është mbret, por edhe mbreti që kujton se është mbret".

E thashë pak më lart, por po e shtjelloj më shumë tani. E vërteta e dalë cullak nga ky akt marrëzie, befasues është se veprimi i Ilir Metës nuk ishte një rrufe në qiell të pastër, por një hap spektakolar në vazhden e një plani politik për të marrë peng jetën demokratike të vendit dhe për të minuar rrugën e negociatave për anëtarësim në Bashkimin European. Nëse në aventurën e tyre mendore, e cila ka patjetër shumë elemente, që

ngajjnë si ndërthurje e “Klubit të Selanikut” të Çajupit me “Pavijonin numër 6” të Çehovit, dy frymëzuesit dhe orkestruesit të këtij plani, Sali Berisha dhe Ilir Meta, kujtojnë vërtet se mund të më largojnë mua nga detyra me molotovët e Lulit dhe me mallkimet e Monikës, e ka gabim. Këta dy të shkretët, që i kanë hyrë detit në këmbë, janë thjesht instrumente në duart e dy të parëve.

Këta besojnë vërtet se mund të marrin pushtetin me kapsolla dhe me magjira, ndërsa dy ustallarët e rrëmujës dhe të intrigave e kanë qitjen më të largët. Unë jam shënjestra që duket, koka që i duhet ofruar turmës për ta frymëzuar dhe për ta sjellë të ndërkryer në bulevard, iluzioni, që i duhet artistit dhe fallxhores për të qenë të qenë të motivuar dhe të palodhur në orvatjen e tyre qorre.

(Bie gongu)

Taulant, të lutem, më jep edhe disa minuta!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Faleminderit!

Ndërsa preja e kërkuar në këtë gjah politik nuk jam unë, është Shqipëria, që duhet ndalur përpara sesa të kapërcejë pragun e negociatave me Bashkimin Europian dhe të hapë, sapo të kapërcejë pragun aty, dy kapitujt e parë të bisedimeve, të cilat, për dreqin e mallkuar, janë kapitujt e drejtësisë. Duke hapur kapitujt e drejtësisë, Shqipëria duhet t'i provojë Bashkimit Europian se reforma në drejtësi nuk është vetëm një maket arkitektonik me letrat e Kushtetutës dhe të ligjeve të sistemit të ri të drejtësisë; nuk është vetëm një mekanizëm i pastrimit të sistemit të drejtësisë nga gjykatës dhe prokurorë të korruptuar, por është një shtet i së drejtës, ku qoftë gjykatësit dhe prokurorët e kapur me presh në duar nga vetingu, qoftë politikanët e korruptuar dhe të paprekshëm prej 30 vjetësh mund të këputen si pras nga goditjet ndëshkimore të drejtësisë së çliruar nga kthetrat e tyre.

Plani është i qartë, dhe duhet thënë se nuk është një plan budalla jo vetëm për mbijetesën politike të atyre që e kanë konceptuar dhe po e zbatojnë, duke goditur pa asnjë mëshirë, jo mua, jo ne, që jemi mbështetësit dhe garantuesit e palëkundur të reformës në drejtësi, patjetër edhe ne, por vetë Shqipërinë dhe shpresat e shqiptarëve, përfshirë dhe ata që u shkojnë pas këtyre të paudhëve, duke kujtuar komplet

gabimisht se do të rrëzojnë qeverinë dhe se Luli dhe Mona do të ndëshkojnë krimin, do të shfarosin korrupsionin, do të shpartallojnë padrejtësitë, ndaj të cilave thonë se janë ngritur në një luftë pa kthim.

Pjesë e këtij plani ishte dhe publikimi në tabloidin e famshëm gjerman i përgjimeve, që ishin të kyçura prej shumë kohësh, pa u hetuar nga një shërbëtor famëkeq i mirënjohur i Saliut në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Ushqimi i duhur në kohën dhe në vendin e duhur për këdo në atë botë, që për arsyet e veta, jo të Saliut dhe Ilirit, nuk e do zgjerimin e Europës, nuk e do çeljen e negociatave me Shqipërinë, por edhe ushqim i bollshëm për çiftet e çiftit të papërgjegjshëm dhe qesharak “Luli- Mona”, të cilët, ruana Zot, kanë marrë përsipër shpëtimin e kombit me doçkat e tyre të pastra dëborë.

Ilir Meta dhe Sali Berisha nuk e duan, në fakt, shtyrjen e zgjedhjeve, por duan kaos në jetën institucionale të vendit dhe synojnë shthurjen e shtetit. Ata duan ta nxjerrin procesin demokratik nga shinat, siç e nxorën nga parlamenti opozitën e drejtuar nga dy kukullat e tyre. Ata kërkojnë me çdo kusht që ta bëjnë Shqipërinë një shesh për përsheshin e tyre, era e të cilit josh njerëz të dëshpëruar, të pakënaqur, të mërzhitur, që janë në të drejtën e tyre absolute të duan largimin e qeverisë; janë në të drejtën e tyre legjitime të shpresojnë ikjen time një orë e më parë; janë në të drejtën e tyre të ëndërrojnë një Shqipëri të qeverisur ndryshe, nga të tjerë njerëz, nga parti të tjera.

Njëkohësisht ata, Sali Berisha dhe Ilir Meta, kërkojnë me çdo mënyrë nëpërmjet mashave të tyre ta bëjnë ndërkombëtarisht Shqipërinë të duket një vend, ku po bëhet nami i zi nga populli i ngritur kundër një narkoshteti dhe të sigurojnë me gjithfarë shpifjesh dhe intrigash krijimin e një mase kritike kundërshtarësh të çeljes së negociatave. Në vend që Shqipëria të mendojë dhe të luftojë për të kapur trenin e vitit 2025, kur dyert e Europës, që ne duam, mund të çelen për anëtarë të rinj, ata duan të sfilitet dhe të trembet, duke menduar makthin e vitit 1997.

Ja pse, shumë i nderuar Kuvend i Shqipërisë dhe të dashur bashkëqytetarë kudo ku jeni, antidekretoi i Ilir Metës është një arsye më shumë dhe jo më pak, një arsye shumë e fortë, për t'i bërë zgjedhjet më 30 qershor, për t'u dalë

përballë frontalisht këtyre katër aventurierëve, që duan të ndalojnë shtetbërjen shumë të mundimshme të këtij vendi dhe ta katandisin këtë vend njëlloj si vetveten.

A doni ta dini se si do të ishte Shqipëria e tyre? Shikojini ata! A doni që Shqipëria t'u ngajjë atyre të katërve? Nuk besoj!

Ne duhet të ecim jo për t'u dalë zot zgjedhjeve vendore, ato janë thjesht pengu që kërkohet të kapet për të negociuar një funeral konsensual të drejtësisë, por për t'i dalë zot Shqipërisë që pikërisht politikanë si këta e kanë damkosur historikisht jo vetëm në këta 30 vjet, por shtojeni sa të doni, si vendi që nuk bëhet.

Ata janë në hall, në një hall aq të madh sa është e madhe e tërë kjo aventurë e tyre kundër Shqipërisë dhe duan që tani halli i tyre të kthehet në problemin e gjithë shqiptarëve, të cilët të lodhur me plot të drejtë nga politika, të neveritur me plot të drejtë nga paprekshmëria e këtij soji politikanësh, që i kanë lejuar vetes gjithçka, duke e hedhur lumin pa u lagur gjithnjë, të pakënaqur me plot të drejtën e Zotit dhe me gabimet me vonesat tona në qeverisje, të thonë “aman, varja së ardhmes, por, të paktën, na lini rehat të tashmen. Merruni vesh si të doni, po veshët aman mos na i çani më se ky vend kështu e paska pasur fatin dhe ky popull kështu e paska pas taksirat”.

Por jo. Jo dhe jo. Kurrsesi jo. Unë njëherë, jo, asnjëherë nuk do të dorëzohem as si Kryeministër jo e jo, por as si qytetar i thjeshtë i këtij vendi nesër, duke e pranuar si fatalitet maskarallëkun, pisllekun, hajvanllëkun, dhe pazarllëkun e trashëguar nga dorëzimi në dorëzim, përballë të keqes që e ka ngrënë këtë vend si kancer për vite, dhe për dekada të panumërueshme. Sikur unë të mos besoja te Shqipëria, sikur të mos besoja tek e drejta e fëmijëve tanë, të gjithë fëmijëve, fëmijëve të socialistëve, të demokratëve, kushdo qoftë, për të trashëguar një vend më të mirë se ky që ne trashëguam nga ata që e trajtuan Shqipërinë si plaçkën e tyre, për asnjë sekondë nuk e jap dorëheqjen, asnjë sekondë, me gjithë breshërinë e baltës inkuizicionale që më shoqëron në çdo hap.

Unë e kam votuar Ilir Metën si President i Republikës së Shqipërisë. Gjithkush në këtë sallë që ishte njësoj si dhe unë këtu, kur Ilir Meta u zgjodh President, ka bërë të njëjtën gjë.

Shumëkush më ka kritikuar në rrjetin social, vazhdimisht më “zhdëpin” për zgjedhjen e tij, jo pak më kanë mallkuar dhe sa shfaqet Iliri me ndonjë nga paudhësitë e veta, më përvishen mua të gjithë.

Nuk jam penduar. Po të ktheheshim mbrapa në kohë, do të bëja po të njëjtën gjë.

Për shumë arsye, që nuk është ky rasti t'i rendis, ky është rasti për t'u kujtuar të gjithëve se Ilir Meta u zgjodh President me votat e tij dhe votat tona mund ta pengonin zgjedhjen e tij, por votat nuk mjaftonin për të zgjedhur një president pa Ilir Metën. Këtë është mirë ta kujtojnë të gjithë.

A e kam imagjinuar unë kur e zgjedhëm se Iliri do ta kthente humbjen e tij karakteristike dhe ciklike të vetëkontrollit, nga një fenomen sporadik, në një mjet sistematik për të çoroditur sistemin tonë kushtetues dhe për të udhëhequr një plan çoroditës të orkestruar bashkë me Saliun në dëm të Shqipërisë? Jo. Këtë jo, nuk e kisha imagjinuar.

Kjo ka kaluar përtej çdo imagjinate të arsyetueshme dhe prandaj nuk mund të tolerohet. Ilir Meta e ka humbur të drejtën të qëndrojë në zyrën e Presidentit me pëlqimin tonë. Shqipëria është një republikë parlamentare dhe presidenti i kësaj Rrepublike është garant i unitetit kombëtar, jo interpretuesi subjektiv i Kushtetutës në funksion të sulmeve kundër Republikës sonë parlamentare dhe të qëllimeve të mbrapshta politike të kujtudo qoftë. Lere pastaj qëkur qëllimet e mbrapshta janë edhe të tijat. Një President që argumenton një marrëzi antikueshtuese si anulimin e zgjedhjeve në mes të fushatës, sikur shef filxhan me data gjëmash dhe me rrugë gjarpëruese fjalish pa kuptim dhe që kur e pyesin përgjigjet “ma përsërisni se nuk dëgjoj mirë, këto kohët e fundit kam qenë i sëmurë”, është sidoqoftë një njeri për të ardhur keq.

Duke shprehur sinqerisht keqardhjen time për të si njeri, si mik, si kundërshtar dhe si aleat, si dikush që nuk ka bërë vetëm gjëra të këqija, por ka dhënë dhe kontribute pozitive në jetën e tij të gjatë politike, i uroj sot me gjithë zemër ta lexojë me qetësi dhe me kthjelltësi rezolutën e këtij Kuvendi, nëse ka ende probleme me dëgjimin dhe nuk do t'i kuptojë qartë fjalët që po thuhën sot nga ky Kuvend në adresë të tij.

Shumë faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Fjala për zotin Lita.

Korab Lita - Të nderuar kolegë deputetë,

Në vitin 1990, kur në çdo rrugicë dhe shesh të Shqipërisë buçiste thirrja e rinisë dhe qytetarëve shqiptarë “E duam Shqipërinë si gjithë Europa”, unë isha vetëm 15 vjeç. Në ëndrrën time dhe në atë çfarë dëgjoja nëpër mitingje nga politikanët e dalë në krye të lëvizjes e mendoja veten shumë afër Europës dhe mendoja se në moshën 20-vjeçare do të isha qytetar evropian. Për të qeshur dhe për të qarë njëkohësisht. Kjo ëndërr kishte qenë gënjeshtër më e madhe që kam përjetuar ndonjëherë në jetën time, jo për fajin tim e aq më tepër të Europës.

Derën europiane, ku duhet të hyjnë qytetarët shqiptarë, e ka zënë një kastë politikanësh, që, të shpërndarë në të dyja kahet politike prej afro 30 vjetësh e kanë kapur këtë vend për fyti dhe po e tërheqin zvarrë.

Kemi 30 vjet që presim integrimin, por politikanët tanë e mbajnë peng këtë proces kaq të pritshëm për shqiptarët. Nëse shqiptarët duan të bashkohen me Europën, duhet të ndahen nga kjo racë politikanësh.

Të nderuar bashkëqytetarë,

Përpara se të jemi të majtë apo të djathtë, ne jemi shqiptarë. Përpara se të duam partinë, ne duam Shqipërinë. Edhe politikanët i përsërisin shpesh këto fraza, madje i artikulojnë më mirë se unë apo ju, por e vërteta është krejt ndryshe. Politikanët tanë i shikojnë partitë si mjete për të vjedhur dhe për të rrjepur Shqipërinë, prandaj i kanë uzurpuar partitë duke u kthyer në pronarë të tyre. E për ta bërë këtë ata po përdorin çdo mënyrë dhe janë gjithmonë të koordinuar ndërmjet tyre.

Ne kemi qenë të gjithë dëshmitarë se si këta politikanë, për ta pasur më të lehtë sundimin e tyre, shpikin lloj-lloj krizash artificiale dhe janë gati të çojnë edhe qytetarët në konflikt, vetëm e vetëm që të krijojnë shtratin e pazarit të radhës, të cilin ata e quajnë marrëveshje apo zgjidhje politike. E tillë është edhe kriza aktuale. Pavarësisht se kjo krizë institucionale sot qelbet erë, ajo i ka rrënjët në vitin 2008.

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj se për vetë situatën e krijuar në Shqipëri dhe temën për të cilën po diskutohet,

seanca e sotme parlamentare do të mbahet mend gjatë në memorien e shqiptarëve. Situata e sotme është e paprecedentë, nga njëra anë kemi Kryeministrin, i cili për 6 vjet me radhë u ka ofruar qytetarëve shqiptarë qeverisjen më të korruptuar, që ka pasur ndonjëherë Shqipëria dhe nga ana tjetër, kjo qeveri, e bërë njësh me krimin, duke aktivizuar në fushatë apo kandiduar në zgjedhje elemente të botës së krimit, arriti që, në mënyrë spektakolare, të vjedhë dhe të manipulojë zgjedhjet lokale të 2015-s dhe ato parlamentare të 2017-s. Deliri i madhësishtës ka arritur kulmin. Kryeministri ynë kërkon të bëjë votime si në kohën e komunizmit, pa konkurrencë.

Nga ana tjetër kemi Presidentin, i cili ka çdëkretuar veten e tij. S’kisha dëgjuar ndonjëherë që një president, kur partia e tij nuk hyn në zgjedhje, paska të drejtë të anulojë zgjedhjet. Presidenti mund të anulojë zgjedhjet në partinë e tij, por jo zgjedhjet e qytetarëve shqiptarë. Që në momentin kur u betua për atë post, presupozohet që ai të jetë gardian i Kushtetutës. Siç duket, në këto zgjedhje, të parat që dekreton, nuk e kishte parashikuar se mund të ishte jashtë loje sa u përket qokave. Ne të gjithë e dimë se ai është specialist në këtë fushë.

Në vitin 2009 mori tri mandate të majta, u fut në koalicion me PD-në, dhe me bllok në dorë u dend mirë me para e pushtet, ndërkohë që shumica e demokrateve të ndershëm rrinin rrugëve.

Në vitin 2013 doli nga koalicioni me PD-në, me 16 deputete, pra i mori 13 deputetë Partisë Demokratike.

Shqipëria, në modelin e saj të të bërit politikë alashqiptare ka pasur të paktën dhe dy raste të tjera të shtyrjes së zgjedhjeve, por jo anulim.

Edhe pse Kushtetuta nuk e parashikon këtë fenomen, në të dyja rastet ka pasur konsultime, tryeza, dakordësi dhe kërkesë nga spektri politik dhe nga Parlamenti. Të gjithë e dimë se në këtë rast palët janë shumë larg në qëndrimet e tyre dhe ndoshta ulja në tryezë është e vështirë.

Po, a e luajti Presidenti këtë rol? Nëse vërtet Presidenti donte të luante rolin e tij konstruktiv, çfarë e pengonte të konsultohet me palët? Siç e kemi parë, por edhe siç e deklaroi

vetë Presidenti, në deklaratën e tij, e gjithë përpjekja për të afruar palët ishte një drekë me zotin Berisha. Këtë drekë, si dhe simpatinë tënde për zotin Berisha e mirëkuptoj, se ti duhet t'i jesh gjithë jetën borxhli Sali Berishës, pasi, që nga 2009-ta deri më 2013-ën të bëri ky që je sot, ty dhe partinë tënde, në kurriz të demokratëve, por kjo drekë s'ka lidhje me krizën.

Veprimi i dytë, Presidenti priti në Presidencë "liderët e djathtë", Mediun, Shehin, Dukën, Ndokën dhe Dulen. Po çfarë krize mund të zgjidhet duke pritur këta liderë, të cilët të gjithë bashkë kanë vota sa çka anëtarë partie seksioni i Partisë Demokratike në Kodrën e Kuqe dhe në Paskuqan?

Veprimi i tretë dhe më pikanti ishte qoka e Presidentit me Kryeministrin në orën 10 të darkës, por, siç duket, pa rezultat.

Gjithsesi unë e çmoj rolin e Presidentit të Republikës në menaxhimin e gjithë kësaj krize. Ai ofroi gjithçka kishte në dorë të bënte. E filloi me kërcënimin se do të vriste veten, por, kur pa se më shumë se gjysma e shqiptarëve ishin dakord, u tërhoq. E vazhdoi me shpërndarjen e parlamentit, por, kur pa se parlamenti u mbush, u tërhoq. Apo s'është tërhequr? Në fund, i futi një zhdekret dhe pas kësaj u konsultua me liderin zyrtar të opozitës nëpërmjet telefonit.

Turp e faqja e zezë nëse demokratët janë katandisur deri në atë fazë sa të presin zgjidhje dhe të vijnë në pushtet me familjen Meta! Bir Selman i nënës, kë të qash më parë!

Ndoshta tani është momenti që të fillojë çmontimi i këtij establishmenti politik dhe Shqipëria të marrë frymë lirisht.

Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Lita!

Fjalën e ka deputetja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në seancën e sotme parlamentare do të duhej, në fakt, të ishim në një seancë ku të miratonim ligje të rëndësishme, që adresojnë problematikat e qytetarëve dhe mbi të gjitha të nxisim në përshpejtimin e atyre reformave që është duke ndërmarrë vendi ynë. Për mua, po besoj edhe për shumicën e kolegëve të mi, por mbi të gjitha edhe për qytetarët që janë duke na

ndjekur, të diskutosh datë zgjedhesh 17 ditë nga data në të cilën do të zhvillohen ato, sepse një ditë të bukur ai që caktoi atë datë, ndryshon mendjen pa asnjë argument të mbështetur mbi kompetencat që jep Kushtetuta, është realisht jo vetëm një nga çuditë më të mëdha të tranzicionit të shoqërisë shqiptare, por, mbi të gjitha, është një nga aktet më të paprecedenta të goditjes së Kushtetutës dhe Republikës parlamentare.

Të nderuar kolegë,

Si ka mundësi që ai që duhej të ishte dhe të jetë faktori i unitetit, simbol i urtësisë dhe i maturisë të bëhet nxitës dhe, aq më keq, pengues i përparimit të vendit? Ai çfarë na shqetëson të gjithëve më shumë është pikërisht fakti se si kreu i shtetit tonë pëson një ndryshim të tillë duke treguar paqëndrueshmëri, mungesë kohezioni dhe marrje vendimesh të nxituara, që në vend të përmirësojnë klimën e debatit, çojnë edhe më thellë në thellimin e ndasive.

Pikërisht për këtë, besoj se Presidentit i Republikë nuk duhet të na përgjigjet neve, si dhe të gjithë qytetarëve sinqerisht dhe të tregojë arsyet e vërteta të këtij vendimi sa absurd, aq edhe të rrezikshëm. Ky qëndrim besoj se nuk është vetëm imi si deputetë, jo vetëm i PS-së që unë përfaqësoj, por edhe i shumë ekspertëve të fushës së të drejtës dhe partnerëve tanë europianë dhe amerikanë.

Shqiptarët e dinë se cilët janë aleatët e tyre, që u kanë qëndruar në momente shumë të vështira. Kushdo që mendon se aleatët e shqiptarëve janë ato forca të errëta, që synojnë të ndezin barutin në Ballkan për të rifituar hegjemoninë e dikurshme, gabohen rëndë. As lekët e lobimeve dhe as mbështetja për karrige nuk mund ta shuajnë ëndrrën europiane të shqiptarëve për të përfaqësuar dhe për të përfaqësuar vlerat më të larta të demokracisë për një shtet të së drejtës.

Të nderuar kolegë, ajo që është më absurde sot, është fakti se si një opozitë kërkon të mos zhvillohen zgjedhjet! Më thoni një vend të botës, ku opozita kërkon të mos zhvillohen zgjedhjet?! Askund! Përkundrazi, një opozitë e përgjegjshme jo vetëm që nuk duhet të pengojë, por duhet të jetë një garant i fortë i datës së zhvillimeve të zgjedhjeve. Me vendimin e tij Presidenti mban anën, edhe pse duhej të ishte i paanshëm, e opozitës jashtëparlamentare, që ka djegur mandatet dhe kërkon prej kohësh shtyrjen e

zgjedhjeve. Qartësisht, mbajti atë anë, veprimet e së cilës janë të qëllimshme dhe të papranueshme në demokraci. Ai, Presidenti, mbi të gjitha, sot nuk përfaqëson popullin. Nëse ka krizë, siç thotë, kjo është një krizë dhe luftë për mbijetesën e opozitës, që doli në rrugë, që ka humbur besimin e elektoratit të saj dhe që braktisi institucionet demokratike, duke vepruar haptazi në kundërshtim me parimet demokratike dhe me Kushtetutën e Shqipërisë. Kjo opozitë synon prej kohësh ta destabilizojë vendin me protesta të dhunshme dhe me aktin e tij Presidenti mori kahje të qartë nga opozita, duke shkelur betimin si përfaqësues i unitetit kombëtar.

Të nderuar kolegë, mbajtja e zgjedhjeve në kohë, në datën 30 qershor, nuk është një dëshirë, por është një detyrim kushtetues ndaj demokracisë dhe ndaj qytetarëve, të cilët pas datës 30 qershor presin t'i marrin të gjitha shërbimet! Ne duhet t'u japim mundësi qytetarëve për të zgjedhur, mundësia u është dhënë të gjitha palëve politike për të qenë pjesë e garës dhe vendimi i tyre për të mos marrë pjesë është në respekt të së drejtës së tyre. Nëse Presidenti mendon vetëm për pakicën e shtëpisë, jo për shumicën e qytetarëve shqiptarë, që duan të votojnë dhe të zgjedhin drejtuesit e tyre lokalë në të drejtën e tyre kushtetuese, detyra jonë si maxhorancë, si shumicë qeverisëse, që kemi marrë besimin e qytetarëve, është që të jemi garantë të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës.

Ndaj, më 30 qershor Shqipëria nuk do të votojë vetëm për të zgjedhur kryebashkiakët, por më 30 qershor Shqipëria do të votojë për shtetin e së drejtës, do të votojë për Shqipërinë europiane.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fjalën e ka Enver Roshi. Zoti Roshi, nuk është i pranishëm.

Në bazë të Rregullores, konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi.

Fjalën e ka deputeti Bledar Çuçi.

Bledar Çuçi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Shqipëria, shtëpia jonë e përbashkët, vendi ku jemi rritur dhe ku rrisim fëmijët tanë, vendi që na bëri këta që jemi, të cilit i detyrohem

shumë, meriton dhe kërkon nga secili prej nesh të ngrihet në lartësinë e këtij momenti të shumëpritur historik: hapja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Hapja e këtyre negociatave do të ishte përgjigjja e mirëpritur për më shumë se 83% të shqiptarëve, të cilët synojnë vlera të rëndësishme të respektimit të të drejtave të njeriut, të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, të cilat BE-ja i mishëron. Për këtë duhej të ishim mbledhur sot këtu, qeveri dhe opozitë së bashku, edhe me Presidentin; duhej të ishim mbledhur për të lobuar së bashku qeveritë e shteteve anëtare të BE-së për të hapur negociatat për anëtarësimin e vendit tonë në BE; duhej të ishim mbledhur këtu për t'u thënë bashkëqytetarëve tanë, por edhe BE-së, se ne, të zgjedhurit e popullit dhe politikëbërësit janë të gjithë bashkë për të arritur një qëllim të madh kombëtar. Por, fatkeqësisht, në vend që t'i përgjigjen një thirrjeje mbarëkombëtare për të hedhur një hap themelor për afrimin me BE-në, në vend që të mendojnë për Shqipërinë, për shqiptarët, të cilët duan më shumë drejtësi, institucione publike më funksionale, më shumë mirëqenie dhe më shumë mundësi për zhvillim, sigurisht gjëra, të cilat shtohen me afrimin ndaj BE-së, drejtuesit e opozitës joparlamentare kanë marrë në dorë pishtarin e urrejtjes dhe të shkatërrimit dhe janë gati t'i vënë flakën Shqipërisë dhe shqiptarëve, vetëm e vetëm për të ruajtur privilegjet e tyre personale, vetëm e vetëm se kanë frikë të përballen me institucionet e reja të drejtësisë, që burojnë nga reforma në drejtësi. Akoma më keq, këtë pishtar të urrejtjes dhe shkatërrimit tashmë e ka marrë në dorë edhe Presidenti i Republikës, i zgjedhur nga ky parlament dhe mandatuar nga Kushtetuta që të qëndrojë mbi palët, që të kontribuojë në unitetin e shoqërisë.

Si jurist, nuk kam asnjë dyshim se dekreti që Presidenti nënshkroi të hënën është në shkelje të plotë dhe të qartë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Dekreti i tij antikushtetues shkel haptazi parimin e unitetit kombëtar, që Kushtetuta i vesh rolit të Presidentit të Republikës, pra neni 86 i Kushtetutës, shkel parimin e sovranitetit të popullit, i cili e ushtron këtë sovranitet përmes përfaqësuesve të tij të zgjedhur, cenon të drejtën e qytetarëve për të zgjedhur ata që i qeverisin, shkel parimin e periodicitetit të zgjedhjeve dhe u zgjat organeve

të qeverisë vendore mandatin përtej afatit të tyre kushtetues.

Si anëtar i këtij parlamenti, ndihem i revoltuar nga akti i Presidentit, i cili haptazi dhe qartazi mori krahun e drejtuesve të PD-së dhe LSI-së, të cilët kërkojnë pushtet në tavolinë dhe nxisin rrëmujë dhe dhunë në rrugët e Shqipërisë.

Si qytetar i këtij vendi, ndihem i tradhtuar nga akti i Presidentit, i cili me dekretin e tij dhunoj Kushtetutën dhe i hodhi benzinë zjarrit, që mundohen të ndezin drejtuesit e PD-së dhe LSI-së, në të cilin duan të djegin aspiratën e shqiptarëve për një vend, që në paqe lufton dhe përpiqet për një jetë më të mirë, për një Shqipëri që i afrohet për herë e më shumë Bashkimit Europian dhe vlerave të tij.

Si anëtar i Partisë Socialiste dhe në misionin tim si ministër, ndiej përgjegjësinë e lartë dhe të paevitueshme për t'iu qëndruar premtimeve, që u kemi bërë të gjithë qytetarëve shqiptarë, atyre që na votuan dhe atyre që nuk na votuan, se ne, socialistët, nuk do ta tradhtojmë kurrë ëndrrën europiane të shqiptarëve, se ne do të bëjmë çfarë është e mundur për të çuar Shqipërinë në Europë, se ne, pavarësisht mëkateve, gabimeve dhe të metave, do të punojmë çdo ditë për t'u siguruar bashkëqytetarëve mundësi për zhvillim, paqe, siguri dhe drejtësi. Prandaj, me këtë përgjegjësi mbi supë, sot do t'u themi ndal akteve antikushtetuese të Presidentit të Republikës për të minuar të ardhmen europiane të Shqipërisë, do t'i themi ndal përpjekjes së tij antikushtetuese dhe antishqiptare për t'u hequr shqiptarëve të drejtën e shenjtë të votës së lirë, të cilën e fituam 28 vjet më parë. Me përgjegjësinë e madhe historike mbi supë, për të mos tradhtuar aspiratat e mëdha historike të bashkëqytetarëve, sot do të nisim procesin për t'i hequr Ilir Metës mundësinë që t'i bëjë ende dëm Shqipërisë dhe shqiptarëve, të ardhmes europiane të tyre dhe fëmijëve tanë.

Faleminderit!

Vasilika Hysa – Faleminderit, zoti Çuçi!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi. Të përgatitet deputeti Damian Gjikhuri.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Faleminderit, zonja e zotërinj ministra dhe ju kolegë që keni mbetur në sallë!

Siç e shihni, sapo ikën Kryeministri, menjëherë sindroma e ikjes për të dalë në rrugë i kap edhe socialistët. Nuk kemi çfarë të bëjmë, duhet të durojmë.

Kemi këtë fletërrufe, kështu do e quaj unë, sepse këtu duhet të vijë mocioni. Presidenti i Republikës duhet të linte menjëherë mandatin në fushatën zgjedhore të vitit 2017 në Berat, por ju e mbajtët edhe 2 vjet, sepse bëtë manovra, por tani që manovra nuk është në favorin tuaj, kërkon t'i jepni fletërrufe. Jo, Presidentit të Republikës i bëj ftesë: “Zoti Ilir Meta, ke vetëm një shans, jep dorëheqjen tani, sepse nesër është vonë”.

Le t'ju kujtoj kush është Presidenti i Republikës. Kryeministri e tha dhe iku. Ai tha: “I kemi dhuruar Ilir Metës mundësinë të jetë Kryetar Kuvendi, Kryeministër dhe kreu i shtetit”. Krahina e famshme e Skraparit, që nuk kishte prodhuar asnjëherë kryeministër në vitet e diktaturës, gjatë demokracisë, në një person ka pasur tri poste të mëdha. Dua t'ju bëj një pyetje juve, socialistëve. A nuk keni pasur personalitete brenda jush, që i keni falur Ilir Metës kaq shumë? Kryeministri vjen këtu dhe thotë se ai është ngritës peshash, bën retorikë. Aq e ka togfjalëshin Kryeministri, 2200-2300 fjalë, sipas statistikave të të huajve, të cilët e kanë studiuar. Ai nuk flet më shumë se një pararendës i tij socialist apo më shumë se baca apo doktori, siç kam qejf unë t'i them. Ai nuk flet më shumë, por rrotullohet te fjalët dhe nuk kthen përgjigje pse nuk u ngrit Gjykata Kushtetuese. Ajo ia heq mandatin Presidentit të Republikës. Pse duhet të rrimë të varur nëse do t'i bëjmë zgjedhjet apo jo?! Si mund të bëjmë zgjedhje në 29 bashki, kur dikush nuk ka kandidatë përballë dikë, nuk po flas për penalizimin e konservatorëve?! Prandaj, Kryeministri ka shansin, të cilin Presidenti e humbi, t'i ftojë në një tryezë partitë politike, edhe ato që dolën në rrugë, sepse edhe ata janë vëllezërit tanë. Ju e dini edhe programin tjetër që ka me Kryetarin e Kuvendit.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Fjalën e ka deputeti Damian Gjikhuri. Të përgatitet deputeti Zef Shtjefni.

Damian Gjikhuri - Të nderuar deputetë,

E nderuar drejtuese e seancës,

Në fakt, pak vetë e diskutojnë nëse akti i Presidentit është nul apo jo. Pse?! Akti i

Presidentit është një akt totalisht nul nga ana juridike dhe kjo nuk diskutohet. Kjo për arsye se Kushtetuta e ka përcaktuar qartë natyrën e akteve që nxjerr Presidenti dhe në asnjë nen të saj nuk ka përcaktuar zhdekretimin e datës së zgjedhjeve. Ky akt i ka prodhuar efektet dhe këtë nuk duhet ta diskutoj asnjë. Akti i Presidentit duhet parë si akt politik dhe këtu fillon problemi. Pse e bëri Presidenti këtë akt? A po kontribuonte ai vërtet në zgjidhjen e krizës?! Po të ishte kështu, do të ishte normale që të merrej vesh me palët, të cilat kërkonin një datë tjetër zgjedhjesh, gjë që nuk e bëri. Atëherë, për çfarë shërbeu akti i Presidentit? Për mendimin tim dhe të shumë njerëzve, të cilët dinë ta analizojnë politikën, akti i Presidentit shërbeu për thellimin e krizës, sepse ai bëri edhe një gabim më të rëndë. Duke mos nxjerrë datë tjetër zgjedhjesh, jo vetëm që akti i parë nuk prodhoi asnjë pasojë, por, mbi të gjitha, bëri edhe diçka tjetër, që nuk e njeh Kushtetuta, e la vendin pa datë zgjedhjesh. Pse e bëri këtë?! Për të kontribuar më shumë, fatkeqësisht, për krizën.

Ndoshta ky nuk ka qenë qëllimi i tij, por realisht ashtu lexohet. Po të donte ta zgjidhte këtë ngërç, do të duhej që shumë kohë më parë, ai të kishte negociuar në një tavolinë për zgjidhjen e krizës, por gjithmonë qëndroi larg këtij problemi. Atëherë, çfarë prodhoi ky akt!? Ky akt prodhoi një amulli të mëtejshme, duke e lënë krizën të hapur. Praktikisht, organet, të cilat merren me zbatimin dhe me administrimin e ligjit zgjedhor, nuk kanë pse ta ndjekin këtë akt, pasi, siç e thashë, ai nuk krijon asnjë pasojë dhe, në kushte të tilla, Partisë Socialiste dhe qeverisë nuk u mbetet gjë tjetër vetëm të vazhdojnë me datën 30 qershor. A është zgjidhja më e mirë?! Është zgjidhja më e mirë ligjore e mbetur. Për atë kohë sa nuk ka një marrëveshje politike, ashtu siç kanë qenë edhe më parë precedentët, akti i Presidentit nuk sjell asgjë, përkundrazi, po forcon shkeljen e tij dhe bindjen se Presidenti thjesht veprimi si aktor politik. Është më e ndershme të thuash që jam aktor politik se të fshihesh pas artificave juridike. Kështu që zgjedhjet do të mbahen më 30 qershor dhe, ligjërisht, asgjë nuk i ndalon ato. Problemi është që në datën 30 qershor maxhoranca është e detyruar që me dhimbje të shkojë drejt kësaj date, kjo për një arsye të thjeshtë: për të ruajtur rendin kushtetues dhe ligjor. Datën 30 disa

njerëz po e shikojnë si Eldorado, disa të tjerë si Waterloo dhe disa të tjerë si vija e Rubikonit.

Në fakt, në datën 30 do të ketë zgjedhje. Mund të ketë edhe disa incidente, mund të ketë edhe probleme me zgjedhjet. Ne nuk donim t'i kishim këto zgjedhje, sepse mbase ato nuk e kanë kredibilitetin e plotë politik, për shkak të mungesës së pluralizmit, siç u tha me të drejtë këtu, diçka e zgjedhur jo nga ne, por nga kundërshtarët tanë, të cilët imponuan një precedent. Por data 30 do të sanksionojë një gjë përfundimisht: do të sanksionojë se asnjë President nuk do të tentojë më të bëjë akte të tilla dhe të kthehet në aktor politik, në vend që të qëndrojë mbi palët. Do të sanksionojë se asnjë precedent dhune, i imponuar nga rruga, nuk mund t'i imponohet një maxhorance në lidhje me rregullat e lojës, për të cilat janë marrë vesh. Kjo do të thotë se data 30 do të shërbejë si mësim i mirë dhe si ditë gjykimi edhe për ata njerëz, të cilët kërkonin të imponoheshin me dhunë.

Nga ana tjetër, data 30 do të kalojë dhe vendi do të ketë prapë pikëpyetje. Unë jam i bindur se klasa politike, natyrshëm duhet të gjejë një zgjidhje politike për këtë krizë që ka zënë vendin. Kriza është politike. Fatkeqësisht, Shqipëria ka kohë që nuk flet më për qeverisje, për politikëbërje e për shumë probleme, që duhet të shqetësojnë shqiptarët, atë më tepër kur ne jemi përpara hapjes së negociatave, dhe shqiptarët duhet të dinë dhe duhet të kenë një datë për këtë. Pikërisht problemi i tyre nuk do të zgjidhet në datën 30, por jam i bindur se ajo shprehja e famshme e Çurçillit: "Fati i shumë njerëzve varet nga politikëbërja e pak njerëzve ose nga përpjekja e pak njerëzve", sot është më gjallë se kurrë.

Është momenti kur fati i shumë shqiptarëve, që varet nga vendimmarrja e pak njerëzve, të bëhet realitet. Na takon neve, neve që jemi ata pak njerëz që bëjnë politikë, për t'u dhënë një mundësi e një të ardhme shqiptarëve, duke e zgjidhur këtë krizë.

30 qershori është një datë që do të vendosë gjykimin për veprimet e gabuara të disave. Pas 30 qershorit vendi kërkon një perspektivë, dhe jam i bindur se Partia Socialiste e ka thënë: jemi të hapur për dialog dhe për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare kësaj krize.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjikhuri!

Fjalën e ka deputeti Zef Shtjefni. Të përgatitet deputeti Ditmir Bushati, e më pas deputeti Blendi Klosi.

Zef Shtjefni – E nderuar zonja nënkryetare e Kuvendit,

Zonja e zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarët shqiptarë, që ndiqni punimet e parlamentit,

Si deputet dhe si kryetar i partisë Ora e Shqipërisë, si koordinator i koalicionit “Shpresa për ndryshimin”, për zgjedhjet e 30 qershorit të vitit 2019, jam këtu për t’ju thënë se me aktin e fundit Presidenti i Republikës u përpoq të shkallmonte republikën parlamentare dhe t’i hapte rrugën një anarkie të plotë.

Ky president u zgjodh në vitin 2017, në atë kohë kur unë dhe e gjithë opozita ishim në çadrën e lirisë. Pse e mori detyrën ky njeri, meqë qenka garant i unitetit të popullit? Asokohe, ne ishim në protestë për afro 100 ditë, kur ky u zgjodh president dhe bëri një fushatë të egër kundër zotit Rama dhe zotit Basha. Pse nuk deklaroi: “Unë nuk e marr detyrën e kreut të shtetit, pasi po zgjidhem vetëm me votat e maxhorancës dhe pa miratimin e opozitës?”

Fakti tregon se edhe kur ka qenë në pushtet me PD-në, ai dhe partia e tij krijuan mjaft probleme dhe e cenuan rëndë pushtetin e PD-së në kohën kur Kryeministër ishte Sali Berisha. Tashmë ka dy vjet që janë kthyer prapë bashkë me PD-në, ndërkohë që shumë forca të djathta politike nuk u thirrën kurrë më nga PD-ja.

Kryetari i shtetit, në kundërshtim me ligjin, zhdekretoi datën e zgjedhjeve. Pse e bëri këtë, mund të pyesni ju. E bëri sepse ka interesa personale, s’e bëri për Partinë Demokratike.

Kryetari i shtetit ka hedhur në erë Kushtetutën e vendit, duke i bërë një shërbim të madh anarkisë, pasi vendi ndodhet në prag të proceseve integruese.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese nuk krijon asnjë problem, sepse në kohë normale është Gjykata Administrative ajo që e gjykon këtë çështje. Në rastin konkret, në procesin zgjedhor, në të cilin ndodhemi edhe sot, është Kolegji Zgjedhor ai që rregullon mbarëvajtjen e tij, dhe zhdekretimi i datës së zgjedhjeve është i pazbatueshëm.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Kur mora mandatin e deputetit, kam qenë në një linjë me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin European, që kjo situatë e paprecedentë në historinë e Shqipërisë nuk ka ardhur rastësisht, sepse ka 30 vjet që këtë vend e vjedhin dhe e shkatërrojnë njerëz të botës së krimit. Fakti tregoi se institucionet tona janë të brishta. Një njeri që është në pushtet mund t’i bëjë gjëmën këtij vendi, mund të shkatërrojë institucionet në emër të unitetit të vendit, por jemi këtu për të vazhduar reformat më të rëndësishme të vendit, siç është reforma në drejtësi, reforma zgjedhore, si dhe për të miratuar ligje që forcojnë Republikën, rendin kushtetues, sigurinë kombëtare dhe unitetin e popullit.

Kushdo që do të përpiqet t’i shkelë këto parime do të marrë goditje ligjore, me votë, po nga ky parlament, që në Shqipëri të mos ketë më asnjë njeri, kushdoqoftë ai, sot në maxhorancë apo nesër në opozitë, të shkatërrojë vendin, duke pasur si qëllim të vetëm përfitimet elektorale dhe politike.

Ky duhet të jetë një kapitull i mbyllur për cilindo që do të guxojë parimet kushtetuese të vendit.

Në mbyllje do t’ju them: kjo është detyra jonë, prandaj dhe jemi këtu, të mbrojmë demokracinë...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Shtjefni! Koha mbaroi.

Fjalën e ka deputeti Ditmir Bushati.

Zoti Bushati nuk ka filluar. Mos filloni të llogarisni kohën, ju lutem! Ndiqni deputetët!

Ditmir Bushati – Zonja drejtuese e seancës,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Po jetojmë në një periudhë eksperimentesh të rrezikshme. Eksperiment ishte djegia e mandateve nga ana e opozitës, eksperiment është mospjesëmarrja e saj në zgjedhjet vendore, eksperiment është largimi nga përgjegjësia për konstituimin e organeve të drejtësisë dhe organeve kushtetuese, vajtimi për mungesën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Eksperimente po bëhen edhe me parimet themelore të së drejtës, me sigurinë juridike, me pritshmëritë legjitime, me proporcionalitetin, me parashikueshmërinë dhe pasojat e akteve ligjore.

Eksperiment është edhe bojkotimi i Komisionit të Reformës Zgjedhore, reformë e mbështetur nga partnerët tanë ndërkombëtarë, si

dhe bojkotimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Po eksperimentohet me dhunën, duke e relativizuar atë dhe duke e mirëpritur si akt apo si instrument politik.

Eksperiment është edhe zhdekretimi apo anulimi i zgjedhjeve nga ana e Presidentit të Republikës, në kapërcim të kufijve kushtetues, në kundërshtim me ligjin, por edhe me praktikën kokëfortë të tranzicionit shqiptar, sipas së cilës duhet të ketë një dakordësi mes palëve politike, për ta anuluar, për ta shtyrë datën e zgjedhjeve.

Shkurt hesapi, e gjithë kjo situatë më kujton romanin e Saramagos, “Verbëria”, i cili përshkruan edhe veprimet e gabuara, që nxisin instinktet më të këqija njerëzore, pikërisht siç po ndodh në Shqipërinë e këtyre ditëve: zhgënjim me demokracinë, të vendosur pas juntës, çka më kujton, gjithashtu, këshillën e një miku të huaj të Shqipërisë, i cili shpesh më thoshte: “Njëqind vitet e para të demokracisë janë gjithmonë të vështira dhe sfiduese”.

Ndoshta është taksirat për ne shqiptarët që t’i përjetojmë të gjitha llojet e eksperimenteve në ndërtimin e një sistemi demokratik. Megjithatë, më duhet të them se kjo rrugë synon zhbërjen e gjithë konceptit të organizimit politik e shoqëror dhe marrjen e drejtimit politik me mjete jashtë sistemit. Në fakt, zhbërja e institucioneve nuk është zgjidhje, për sa kohë që forcat politike janë këtu për të dhënë kontributin e tyre, duke u angazhuar në procese brenda procesit politik institucional.

Kam qenë deputet i Tiranës më 2011 dhe e di shumë mirë se çfarë ndodhi. Na u vranë katër protestues në bulevard, zgjedhjet e majit të 2011-ës u grabitën në tavolinë nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integritet, e më pas u justifikuan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Edi Rama e la bashkinë e Tiranës, por ne nuk e lamë parlamentin, vazhduam procesin e përmirësimit të jetës parlamentare e institucionale, duke fituar zgjedhjet në vitin 2013.

Për herë të parë kam votuar më 1996. I mbaj mend shumë mirë zgjedhjet e vitit 1996. Gjithashtu, mbaj mend shumë mirë se në tetor të vitit 1996 Partia Socialiste, megjithëse u gjakos në zgjedhjet e majit, u bë sërish pjesë e procesit zgjedhor.

Pra, miq, ne të gjithë e dimë se sistemet politike institucionale përmirësohen nëpërmjet platformave, përmirësohen nëpërmjet pjesëmarrjes, përmirësohen nëpërmjet bashkëpunimit, por nuk përmirësohen nëpërmjet kulturës së shumatores zero.

Ne jemi te verbëria, siç e përshkruan Saramago situatën pas juntës dhe rivendosjes së demokracisë. Verbëria na fton në qorrsoak, dhe sot, për fat të keq, ne diskutojmë për datën e zgjedhjeve në Shqipëri, për 30 qershorin, ndërkohë që të gjitha energjitë tona do të duhej të ishin përqendruar te data e fillimit të negociatave. Sot ne diskutojmë për një histori, e cila nuk ka lidhje me aspiratat e shqiptarëve, që nuk ka lidhje me përparësinë tonë kombëtare. Në vend që të merremi me vendet anëtare të Bashkimit Europian, që janë skeptike për progresin tonë apo për progresin e fqinjit tonë, ne harxhojmë energji duke u marrë me njëri-tjetrin.

Shkurt, ne e kemi braktisur përparësinë kombëtare, dhe për shkak se e kemi braktisur përparësinë kombëtare, sot nuk jemi në gjendje t’u ofrojmë qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi atë çfarë ata meritojnë. Në kushtet kur ne jemi të vendosur përballë kësaj situatë, unë besoj në atë që besonte dhe beson filozofi gjerman Habermas: te logjika e njeriut dhe te fuqia e rezistencës së demokracisë. Kështu e lexoj edhe vullnetin tonë për të shkuar drejt 30 qershorit, për t’u dhënë së paku mundësi atyre zgjedhësve, atyre shqiptarëve, të cilët duan të votojnë, që ta thonë fjalën e tyre me votën e lirë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën e ka deputeti Blendi Klosi. Të përgatitet deputeti Selami Jenishehri.

Blendi Klosi – Këtë maj, në Shqipëri hynë 531 mijë turistë të huaj, vetëm 1, 4 % më shumë se në majin e vitit 2018, apo 5600 veta, ndërkohë që pritshmëritë e të gjithë neve, pritshmëritë e hotelierëve, e njerëzve që punojnë në botën e biznesit të turizmit, e njerëzve të cilët presin që turizmi në vendin tonë të shndërrohet në industri e të sjellë të ardhura, ishin të paktën 20 % më shumë.

Prisnin që shumë shpejt sfida jonë: dhjetë milionë turistë të bëheshin realitet. Presim ne që të dyfishojmë veten tonë me të ardhurat që vijnë nga turizmi. E gjetëm në 2013-ën me vetëm 3 milionë turistë, e çuam në gjashtë, dhe presim të

shkojë në dhjetë, pra të katërfishojmë të ardhurat nga turizmi. Nuk janë pak. Janë të paktën 3-4 miliardë euro më shumë të investuara në ekonominë e vendit vetëm nga ajo politikë qeveritare.

Çfarë ndodhi? Protestat, zhurma, molotovi, debati, edhe këto që ndodhin sot, e shndërruan këtë në një bisedë pothuajse dështim, për sa i përket politikës dhe asaj çfarë presin njerëzit.

Pse e them këtë sot, në një ditë kur diskutojmë për një vendimmarrje të Presidentit të Republikës? E them fare qartë, sepse ne, të nderuar miq të mi, kolegë deputetë, në të dyja krahët, vijmë në këtë parlament, paçka se nga çfarë sistemi, maxhoritar, proporcional, mund të ketë edhe sisteme të tjera, po ç'rëndësi ka, pra vijmë në këtë parlament dhe betohemi se me veprimet tona, me punën tonë, me vendimmarrjen tonë, ne do t'u shërbejmë interesave të qytetarëve, do t'i shërbejmë mirëqenies së qytetarëve, do t'i shërbejmë asaj çfarë njerëzit presin: punësim, mirëqenie, prosperitet.

Ndërkohë, çfarë ndodh? Në kohën më të mirë, në kohën që ne kishim kaq shumë ëndrra për një Shqipëri europiane, erdhi goditja presidenciale, një goditje e cila i jepet këtij parlament, paçka se fuqinë kushtetuese e ka ky parlament, paçka se fuqinë politike e ka ky parlament, paçka se ne jemi votuar për të prodhuar institucione. Goditja presidenciale s'është as ligjore, sepse nuk ka asnjë mbështetje në ligj, vjen si personale, por vjen si opozitare, vjen si një goditje që dëmton qartazi atë çfarë njerëzit duan dhe presin nga ky parlament.

Na akuzojnë ne për reformën në drejtësi, akuzojnë organet e drejtësisë, të cilat bëjnë gjykim në lidhje me vendimin që Presidenti ndërmori në mënyrë krejtësisht opozitare.

Të nderuar miqtë e mi, kemi qenë në këtë parlament edhe kur ndodheshim në opozitë. Kemi qenë në këtë parlament gjithmonë qartazi në interes të opinionit publik qytetar. E kemi respektuar Kushtetutën, e kemi respektuar garën zgjedhore, po përgatiteshim për këtë garë zgjedhore edhe për 30 qershorin, dhe do të shkojmë qartazi më 30 qershor, me kandidatët tanë më të mirë, të cilët kishim dy vjet që i përgatisnim. Tetë muaj më parë, po Presidenti, caktoi 30 qershorin si datë të garës politike. Ne jemi sot në fushatë elektorale kudo në Shqipëri,

ne jemi sot në takime me njerëzit, për t'i përgatitur ata për 30 qershorin. Aq njerëz sa mbledhen në protestat kombëtare të opozitës, ne i mbledhim në një lagje të Beratit, Vlorës, Shkodrës, Dibrës, Klosit apo Matit.

E pra, kjo është e vërteta. Sovrani vendos me anë të votës në ditën e zgjedhjeve. Sovrani nuk është si Barcelona dhe Reali, që luajnë 3 herë në javë, por vendos një herë në 4 vjet. Vetë sovrani ka vendosur me votën e tij në vitin 2017. Sovrani do të vendosë edhe për drejtuesit lokalë më 30 qershor. Sovrani vendos! Po, është e vërtetë se sovrani vendos me votë. Sovrani na besoi në vitin 2013, kur vendosëm të bëjmë një reformë të thellë në organet e drejtësisë. Sot problemi nuk është mungesa e Gjykatës Kushtetuese, e Gjykatës së Lartë apo e gjyqtarëve të tjerë për të gjykuar një veprim joligjor të Presidentit. Sot problemi që duhet të na shqetësojë ne dhe ata, që i kanë zgjedhur ata gjyqtarë, është: si ka mundësi që i gjithë sistemi, që kontrollohet nga një sistem i pavarur ndërkombëtar, që, për hir të së vërtetës, nuk ka pasur kritikë nga të gjithë kritikuesit e reformës në drejtësi, rezulton i gjithi me probleme?

Të nderuar miqtë e mi, ky është shqetësimi i vërtetë. Prandaj edhe 30 qershori nuk mund të jetë një datë pazaresh, por një datë ballafaqimi me sovranin. Po e them, e kam thënë edhe herë tjetër: më vjen keq që nuk i kemi përballë në Berat, se kandidatët socialistë do t'i fitonin të 5 bashkitë. Nuk diskutohet, do të fitonim shumë më tepër sesa kemi aktualisht kryetarë bashkie, sepse është e qartë që ne punojmë për njerëzit.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Selami Jenishehri.

Të përgatitet deputeti Alket Hyseni. Më pas deputetja Ermonela Felaj.

Selami Jenishehri - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë të pranishëm në këtë sallë,

Të nderuar qytetarë shqiptarë, që na ndiqni nëpërmjet ekranit në Shqipëri dhe jashtë saj,

Si deputet dhe kryetar i Partisë Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë, vlerësoj se akti i Presidentit, datë 10.06.2019 "Për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, date 05.11.2018 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore" është një akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në tejkalim të

kompetencave kushtetuese dhe ligjore të institucionit të Presidentit dhe, si i tillë, konsiderohet nul. Populli shqiptar nuk ka tashmë një datë kur do të bëhet i mundur zhvillimi i zgjedhjeve vendore. Kjo është e papranueshme, është në kundërshtim me ligjin, me çdo arsye, sado e vogël qoftë ajo.

Unë i bëj thirrje Presidentit të Republikës të reflektojë duke e kthyer institucionin e Presidentit në kufijtë e kompetencave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe të mos ndër marrë asnjë veprim tjetër në shkelje flagrante të Kushtetutës.

Dua t'i drejtohem zotit President dhe t'i them: "Ka dyshime të besueshme se ju i shërbeni zotit Lulzim Basha". Kjo shihet qartë nga qëndrimi që mban, nga mendimi që ka, ku i interesojnë problemet rreth personit të Presidentit, i cili është treguar i papërgjegjshëm në lidhje me dekretin në fjalë.

Zoti President, thonë se ju i shërbeni zotit Lulzim Basha, i cili thotë para shqiptarëve se Kryeministri ynë, zoti Edi Rama, paska vjedhur votat! Nëse je ti ai, që ka vjedhur votat dhe ka hequr nga karrigia Kryeministrin, zotin Edi Rama me vota të vjedhura në vitin 2011, dokument i cili është në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku kishte 800 e ca vota më shumë se votues, nuk ke të drejtë morale ta zësh në gojë këtë gjë. Ti e ke hequr zotin Edi Rama nga karrigia e...

Vasilika Hysi – Faleminderit, deputeti Jenishehri!

Fjalën e ka deputeti Alket Hyseni.

Alket Hyseni - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Rafaella, Rei, Klea, Laura, Rizai, Medi, Armando, Eri, Seldina, Romeo dhe mbi 500 të rinj 18 -vjeçarë do të votojnë për herë të parë në Sarandë, Delvinë, Konispol dhe Finiq. Ata dëshirojnë të votojnë më 30 qershor. Pata kënaqësinë të takohesha me ta dhe me një grup të madh të rinjsh të tjerë. Me pasionin e moshës që kanë, por edhe me mundësinë dhe përgjegjësinë që Kushtetuta shqiptare dhe ligji u kanë dhënë, me dëshirën për të ndryshuar botën dhe brenda botës jetën e tyre, të familjarëve të tyre nëpërmjet mekanizmit të vetëm që njeh demokracia, votës, me impulsin e jetës rinore, por edhe optimizmin, besimin se Shqipëria mund të bëhet me kontributin e gjithsecilit, ata

prisnin me padurim 30 qershorin. Jo të gjithë do të votonin për PS-në. Jo të gjithë janë dakord me punën tonë, me punën time; ndoshta edhe me Kryeministrin Edi Rama jo të gjithë janë dakord. Midis tyre kishte edhe disa të djathtë, por të gjithë ata duan të votojnë, të zgjedhin administratorin e bashkisë për 4 vjetët e ardhshëm, të zgjedhin apo të zgjidhen këshilltarë, që të kenë mundësi të ndikojnë indirekt me votë, kur zgjedhin përfaqësuesit, dhe direkt, kur zgjidhen vetë me vendimmarrje për rrugë më të mira, për ujë të pijshëm 24 orë, për ambiente arsimore më të mira, për politika lokale zhvillimi, që sjellin punësim dhe mirëqenie për gjallërimin e jetës sociale, kulturore, sportive. A e dini se çfarë më tha Eri, një prej atyre djemve: "Na doli kuçedra dhe nuk na le të pimë ujë në kroin e demokracisë. Kërkon të na e thajë mendjen", t'u heq mundësinë e vetme që të jenë zot të fateve të tyre, zot të lagjes, të rrugicës, të fshatit, të qytetit, të bashkisë. U them këtyre djemve dhe vajzave, por jo vetëm, edhe të gjithë atyre burrave dhe grave të majtë dhe të djathtë që duan të votojnë, të mos shqetësohen fare. Nuk ka akt që u heq mundësinë e votës demokratike, që e kanë fituar shqiptarët me shumë mund dhe sakrifica.

Unë, si jurist dhe qytetar, në përgjithësi nuk kam dashur të futem në komente, në debate për deklarata apo për qëndrime politike të presidentëve të ndryshëm të Republikës, dhe as të Presidentit aktual, por si deputet i këtyre njerëzve nuk mund të rri, sepse na doli ky President që kujton se Kushtetuta është shkruar me laps dhe ky ka gjetur një gomë dhe mund të fshijë çdo gjë. Goma jote, zoti President nuk mund të fshijë asgjë nga këto, sepse janë shkruar, janë skalitur me mundin dhe sakrificat e shumë brezave. Goma jote administrativisht është nul, sepse akti juaj është absolutisht i pavlefshëm dhe, si i tillë, konsiderohet sikur nuk ka dalë kurrë, si i tillë nuk mund të zbatohet, është i pazbatueshëm. Nuk duhet të zbatohet nga asnjë organ dhe nga asnjë subjekt i Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Administrativisht, dekreti i pretenduar në formën e një njoftimi, që del në zbatim të kompetencave administrative të Presidentit, nuk mund të anulohet prej të njëjtin organ, për sa kohë që ka dhënë efekte, ka filluar organizimi i zgjedhjeve; është në mes të rregullave të lojës.

Fakti që është akt administrativ, është e qartë, sepse e ka definuar Gjykata Kushtetuese, aq shumë e cituar dhe e “dashuruar” nga Presidenti, as juridikisht, edhe nga pikëpamja kushtetuese nuk është i vlefshëm. President, ti nuk ke asnjë kompetencë të tillë. Kushtetuta e shpreh qartë në nenin 94 se asnjë kompetencë, që nuk të jepet taksative, nuk mund të ushtrohet prej teje. Të ka dhënë kompetencën për të nxjerrë vetëm datën dhe këtë në formë strikte ta ka dhënë me një procedurë të përcaktuar konsultimi, me një periudhë të përcaktuar zgjedhore dhe një afat se kur e nxjerr: 9 muaj përpara. Po tani, zotëri, si mund ta nxjerrësh? Pas 9 muajsh duhet të bëjnë zgjedhje shqiptarët?

Zoti President, edhe politikisht duhej të ishte mbi palët. Prandaj, nuk kam dashur të kontestoj asnjë president. Duhej të ishte i baraslarguar, të kishe pamjen e “plakut të moçëm”, por na dole inatçor, që more jo vetëm palë, por je organizatori i atyre që nuk duan të zgjedhin dhe të zgjidhen.

Punë e madhe! Kjo është demokracia. Le të rrinë në rrugë, nëse zgjedhin rrugën. Ne do të shkojmë të votojmë bashkë me këta të rinj që përmenda, bashkë me shumë burra dhe gra, do të ushtrojmë të drejtën tonë, të bëjmë zgjedhje demokratike. Ti ta dish mirë se nuk mund të sillesh si bajraktar. Prandaj, e ke humbur të drejtën të jesh Presidenti i vendit tim dhe unë do të jem pjesë aktive e atyre, që do të iniciojnë procedurat e republikës parlamentare për të zgjedhur Presidentin që i duhet vendit.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti Hyseni!

Fjalën e ka deputetja Ermonela Felaj. Të përgatitet deputeti Lefter Maliqi. Më pas fjalën e ka deputeti Spartak Braho.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Në radhën e atyre që duan të bllokojnë zgjedhjet e 30 qershorit, u shfaq hapur edhe Presidenti i Republikës me aktin e fundit të anulimit të datës së zgjedhjeve të dekretuar më parë. Presidenti i Republikës mëtoi, gjoja, të kryente detyrën e kreut të shtetit, të atij që përfaqëson unitetin e popullit, por dështoi tërësisht në këtë gjë, duke dështuar edhe në detyrën e tij të parë: atë të respektimit të Kushtetutës.

Dikush është përpjekur ta justifikojë, dikush ta relativizojë aktin e Presidentit. Një

përpjekje e kotë, po aq e kotë sa edhe ajo e Presidentit, për t'u dhënë oksigjen kërkesave marroke të një opozite të çoroditur, që në turravrapin e saj për t'u ikur institucioneve dhe përfaqësimit të tyre nga qytetarë të zakonshëm të këtij vendi, mori edhe Presidentin.

Do të shpresoja fort që gjesti i shqiptarizmit, me duart e kryqëzuara porsi shqiptonjë, i një Presidenti të mos ketë tërhequr aq shumë vëmendjen nga fakti se në fjalën e Presidentit për anulimin e zgjedhjeve nuk kishte qoftë dhe një germë të vetme që të justifikonte sjelljen dhe veprimin e tij. Dhe nuk ka një germë në Kushtetutë, pasi kjo e fundit i nominon një për një kompetencat e Presidentit të Republikës në nenin 92 të saj.

Ne jemi një republikë parlamentare, dhe ky është një model i ndryshëm nga republika gjysmë presidenciale dhe ajo presidenciale. Në këtë model qeverisjeje çdonjëri organ apo institucion ka kompetencat e tij dhe Presidenti ka kompetenca të natyrës formale ose ceremoniale, që thjesht konfirmojnë vullnetin e parlamentit ose të qeverisë.

Presidenti i Republikës duhet të mbajë dhe të luajë rol neutral në jetën politike të vendit dhe, për parim, nuk mund të ndërhyjë në çështje të natyrës partiake. Qartësisht Presidenti nuk munda të shkëputet nga partia nga e cila vjen as edhe formalisht. E gjitha, e lidhur me rastin konkret, përbën një shkelje të rëndë të Kushtetutës, rrethanë e cila duhet të shënojë edhe fundin e mandatit të tij si President.

Veprimi i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve është kryer në një boshllëk kushtetues dhe juridik. Presidenti mund të caktonte vetëm datën e zgjedhjeve, detyrim të cilin e pati përmbushur. Kjo kompetencë e tij nuk është diskrecionale, nuk është në vullnetin e tij të lirë, sepse përcaktimi i datës së zgjedhjeve vjen si pasojë e një procesi. A do të mundej Presidenti të caktonte një datë zgjedhjesh para përfundimit të mandatit të organeve të zgjedhura të pushtetit lokal? Një vit, dy vjet përpara? Jo! Nëse do ta kishte bërë këtë, me siguri që ne sot nuk do të votonim një rezolutë, por me gjasë do të votonim një komision mjekësor. Mandej edhe çështja e datës përsëri nuk është një dëshirë e Presidentit, sepse ligji e detyron Presidentin të përcaktojë një datë në periudhën që thotë ligji për zgjedhjet dhe në konsultim me partitë

politike. Pra, në asnjë moment të ushtrimit të kësaj kompetence Presidenti nuk ka diskrecion, përkundrazi, siç u shpreha, fuqia e tij në këtë rast është e kufizuar, dhe e tillë është, sepse ne Presidentin nuk e zgjedhim nga populli, por nga parlamenti dhe e zgjedhim me shumicë të thjeshtë. Qenia kreu i shtetit dhe përfaqësues i unitetit të popullit do t'i kërkonte Presidentit të Republikës në mënyrë imperative të vepronte në një linjë me të mirën publike, jashtë çdo linje të ngushtë partiake apo personale, të sillej në mënyrë të paanshme, duke qenë i besueshëm dhe objektiv. Kjo nuk ndodhi. Para nesh u shfaq kryetari i vjetër i LSI-së, u shfaq opozita me molotov në duar, u shfaqën me të gjitha karakteristikat penguesit e zgjedhjeve.

E pra, zgjedhjet nuk do të mund të pengohen. Ato do të mbahen më 30 qershor. Qytetarët do të shkojnë të votojnë më 30 qershor për të treguar se demokracia në këtë vend, pavarësisht problemeve, funksionon dhe se koha e autoritarizmit ka marrë fund. Të vepruarit si “kofini pas të vjelit,” duhet t'i tregojë Presidentit se më 30 qershor shqiptarët do të vjelin frytet e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, ndërsa Presidenti le të zbulojë pensionin, të paktën kështu do të dijë se ka mandat të pakufizuar.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Felaj!

Fjalën e ka deputeti Lefter Maliqi.

Lefter Maliqi – Të nderuar shqiptarë, po ju drejtohem juve dhe po e nis me fjalët: në datën 30 qershor nuk do të ketë zgjedhje, sepse vendi kalon në diktaturë, konflikti do të jetë i pashmangshëm dhe përgjegjësia do të bjerë drejtpërdrejt te kalorësi i Rilindjes, i 1000 shuplakave, që ka vetë frikë nga zgjedhjet, pasi e di shumë mirë që nuk i fiton më zgjedhjet, për shkak se iku Dule, Idrizi, aktualisht LSI-ja është bashkuar me Partinë Demokratike, ka futur deputetë të Partisë Socialiste në burg, sepse ky jo vetëm të gënjen, por të fut edhe në burg!

Të nderuar shqiptarë, dëgjua këtu disa recitime të maxhorancës, tamam si ato të revolucionit kinez dhe fletëthirrje si të sistemit komunist. Kur me parodinë e tij, Kryeministri i Shqipërisë, erdhi këtu me ERTV-në e tij, filluan disa ovacione të mëdha, njëlloj si në kohën e “xhaxhit”, por ju e dini shumë mirë që këta

diktatorë e kanë pasur dhe e kanë fundin e hidhur.

Të nderuar shqiptarë,

Unë dua t'ju them se kam dëgjuar me vëmendje analistë, deputetë, gazetarë e të tjerë me radhë, por kemi parë edhe përrallën e fundit të ERTV-së së famshme, më të mirën në Ballkan dhe në Europë, e cila na nxjerr një video dhe na bën krahasimin: cilin do të dëgjoni, Junkerin, apo Presidentin Meta?

Bëra një analizë të thellë, e cila është e dukshme edhe për të gjithë shqiptarët, që do të thotë se unë vetë, si deputet, por edhe shqiptarët e ndershëm, të cilët ndërmjet Presidentit dhe Kryeministrit janë me zotin Clinton, ish-presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili, me veprimin e tij dinjitoz e injoroi kalorësin e “Rilindjes” dhe u shtrëngoi dorën të tjerëve. Kështu ka injoruar edhe veprimet e këtij pijaneci, që edhe ato që i thotë Rama, me një fjalë, i thotë paçavure kur jep konferencë.

Së dyti, jam përsëri me Presidentin Clinton për veprimin e tij dinjitoz, për shtrëngimin e duarve të liderëve të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe jam kundër këtij pijaneci, që ngatërron 1 prillin e famshëm të këtij kalorësi me datën 30 qershor.

Sigurisht, jam përsëri me zotin Clinton, i cili e çliroi Kosovën dhe na dha ne, shqiptarëve, mundësinë të shikonim një Kosovë të lirë e të pavarur, dhe jam kundër këtij pijaneci në ikje, që fut përçarjen e shqiptarëve më 30 qershor.

Veprimi i Presidentit është veprimi më dinjitoz që ekziston, sepse shmangi një konflikt civil. Ta harroni që ju mund të fusni në burg 600 mijë-700 mijë, sipas zgjedhjeve të fundit! Ju keni frikë vetë nga zgjedhjet e lira! Keni frikë nga vetingu! Keni frikë nga reforma në drejtësi! E dini se nuk fitoni, pasi keni vetëm një parti; nuk janë 42 parti! Këto 42 parti mund të jenë me 100 ose 30 vota.

(Bie gongu)

Partitë në Shqipëri janë: PD-ja, PS-ja...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Maliqi!

Fjalën e ka deputeti Spartak Braho. Të përgatitet deputetja Elda Hoti.

(Deputeti Maliqi flet pa mikrofon.)

Zoti Maliqi, ju lutem, se ju ka mbaruar koha e diskutimit!

Ju lutem, lironi foltoren për kolegun Braho!

(Deputeti Maliqi flet pa mikrofon.)

Zoti Maliqi, ju lutem, lironi foltoren, se ju mbaroi koha!

(Deputeti Maliqi flet pa mikrofon.)

Zoti Maliqi, ju lutem, lironi foltoren!

Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Spartak Braho. Të përgatiten deputetet Elda Hoti dhe Lindita Nikolla.

Spartak Braho – E nderuara zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Këto ditë jemi para faktit që Presidenti i Republikës ka prodhuar një shkresë, një akt, një njoftim, “një zhdekretim”, e quan dikush tjetër, që shfuqizon një dekret të tij të disa muajve më parë, duke menduar se e ka kompetencë të tij.

Çdo njeri normal, pale jurist, po të lexojë nenin 92 të Kushtetutës, ku parashikohen kompetencat e Presidentit, një terminologji të kësaj natyre nuk e gjen të shkruar kund, madje në asnjë kushtetutë të shteteve të tjera të botës.

Në germën “gj” të nenit 92 të Kushtetutës parashikohet si kompetencë e vetme e Presidentit për zgjedhjen dhe referendimet caktimi i datës së zhvillimit të tyre. Në nenin 93 Kushtetuta përcakton se, në zbatim të kompetencave të tij, Presidenti nxjerr dekrete. Pra, ajo që po shohim është se Presidenti me topin e dekreteve që ka poshtë tavolinës, ka goditur një dekret tjetër të tij, që është në fuqi dhe sapo ka filluar zbatimin, duke pasur si kufi nominal datën 30 qershor. Kaq mjafton për ta konsideruar dhe për ta kuptuar këtë veprim si marrëzi me stof kushtetues, e veshur me retorikë djallëzore politike. Madje, çuditësh dhe të vjen për të qeshur kur shikon se si një radhë e tërë injorantësh, ndërmjet tyre pseudojuristë dhe pseudoanalistë, disa seriozë e disa gjasme, marrin përsipër të argumentojnë gjylen e ndryshkur të Presidentit, e cila nuk pati fuqi të kalojë as murin e Presidencës.

Pse ndodhi kështu? Veç të tjerash, është evident fakti se Presidenti, veçse është një njohës i keq i Kushtetutës dhe ligjit, në thelbin voluntarist të paskrupullt të tij, shoqërohet kjo edhe me nivelin e ulët të këshilltarëve të tij ligjorë. Kushtetuta dhe ligji nuk janë si llastiku i të mbathurave, që mund ta hapësh sa të duash. Në këtë kuptim, ato janë strikte, pasi janë shtylla të shtetit dhe trarë që nuk mund t’i lëvizësh kollaj.

Veprimi dhe aksioni institucional për zbatimin e Kushtetutës nuk e pranon retorikën apo të ashtuquajturat argumente politike. Ato janë dy gjëra që rrinë veç e veç, ndonëse i nevojiten njëra-tjetrës.

Të gjithë vrapojnë të flasin për pasojat që mund të prodhojë moszbatimi i aktit nga KQZ-ja dhe maxhoranca. Në të vërtetë, më e rëndësishme është të kuptohet se çfarë pasojash do të rrjedhin nëse e zbatojmë aktin e Presidentit. A nuk do të instalohej në Shqipëri precedenti që çdokush nga forcat e mëdha politike, normalisht opozitare, mund të thotë një ditë: “Nuk duam të hyjmë në zgjedhje” dhe Presidenti përkatës të anulojë datën e zgjedhjeve?

Po sikur të pranojmë që kur një president zhdekretin datën e zgjedhjeve, të zgjedhurit aktualë, që presin të zëvendësohen, të mund vazhdojnë të qëndrojnë në pushtet, e kështu do të gjendemi përballë faktit se një parti në pushtet refuzon të hyjë në zgjedhjet e vitit 2021, se nuk i pëlqen dhe Presidenti duhet të zhdekretojë datën e zgjedhjeve.

E tha edhe Presidenti se as kërcënimet me luftë apo me konflikt civil, si ai që u përgatit në datën 8 qershor, që është i dokumentuar, nuk janë arsye që demokracia t’i hapë rrugën paligjshmërisë, sepse, nëse ndodh kjo, atëherë do të instalojmë precedentin që në demokraci gjërat fitohen me luftë dhe jo me ligj. Ky është fundi i një sistemi normal demokratik.

Po ashtu, nëse pranojmë që Presidenti të nxjerrë akte juridike-administrative, për të cilat nuk ka kompetencë, siç është anulimi i zgjedhjeve, mund të gjendemi përballë një realiteti të ri, ku Presidenti mund të fillojë të bëjë emërime, të shkrijë institucione, të shpikë institucione të reja etj.

Së fundi, duhet ditur se nëse KQZ-ja nuk do ta konsideronte të pavlefshëm aktin juridik të Presidentit, që ai e quan dekret, atëherë sipas nenit 111 të Kodit të Procedurës Administrative, këta zyrtarë të penalizohen.

Ka edhe shumë efekte të tjera shkatërruese deri në kapilarët e sistemit demokratik, nëse pranojmë që një president me qëllime të dukshme politike, t’u heqë të drejtën 2 milionë votuesve në pritje të pazarit të favorshëm për të.

Do të mjaftonin këto për të kuptuar se, nëse i hapet rrugë Ilir Metës, si dikur Sali Berishës, vendi mund të mos e marrë veten kurrë, duke

hyrë në spiralen e një anarkie shtetërore, nga e cila nuk do të na nxjerrë dot as lufta.

Prandaj, të nderuar kolegë, është më mirë të bëjmë një betejë ligjore sot në Kuvend me një President, që kërkon ta çojë vendin në anarki, sesa të pastrojmë nesër Shqipërinë nga gërmadhat e një lufte për pushtet që nuk do të mbarojë kurrë, nëse do ta pranojmë këtë marrëzi të Ilir Metës.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Braho!

Fjalën e ka deputetja Elda Hoti!

Elda Hoti – Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Sot do të kisha dëshirë t'ju propozoja ta ndryshonit axhendën.

Ju lutem, mos e fyeni inteligjencën e shqiptarëve!

Askush nuk ju beson se e keni seriozisht gjithë këtë tymnajë. Ju keni 30 vjet bashkë dhe nuk e lëshoni njëri-tjetrin. Ju e zgjodhët President Ilir Metën, pasi u përqaftat me Lulzim Bashën në vitin 2017.

Ju nuk keni ndër mend ta shkarkoni dhe thjesht po na humbni kohë, ndërsa mund të diskutonim për çështje madhore, si papunësia, emigracioni, pensionet, vrasjet.

I gjithë ky teatër i madh për çfarë po ndodh? Në fund Rama dhe Basha do bashkohen kundër të gjithëve.

Ambasadori austriak dje e tha hapur: çdo 2 vjet 3 aktorë politikë luajnë të njëjtën skemë, njëri bojkoton zgjedhjet, tjetri do të hyjë i vetëm në zgjedhje dhe një i tretë del e shtyn datën. Jua ka kuptuar lojën e gjithë bota tashmë. Ndërroni skenar, se jeni bërë aq të lexueshëm, sa nuk ju beson më askush!

Për çfarë jemi mbledhur sot? Për të thelluar krizën apo për të gjetur zgjidhje? Nëse jemi mbledhur për të thelluar krizën, atëherë shajeni Presidentin, mallkoheni opozitën, hyni të vetëm në zgjedhje dhe merrini të gjitha pushtetet!

Nëse do të merrni përgjegjësinë që ju takon si maxhorancë, nëse do të marrim përgjegjësinë që na takon si parlament, atëherë duhet të diskutojmë se cila është zgjidhja. Zgjidhja duhet gjetur brenda logjikës europiane, jo asaj komuniste. Nuk dua të mbroj juridikisht dekretin e Presidentit, se ky është një debat i pafund dhe i pafytyrshëm. Gjykimi për aktin e Presidentit i takon Gjykatës Kushtetuese dhe jo neve këtu.

Ju nuk duhet të uleni për të organizuar shkarkimin e Presidentit dhe për të marrë edhe pushtetet, që nuk i keni akoma, por për të organizuar një tryezë gjithëpërfshirëse, për të shpërndarë pushtetin me të cilin keni abuzuar, për ta çuar vendin përpara drejt paqes shoqërore dhe më pas drejt përgatitjes për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE.

Për këtë arsye ju kërkoj edhe një herë të hiqni dorë nga ky mocion i pakuptimtë dhe të bëni një mocion për mirëkuptim politik, të bëni një mocion me debat për të ardhmen e vendit dhe do të kuptoni se jeni vonë, por ende në kohë për të reflektuar. Edhe pse jemi të vonuar, kemi ende kohë t'u kthejmë shpresën shqiptarëve.

Unë pranova të marr mandatin me këtë bindje dhe jam gati të bëj gjithçka që më takon në shërbim të paqes politike dhe sociale të vendit.

Çdo ndërkombëtar po kërkon të ndëshkoni peshqit e mëdhenj dhe, sigurisht, këtu ju dhimbset vetja. Për këtë arsye e keni ndezur zjarrin brenda Shqipërisë me shpresën se do ta shtyni edhe ca kohë mes tymit dhe amullisë.

Kanë të drejtë Europa dhe Amerika që as dorën nuk jua shtrëngojnë, kur ju shohin në rrugë.

Sot është një ditë e shenjtë për të gjithë besimtarët katolikë, festa e Shën Ndojit. Mijëra persona udhëtojnë sot drejt kishës së Laçit...

(Bie gongu.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Hoti!

Koha për ju mbaroi.

Fjalën e ka deputetja Lindita Nikolla!

Të përgatitet deputeti Artur Roshi!

Lindita Nikolla - Të nderuar kolegë,

Akti i Presidentit na jep edhe më shumë të drejtë të vlerësojmë se këto zgjedhje nuk janë tashmë thjesht lokale, por janë zgjedhje mes një pale, që është vendosur në mbrojtje të Kushtetutës, të drejtës së qytetarëve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre dhe një pale tjetër, që i ka dalë përballë popullit dhe as nuk e përfaqëson, as nuk do ta lërë të zgjedhë.

Pyetja që shtrohet është: a do ta mbrojmë të drejtën e njerëzve tanë për të zgjedhur? Presidenti thotë jo, njësoj siç thonë Sali Berisha, Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi. Pikërisht për këtë ai nxori një akt, që, juridikisht, nuk do të thotë asgjë dhe politikisht doli hapur në krah të protestës së opozitës, u bë palë me opozitën,

duke treguar hapur anësinë politike, në shkelje të Kushtetutës.

Presidenti ka si detyrim vetëm të përcaktojë datën e zgjedhjeve. Këtë kompetencë e ka përmbushur në tetor të vitit të shkuar dhe nuk mund ta riuastrojë më. Me caktimin e datës së zgjedhjeve dhe me fillimin e periudhës zgjedhore, janë organet e administrimit zgjedhor, që marrin në dorë administrimin e zgjedhjeve.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2017 përcakton se e drejta e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve është një akt i pastër administrativ dhe individual, i cili nuk mund të gjykohej nga Gjykata Kushtetuese, por nga Gjykata Administrative apo nga Kolegji Zgjedhor. Ndaj, mungesa e Gjykatës Kushtetuese nuk luan rol për çështjen. Vendimmarrja e KQZ-së mund të ankimohet në Kolegjin Zgjedhor, vendimet e të cilit kanë formë të prerë dhe janë të paankimueshme.

Nga ana tjetër, nëse ne do të lejojmë që Ilir Meta të bëjë çfarë të dojë për shkak të mungesës së Gjykatës Kushtetuese, sepse atë nuk e shkarkojmë dot, i bie që secili prej nesh apo të gjithë bashkë, të vepronim me të njëjtën logjikë. Pra, të kryenim veprime të papërgjegjshme, meqenëse mungon Gjykata Kushtetuese.

Në arsyetimet e tij Presidenti u mendua ta shpallë veten si shpëtimtarin, të përgjegjshmin, atdhetarin, sovranin, por akti i tij është një atentat i pastër ndaj demokracisë, që bazohet në të drejtën e shtetasve për të zgjedhur një herë në 4 vjet drejtuesit vendorë.

Xhesti i shqiponjës nuk e mbulon atë, që ai tashmë së bashku me Sali Berishën, Lulzim Bashën dhe Monika Kryemadhin dëshirojnë të bëjnë, ta destabilizojnë dhe ta çojnë vendin në krizë. Duke sjellë destabilitet, ata synojnë rishikimin e reformës në drejtësi, me shpresën për të shpëtuar nga ndëshkimi për gjithçka që kanë bërë në të shkuarën.

Pardje ai u përpoq të sillej edhe si sovranist duke deklaruar se sot nuk kemi nevojë për eurojuristë dhe eurodiplomatë, por Presidenti harron se shqiptarët kanë zgjedhur Bashkimin Europian dhe po pengohen në rrugën e integritetit pikërisht nga politikanë si Sali Berisha, Lulzim Basha dhe Ilir Meta. Presidenti harron se shqiptarët kanë besim te reforma në drejtësi pikërisht sepse aty janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian.

Ndaj, kur Presidenti, si zoti i shtëpisë, është kundër Perëndimit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të thotë se është kundër interesave të shqiptarëve.

E drejta për të zgjedhur është një e drejtë sovraane, ndërsa e drejta për t'u zgjedhur duhet garantuar, por buron nga vullneti.

Partia Demokratike dhe LSI-ja me vullnetin e tyre kanë zgjedhur të mos hyjnë në zgjedhjet e 30 qershorit. Ato nuk janë penguar në asnjë moment për t'u regjistruar dhe për të marrë pjesë në to, ndaj ky akt i papërgjegjshëm i Presidentit krijon një precedent të rrezikshëm. Për Presidentin kushtetutë janë bërë kushtet e opozitës. Sipas tij, nesër çdo parti politike, që nuk dëshiron të hyjë në zgjedhje, bën të mundur që zgjedhjet të mos zhvillohen dhe qeveria, kryetarët e bashkive ose deputetët, mund të qëndrojnë në pozicionet e tyre jashtë çdo afati kushtetues. Nëse konflikti civil është arsye, siç tha Presidenti, që paligjshmëria të prevalojë mbi demokracinë, atëherë i bie që në demokraci fitues bëhesh vetëm me dhunë dhe jo me ligj.

Nuk ka dyshim që një akt i tillë ka shkelur rëndë Kushtetutën në mënyrë flagrante, ndaj votimi i rezolutës është detyrimi i secilit prej nesh, që ka vendosur të mbrojë kushtetutshmërinë e vendit ndaj anarkisë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Nikolla!

Fjalën e ka deputeti Artur Roshi.

Artur Roshi - Zonja drejtuese e seancës, Zonja dhe zotërinj deputetë,

Dëgjova me vëmendje konferencën për shtyp të Presidentit Meta. Lajtmotivi që e përshkroi gjithë fjalën e tij për të mbështetur zhdekretimin e dekretit të tij për datën e zgjedhjeve të 30 qershorit ishte uniteti i shqiptarëve dhe garantimi i të drejtës për të zgjedhur.

A e ka zbatuar Presidenti Kushtetutën? Çfarë është në thelb Kushtetuta? Kushtetuta përmbledh të drejtën natyrore të njeriut, duke sakrifikuar ato pjesëza të saj për shkak të jetës në komunitet, por që i konverton ato në një trajtë tjetër të drejtash, të cilat përfitohen nëpërmjet komunitetit. Kjo është Kushtetuta, ose fryma e saj.

E drejta për të zgjedhur në kohët moderne është kthyer në një të drejtë bazike, ashtu si e

drejta për të jetuar. Unë mendoj që Presidenti donte pikërisht të mbronte këtë të drejtë ekzistenciale të individit. Presidenti në këtë situatë politike zgjodhi frymën e Kushtetutës për të arritur te procedura.

A kishte Presidenti ngarkesë politike? Sigurisht që po. Si çdo genie njerëzore, edhe ai është genie politike, por ai sqaroi vetëdijen e tij të lartë për përgjegjësinë, si kryetar shteti, përballë një konflikti të mundshëm, mbështetur në perceptimin e ngritur mbi informacionin që kishte dhe çdo mundësi, sado minimale, që mund ta çojë vendin në konflikt, duhet marrë seriozisht. Prandaj, Presidenti, i prirur nga zgjidhja e situatës politike, pati besim se me këtë akt administrativ shtrëngues do të ndihmonte në dialog midis palëve.

Ne nuk kemi arsye pse të mos besojmë se Presidenti i Republikës u nis nga një qëllim i mirë, sepse ky akt kërkon krijimin e premisave pozitive për të zgjidhur çështjen e zhvillimit të zgjedhjeve në një klimë paqësore.

Jo gjithmonë qëllimi justifikon mjetin, por në këtë rast qëllimi i mirë vlen, sepse ajo, me të cilën po luhet e ardhmja e shqiptarëve, është tepër e rëndësishme.

Zgjidhja e situatës nuk do të ndodh nëse liderët e opozitës nuk rimarrin tezën e votës së lirë, të votës së lirë që vjen nga ndryshimet rrënjësore të Kodit Zgjedhor, i cili është përshtatur gjithmonë me oreksin e më të mëdhenjve, duke prodhuar realitetin politik ku jemi sot.

Pra, për mendimin tonë, të Ballit Kombëtar Demokrat Kodi është A- ja e ndryshimeve në jetën politike.

Mos harroni që figura e Presidentit është e lidhur me institucionin e Presidencës dhe shfrenimi i gjuhës së diskutimit ul autoritetin e postit më të nderuar në hierarkinë shtetërore.

Në Kushtetutë për shkarkimin e Presidentit te Republikës thuhet se kjo ndodh kur ka shkelje të rëndë të Kushtetutës. Pra, me logjikë të ftohtë ky kategorizim vlen për cenime territoriale të kombit, për prishjen e sistemit politik, për tradhti ndaj kombit e të tjera....

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Roshi, koha juaj mbaroi!

Fjalën e ka deputeti Niko Peleshi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, kohën nuk ia merrni dot njëri-tjetrit pa e vendosur personi më parë. Ju lutem, nuk jeni ju që i merrni kohën tjetrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, zotëria që do të japë kohën nuk është shprehur.

Kush kërkon kërkon të heqë dorë nga fjala e tij?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deputeti nuk është i regjistruar.

Fjalën e ka deputeti Niko Peleshi.

Niko Peleshi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Shqipëria prej muajsh po furnizon mediet ndërkombëtare me imazhe, që vizatojnë një vend në tym e flakë. Nuk është hera e parë që padurimi për pushtet shkel interesin afatgjatë të shqiptarëve. Ende nuk kemi kuruar imazhin që ka lënë pas viti '97, e tani duhet të shpëljajmë tymin që do të mbetet për vite të tëra në përfytyrimin e të huajve për Shqipërinë.

Absurditetit politik tani i është shtuar edhe absurdi institucional. Koston e situatës, ku ndodhet vendi e kupton me një ushtrim të thjeshtë, mjafton të lexosh raportin e progresit të Komisionit European. Aty flitet paragraf pas paragrafi për tema të harruara prej muajsh nga opozita, për fushat e sektorit të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit, aty gjen progresin, gjen edhe sfidat, pra mundësinë për të bërë opozitë normale me ide, alternativa dhe zgjidhje më të mira.

Por ne sot nuk jemi në kushtet e normalitetit demokratik, jemi në kushtet e ngutit politik, që ka injoruar ngutin e shqiptarëve për zhvillim, madje edhe hapja e negociatave për integrim në Bashkimin European duket se ka kaluar në plan të dytë në diskutimet qytetare dhe politike. "Hapja e negociatave" është bërë një togfjalësh, që, meqenëse është lakuar shumë herë, mbase tingëllon si një tekst pa përmbajtje. Në të vërtetë për Shqipërinë moshapja e negociatave është si humbja e trenit dhe ne nuk e dimë nëse do të ketë një tren tjetër. Shtyrja edhe më larg e Europës është aq e vështirë të përballohet nga shqiptarët, sa ç'është e lehtë të thuhet.

Nëse ne do të dështojmë në procesin integruar, nuk do të ketë më vlerë se cila parti do t'i fitojë zgjedhjet. Koha që humbet vendi është

rinia e fëmijëve të fëmijëve, që lindën në vitin '90, kur në qiellin shqiptar u dëgjua për herë të parë klithma "E duam Shqipërinë si gjithë Europa!". Para kësaj llogarie ne nuk mund të ndërtojmë më një narrativë politike. E di që logjika racionale duket naive në një kohë kur opozita ka ikur kaq larg rrugës së re që Shqipëria ka zgjedhur pas dhjetorit '90. Asnjëherë më parë nuk kemi qenë kaq pranë një përplasjeje politike si sot, që dukshëm do të ketë edhe humbësit e mëdhenj. Sa herë që ka një përplasje, ka edhe një pyetje: në cilën anë qëndron e drejta? Përgjigjen e kësaj pyetjeje mund ta gjejmë brenda raporteve që kanë palët tona me sistemin e demokracisë, me të drejtën e zgjedhësve për të zgjedhur, me detyrimin e të zgjedhurve për llogaridhënie dhe të maxhorancës për ndërtimin e mjedisit të përshtatshëm për të zgjedhur lirshëm.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar brenda afateve ligjore për zgjedhjet e dekretuara nga Presidenti në përputhje me të drejtën kushtetuese. Partia Socialiste, aleatët e saj, edhe deputetët e mandatuar së fundi në radhët e partive opozitare, po përpiqen të sillen në mënyrë normale brenda anormalitetit që ka krijuar bojkoti radikal i opozitës. Ky anormalitet është shkaku i absurdit politik që tashmë pas dekretit të fundit të Presidentit, të sforcuar tej hapësirave që lejoi Kushtetuta, ka marrë edhe përmasat e një konflikti institucional. Ne jemi të vetëdijshëm edhe për përgjegjësinë që ka maxhoranca për të bërë gjithçka që ka në dorë për të dialoguar dhe për të arritur marrëveshjen në të mirë të stabilitetit dhe normalitetit politik.

Në vitin 2017, si dhe më parë, treguam gatishmëri të merremi vesh duke bërë lëshime të sikletshme, por këtë herë duket se forca që na ndan është më e madhe se nevoja për mbijetesë politike që na afron. Duket si një krizë politike, që vjen nga domosdoshmëria historike për të krijuar një ekuilibër të ri ndërmjet partive tona dhe të ardhmes së shqiptarëve.

Kam folur disa herë në këtë foltore për përpjekjet e përbashkëta për vetërregullim në vend të vetëshkatërrimit, por, mesa duket, po shkojmë drejt një situatë konfuciane. Jashtë nesh është Shqipëria me problemet dhe aspiratat e saj, që tani po bën pauzë. Skenën e debatit politik e ka marrë të gjithën politika. Nuk ka kosto më të madhe se kjo për vendin, ndaj më 30 qershor duhet të votohet. Ne nuk mund të kërkojmë një

datë të re, sepse nuk na ka munguar koha, nuk na ka munguar hapësira për rrugëzgjidhje, por na ka munguar vetëdija për dëmin që paguan çdo familje shqiptare.

Më 30 qershor duhet të votohet që të rifillojmë për punët e mëdha, të flasim për të rinjtë, për studentët, për arsimin, për shëndetësinë, për ristrukturimin ekonomik, për punësimin, për fëmijët, për pensionet, për qytetin, për fshatin, për reformën në drejtësi, të flasim për Shqipërinë reale. Kjo është Shqipëria e njerëzve që takojmë çdo ditë në rrugë, në park, në njësitë e shërbimit, ku gjithmonë dëgjojmë ose ndiejmë dëshpërim për atmosferën politike, që për ta përkthehet në më pak shitje, më pak...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Peleshi!

Fjalën e ka deputeti Halil Jakimi. Të përgatitet deputetja Mimi Kodheli dhe më pas ministrja Etilda Gjonaj.

Halil Jakimi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot po zhvillojmë një mocion me debat në lidhje me vendimin që mori Presidenti i Republikës për zhdekretimin e datës së zgjedhjeve. Po debatojmë për një projektrezolutë, e cila, në gjykimin tim, i jep një vërejtje me shkrim Presidentit si një qortim nga maxhoranca për aktin e marrë, duke dënua këtë akt si akt kundër Kushtetutës.

Presidenti, në shpjegimet e tij, është nisur nga shmangia e përplasjes civile, nga gjithëpërfshirja në zgjedhje, nga respektimi i pluralizmit politik.

Të nderuar qytetarë,

Sot nga kjo foltore dua t'ju bëj me dije se nuk shoh asgjë më shumë, nuk lexoj asgjë më shumë e as më pak nga ajo që shihni dhe lexoni ju jashtë kësaj sale në lidhje me krizën politike në vend. Ndaj të njëjtin mendim me pjesën dërrmuese të qytetarëve shqiptarë, e kam fjalën për një politikë të mbrapshtë 30-vjeçare, një politikë, e cila ka prodhuar kriza morale, shoqërore, politike dhe përfaqësimi, ku politikanët tanë, në vend që të gjejnë gjuhën e përbashkët për problemet që i bashkojnë, gjejnë gjuhën t'i bëjnë akoma më tërkuzë problemet që i ndajnë.

Qytetarë,

E kam fjalën për bindjen që keni se këta janë bashkë dhe, kur është dashur, kanë zgjidhur probleme edhe më të mëdha, kanë ndërhyrë në Kushtetutë, në ligje, në parime, në norma vetëm për të arritur qëllimin, siç ka thënë edhe filozofi francez Monteskie “Qëllimi justifikon mjetin”. Qëllimi i tyre dihet, mbajtja e pushtetit me çdo kusht dhe çdo mjet brenda një qarku të mbyllur dhe ndërrimi i këtij pushteti po brenda këtij qarku dhe në po të njëjtat duar dihet.

Ka 30 vjet që luajnë shah me njëri-tjetrin dhe qytetarëve u shesin dokrra; kanë zënë karriget dhe nuk i lëshojnë, se e kanë kapur sistemin në atë mënyrë, saqë është e pamundur të bëhet ndërrimi i elitave të reja politike apo zëvendësimi i këtyre që janë.

Janë populistë në kulm, saqë nuk u gjendet shoku. Për 30 vjet rresht flasin në emër të popullit që të gjithë, pa përjashtim, ndërsa popullit sot nuk i qahen hallet, ai përballat me papunësi në kulm, varfëri, taksa të larta, paga të vogla, pensione të ulëta, mungesë të marrjes së shërbimeve në sektorë të ndryshëm të vendit, në arsim, në shëndetësi, bujqësia nuk ka rendiment fitimi dhe kemi edhe një fenomen edhe më të ndjeshëm që është braktisja e vendit nga rinia, nga forca më vitale e shoqërisë shqiptare dhe nga të rinj të arsimuar, nga studentë. Kjo kërkon një mocion debati sot dhe jo këto lojëra politike mes njëri-tjetrit, kur vetë Partia Socialiste e ka zgjedhur Presidentin.

Kjo kërkon debat dhe ne, lidhur me këtë, do të kërkojmë të bëhet debat. Ne këtu flasim ende: ka zgjedhje, nuk ka zgjedhje, me opozitën, pa opozitën, kjo është e papranueshme. Politika shqiptare në këta 30 vjet vetëm një gjë ka arritur ta bëjë mirë, pasi u ka ngulitur në mendje shqiptarëve politikë pa fund, sepse është një fenomen që, kur sheh dy shqiptarë bashkë, është e pamundur të mos flasin për politikë. Është e pamundur, pasi këtu kontrollohet çdo emision, çdo hapësirë televizive me analistët apo pa analistët tuaj, vetëm politikë u serviret shqiptarëve nga mëngjesi deri në darkë. Kjo jo vetëm në këto kohë krize politike, por pothuajse gjatë gjithë kohës.

Jetojmë në një sistem ku nuk ka asnjë mundësi që të krijohen elita të reja politike, pasi sistemi zgjedhor njihet si padronë dhe menaxherë vetëm kryetarët e partive dhe një grup njerëzish vicioz të një rrethi vicioz rreth tij. Listat hartohen

vetëm nga kryetarët dhe riciklimi i njerëzve pa integritet, pa nivel, pa moral, pa personalitet i sheh ata të ulur në karriget më të larta të pushtetit falë deformimit të padrejtë që i bëhet votës së qytetarëve shqiptarë. Diku në një studim lexova, nuk e mbaj mend se ku, se rreth 76% e qytetarëve shqiptarë nuk dinin se kë kishin përfaqësues dhe deputet të zonës së tyre. Unë nuk jam jurist me profesion dhe nuk futem në debate për interpretimin e Kushtetutës së Shqipërisë, por jam i vetëdijshëm që është Gjykata Kushtetuese ajo që vendos, dhe që Shqipëria do të ketë zgjedhje të lira dhe të ndershme vetëm kur të ketë funksionim të të gjitha institucioneve ligjzbatuese në vend, të ketë Gjykatë Kushtetuese, të ndryshohet sistemi i funksionimit, siç e kam përmendur edhe në fjalimet e mia të mëparshme, të partive politike dhe doemos ndryshimi i sistemit të Kodit Zgjedhor.

Kryeministri foli për pazar, për marrëveshje, për negociata, për arsytet që kanë çuar dy herë në shtyrjen e zgjedhjeve, por nuk tha asnjë fjalë për ndryshimin e Kodit Zgjedhor. Për mua i rëndësishëm është stabiliteti politik i vendit në situatën ku jemi dhe asgjë më shumë se ky stabilitet politik nuk vlen të diskutohet këto ditë. Nuk ka rëndësi data e zgjedhjeve, por i rëndësishëm është zbatimi i pluralizmit politik, gjithëpërfshirja dhe gjithëpjesëmarrja në një proces të drejtë demokratik.

Në mbyllje të fjalës sime më lejoni t’ju kërkoj t’i hidhni sytë përtej rreziqeve së sotme dhe të vështroni në shpresat e së ardhmes. Nëse parimi i bashkëpunimit do të sillte zgjidhjen e ngërçit politik, atëherë le të bashkohen të gjitha palët për një rrugë të re, për një përpjekje të re, jo për një balancë të re force, por për një Shqipëri të re të ligjit, për një Shqipëri europiane, ku i drejti është i fortë, i dobëti është i sigurt dhe paqja është e mbrojtur. Le të mos negociojnë kurrë nga frika, por të mos kenë kurrë frikë nga negociata.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Jakimi!

Fjalën e ka deputetja Mimi Kodheli.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolege!

Kolegë,

Dje, Partia Socialiste festoi 28-vjetorin e krijimit. Rruga e saj për të ardhur deri këtu ku është sot ka qenë një rrugë e gjatë dhe shpeshherë paragjyquese me pa të drejtë.

Emancipimi i saj ka kaluar sfida dhe ka mbajtur gjallë jo vetëm pluralizmin, por edhe demokracinë funksionale. Edhe Partia Demokratike apo opozita në përgjithësi, e cila e mban po aq gjallë pluralizmin, paçka se shpesh e ka dëmtuar në ndërtimin e një demokracie funksionale, ka qenë pro pluralizmit, por demokracinë funksionale jo domosdoshmërisht e kemi parë të funksionojë, siç edhe e ka emrin. Madje, për fat të keq, disa herë është bërë shkas i mosfunksionimit të institucioneve demokratike, pengesë për krijimin e tyre dhe protagoniste për kriza institucionale. Në momentin kur me 100% të votave kuvendore miratua ndryshimet kushtetuese dhe reformën në drejtësi shpresova që gjërat do të merrnin për mirë dhe shoqëria jonë, bashkë me të edhe politika, do të mund të realizonin një katarsis aq të nevojshëm, për shkak të batakut ku kishim rënë asokohe. Drejtësi e munguar apo e njëanshme, e korruptuar, joprofesionale, pa integritet; ekonomi tregu e monopolizuar dhe deformuar për shkak të rregullave jo të drejta të lojës; institucione dhe administratë e politizuar dhe jo e përshtatshme; politikë mendjeshkurtër dhe e marrë peng; shtet i dobët ligjor dhe demokraci e pazëshme. Por për fat të keq në mes të lojës bojkoti i garës politike u kthye në një bojkot të demokracisë, në një bojkot të interesave të votuesve.

Zonja Ministre, do t'ju lutesha të mos më shqetësoni gjatë kohës që jam duke folur, sepse dëgjoheni shumë këtu! Ju kërkoj ndjesë!

Bojkoti i sotëm politik, pavarësisht se në emër të qytetarëve, është, në fakt, thjesht dhe vetëm një tutje e madhe nga reforma në drejtësi, që pa dyshim shumëkujt i rri si shpata e Demokleut mbi kokë. Miqtë tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian, kanë diktuar rregulla loje jo vetëm për veten, por edhe për ne, ndaj nëse do të mund të arrijmë një ditë të jemi si ata, kjo rrugë kalon pikërisht nëpërmjet këtyre reformave, nga kjo mënyrë e funksionimit të sistemit, zgjedhje parlamentare dhe parlamentarizëm aktiv, dhe këtu pa dyshim nuk kam parasysh as vezët dhe as miellin, por debatin politik, zgjedhjet lokale dhe funksionimin e pavarur të këtij pushteti dhe këtu e kam fjalën edhe për zgjedhjet e 30 qershorit, konsolidimin e shtetit, *fare play* dhe *free market*.

Të nderuar kolegë,

Ne nuk besojmë te fitorja aforfe, megjithëse të tilla ka, por nuk do të mund të pranojmë të luajmë me rregulla të ndryshuara afër fundit të lojës, po aq sa nuk besojmë te njëanshmëria me të cilën arbitrohen shpeshherë interesat e përbashkëta, sidomos ato kombëtare. Kompetencat e arbitrit janë të qarta, ai ndërhyr kur ka krizë institucionale jo kur ka krizë politike të një pale. Ndërkaq, kjo metaforë nuk do të thotë se politika sot është një sport, aq më pak bojkoti dhe akoma më pak demokracia dhe fatet e vendit, ndaj le të jemi seriozë dhe le t'u rrimë fort shtyllave që mbajnë në këmbë demokracinë.

Të dashur qytetarë,

Ju drejtohem juve me shpresën se askush nga ju nuk do të më gjykojë për ngjyrimin tim politik, por do të vlerësojë opinionin tim! Ne jemi bij të një nëne dhe flasim të njëjtën gjuhë. Ne jemi pak, madje shumë pak, ndaj nuk duhet të jemi të ndarë dhe kurrë nuk duhet ta urrejmë njëri-tjetrin. Janë të shumtë ata përreth nesh që nuk duan të na shikojnë në Europë dhe as të na shikojnë në unitet, përkundrazi, fërkojnë duart kur televizionet e tyre transmetojnë pamjet e dhunës. Ne nuk kemi pse të bëhemi justifikim për veprimet antikushtetuese të askujt dhe as mburojë e pazarllëqeve të politikës së vjetër. Ndaj, ju ftoj të dalim mbi palët, mbi politikën dritëshkurtër dhe të mbrojmë votën tonë, të ardhmen tonë europiane jo duke i qëndruar përballë njëri-tjetrit, por duke qëndruar krah për krah, pavarësisht bindjeve politike.

Ju ftoj të votoni më 30 qershor!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Kodheli!

Fjalën e ka ministrja Etilda Gjonaj.

Të përgatitet deputeti Enver Roshi.

Etilda Gjonaj - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Shqiptarët e kanë fituar të drejtën të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në nivel qendror dhe vendor nëpërmjet zgjedhjeve të lira, të barabarta dhe periodike.

Vota e shqiptarëve dhe e drejta e tyre për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre është e shenjtë dhe mbrohet nga Kushtetuta, nga legjislacioni zgjedhor, si dhe nga ligji penal.

Sipas Kushtetutës, Presidenti i Republikës ka detyrimin dhe kompetencën të caktojë datën e zgjedhjeve, por Kushtetuta nuk ka parashikuar asnjë të drejtë të Presidentit dhe as mundësinë për të zhbërë datën e vendosur të zgjedhjeve. Arsyeja pse i është lënë kjo kompetencë Presidentit është për shkak se ai përfaqëson unitetin e popullit dhe, si subjekt asnjans, atij i është lënë detyra për të shpallur garën ndërmjet partive politike për zgjedhjet.

Dekreti për të zhbërë datën e zgjedhjeve është një akt totalisht i nxjerrë në mungesë të kompetencës së Presidentit, si dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin.

Kodi Zgjedhor i përcakton shumë qartë procedurat, afatet dhe rolin e Presidentit në caktimin e datës së zgjedhjeve, duke përcaktuar edhe periudhën zgjedhore. Legjislatori i ka kushtuar një rëndësi të jashtëzakonshme periudhës se kur mbahen zgjedhjet dhe fakteve se kurrësi këto zgjedhje nuk mund të mbahen pas përfundimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore.

Presidenti me dekretin për të shfuqizuar datën e caktuar të zgjedhjeve, duke rrezikuar zhvillimin e zgjedhjeve para datës 10 gusht, mund të çojë në situatën antikushtetuese dhe të paprecedent, ku të gjitha organet e qeverisjes vendore në vend të qëndrojnë në funksion përtej mandatit kushtetues. Për më tej, ky dekret i pavlefshëm e fut vendin në një pasiguri totale.

Edhe sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, mandati i organeve kushtetuese nuk mund të zgjatet pa një rregull kushtetues që e lejon këtë. Ne jemi para situatës, ku Presidenti me një dekret, në tejkallim kompetencash, anashkalon rregullimet kushtetuese për mandatin e organeve të qeverisjes vendore.

Duhet vënë në dukje se çdo dekret, që do të nxjerrë Presidenti tashmë për të caktuar një datë të re për zgjedhjet vendore, do të jetë në shkelje të Kodit Zgjedhor, po ashtu do të jetë një shkelje e rëndë e Kushtetutës.

Në këtë kuptim, çdo dekret i ri i Presidentit për caktimin e një date tjetër të zgjedhjeve dhe për mosmbajtjen e tyre në datën 30 qershor të vitit 2019, do të jetë shkelje kushtetuese dhe ligjore, si dhe do të krijojë një gjendje pasigurie të vazhdueshme juridike për funksionimin e demokracisë në Shqipëri.

Presidenti me këtë akt pengon të drejtën e shtetasve për të zgjedhur, duke cenuar kështu një të drejtë kushtetuese. Gjendja e pasigurisë së vazhdueshme juridike, duke cenuar zgjedhjet e 30 qershorit, nuk duhet të kërcënojë demokracinë dhe institucionet shtetërore demokratike, aq më tepër Presidentin e Republikës.

Besimi se reforma në drejtësi më në fund do të jetë vija ndarëse e tranzicionit të gjatë shqiptar, kërkohet të tronditet me gjendjen e pasigurisë së vazhdueshme juridike. Besimi se nëpërmjet reformës në drejtësi ne do të jemi në gjendje të forcojmë shtetin e së drejtës, kërkohet të tronditet me lajme për trazira civile.

Duhet ta kuptojnë njëherë e mirë se reforma në drejtësi dhe besimi i shqiptarëve në një shtet modern europian është e pakthyeshme dhe nuk ka asnjë kërcënim për trazira civile apo për moslejimin e zhvillimit të zgjedhjeve, që mund ta trondisë besimin e shqiptarëve në luftën tonë të drejtë për të çliruar sistemin e drejtësisë nga korrupsioni, nga kapja prej krimit të organizuar, nga kapja apo ndikimi nga politika.

Shfuqizimi i të drejtës së shqiptarëve për të votuar dhe lufta që bëhet kundër reformës në drejtësi ka si qëllim pikërisht: të shkatërrojë themelet për të pasur një shtet modern, me qëllim që të ruajnë në pafundësi kontrollin politik mbi shqiptarët.

Fakti që partnerët ndërkombëtarë kanë dhënë mbështetjen e tyre për zgjedhjet e 30 qershorit, nuk është rastësi, por argument se kjo që po bëjmë, është rruga e duhur, pasi 30 qershori është respektimi i standardeve europiane.

Zgjedhjet e 30 qershorit janë domosdoshmëri për reformën në drejtësi, pasi askush nuk mundet të mbajë peng klimën politike dhe parlamentare si një mundësi për të delegitimuar dhe për të penguar zbatimin e reformës në drejtësi.

30 qershori është domosdoshmëri, pasi do të thotë respektim i Kushtetutës dhe i ligjit, do të thotë respektim dhe garantim i të drejtës së qytetarëve për të votuar.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Fjalën e ka deputeti Enver Roshi.

Të përgatitet ministri Sandër Lleshaj dhe më pas deputeti Kostaq Papa.

Enver Roshi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Në historinë e pluralizmit 30-vjeçar të Shqipërisë, popullin e këtij vendi e ka mbajtur shpresa e madhe për ta parë vendin e tij si vendet e BE-së, me mirëqenie të mirë, ku të sundojë dhe të zbatohet ligji me korrektësi. Një ndër kombet më të vjetra në kontinent, një ndër kombet më të etura për të hyrë në Europë, ku 95% e shqiptarëve kanë aspiruar dhe aspirojnë të jenë pjesë e këtij qytetërimi mijërvjeçar, sot e 30 vjet lihet jashtë Europës, ku natyrshëm duhet të jetë vendi i tyre. Sot dhe gjatë gjithë kohës kjo ëndërr zvarritet nga politika e mbrapshtë në Shqipëri.

Populli shqiptar kërkon që të hyjë në Europë, por nuk mundet, sepse politikanët e këtij vendi nuk duan ta integrojnë vendin në Europë, ndryshe nuk ka si të shpjegohet që këtë ëndërr 500-vjeçare, të ndaluar nga pushtimi i gjatë dhe gjakatar otoman, po e ndalon sot një pjesë e politikës shqiptare, të cilët nuk duan ta shikojnë vendin e tyre në Europë.

Çfarë i pengon vallë politikanët? Mundësitë u janë dhënë dhe besuar nga populli për të qenë në pushtet që në fillim të viteve '90 dhe për të realizuar ëndrrën e shqiptarëve dhe studentëve për ta bërë Shqipërinë si gjithë Europa. Por etja e tejskajshme për pushtet të pakufizuar, për të qenë me hir ose pahir në pushtet, errësimi për të parë dhe lexuar realitetin shqiptar me sy hapur, ashtu siç është, që në vetvete është aq kompleksiv dhe shpeshherë i çuditshëm, e kanë bërë klasën politike të bëjë faje e gabime dhe faj pas faji e ka shndërruar këtë klasë politike dhe liderët e saj në mëkatarë, aq sa nuk mund t'i lajnë dot lumenjtë dhe kultet fetare të Shqipërisë. Vetëm si pasojë e ligjit nr. 7501 në të gjithë vendin janë rreth tetë mijë të vrarë për çështje prone. Për gjyqet e fituara nga ish-pronarët në Gjykatën e Strasburgut do të paguhet miliona euro nga gjaku dhe djersa e këtij populli.

Sipas Profesor Doktor Gëzim Boçarit më shumë se tetë mijë shqiptarë janë vrarë dhe më shumë se pesëqind familje janë ngujuar deri më sot për shkak të anarkisë me të drejtat e pronësisë. Ky problem ka shumë vjet që ngrihet në raportet e Avokatit të Popullit dhe Komitetit të Pajtimit Kombëtar.

Zgjedhjet e 26 majit 1996 do të mbeten si njolla më e zezë e historisë së Shqipërisë së

pluralizmit, duke u shoqëruar me dhunë të ushtruar mbi opozitën dhe popullin, humbje të kompanive rentiere të inkurajuara nga politika në vitin 1997, me dyqind milionë dollarë të humbura dhe rreth katër mijë civilë të vrarë, me qindra e mijëra të tjerë të plagosur dhe gjymtuar, invaliditetin e të cilëve do ta paguajnë breza të tërë.

Për nga raporti i ndeshjes polic-krim jemi vendi i parë në botë me 264 policë të vrarë, ndërkohë që duhet të ishte ndryshe. Kemi më shumë policë të vrarë sesa kriminelë. Kjo është lebetitëse. Nuk krahasohemi me asnjë vend, sepse politika nuk ka qenë e aftë të parashikojë, parandalojë, neutralizojë dhe godasë krimin, por përkundrazi është vënë shpeshherë në shërbim të tij.

Ngjarja e Gërdecit, me viktimë, gra dhe fëmijë, 300 të plagosur dhe me trauma psikologjike vazhdon të shoqërojë jetën e komunitetin të asaj zone.

Niveli i lartë i stresit është një nga më të lartit në kontinent e më gjerë. Krimi dhe stresi i shkaktuar nga pasiguria politike dhe cilësia e ulët e shërbimeve ndaj qytetarëve gjatë këtyre viteve kanë rritur së tepërmi ankthin, depresionin, vetëvrasjen, konfliktin në familje dhe jashtë saj, divorcet, numrin e fëmijëve që mbeten pa prindër dhe kujdesje, dhunën dhe vrasjet që shfaqen me humbjen e qetësisë dhe kontrollit social nga qytetarët e këtij vendi.

Sipas një studimi të kryer në QSUT në vitin 2000 me 1100 individë, rezultoi se stresi ishte faktor madhor i infarktut të miokardit dhe hemorragjisë cerebrale, me pasoja që vinin nga pasiguria e jetës, humbja e familjarëve dhe traumat e rënda psikologjike.

Të gjitha këto janë pjellë e politikës dhe politikanëve, të cilët për të ruajtur pushtetin e tyre i vunë zjarrin vendit. Asnjë i dënuar, drejtësia zero.

Më vjen keq, por poema e Naim Frashërit për bukuritë natyrore të këtij vendi ka ikur dhe nëse do të ishte gjallë Migjeni, me një poemë të vetën për atë që është bërë me natyrën shqiptare, ndoshta do të merrte çmimin Nobel. Unë nuk i gjej lumenjtë, luginat dhe pyjet e lartë që janë djegur dhe prerë në mënyrën më shtazarake. Me qenien pushtetar në Shqipëri klasa politike ia ka kaluar çdo shembulli kombëtar, ajo është kthyer në një tufë hienash, çdo gjë për vete, çdo gjë që

nuk është e saj nuk duhet ruajtur, ajo që nuk më përket mua, nuk i duhet askujt.

Askush nuk ka dhembshuri për këtë vend. Ajo pjesë idealistësh që ka qenë, tani janë bërë pesimistë dhe me plot gojën thonë që Shqipëria nuk bëhet.

Këtu më i forti i lagjes është më i fortë se shteti, ligji dhe gjykata. Prej 30 vjetësh me dhjetëra njerëz përpiqen të marrin arratinë për shkak të politikës. Unë sot flas në emër të njerëzve të varfër të këtij vendi, që gjatë gjithë viteve të demokracisë kanë pritur me shpresën e madhe të ndërtohet ujësjellësi, rruga, kanalizimet, shkolla dhe shërbimi shëndetësor më cilësor, flas në emër të të rinjve shqiptarë, të cilët duan të gjejnë shpresën në këtë vend, të mos emigrojnë jashtë vendit. Arsimi i lartë është goditur në palcë prej shumë vitesh dhe paralizuar me universitete të ngritura si kioska, ku i paafti zuri punë në vend të të aftit. Edhe sot një pjesë e mirë e tyre janë akoma në detyra shtetërore, kurse të aftët vërtiten me diploma në universitete dhe nuk gjejnë dot derën të futen, sepse ua kanë zënë dyert të paaftët.

Me sytë nga televizioni të gjithë presin çfarë thotë politika. Për të thënë, themi shumë, por bëjmë shumë pak ose aspak.

Çfarë po prodhon kjo krizë politike? Kjo është kriza e disa politikanëve, të cilët për vite me radhë kanë prodhuar mungesë stabiliteti politik dhe gjithë pasojat e tjera që vijnë prej saj, duke cenuar rëndë sigurinë kombëtare të vendit, rritur varfërinë dhe gjithçka që del prej saj. Shqiptarët nuk ua kanë borxh këtë, pasi sistemi i kapur politik është ushqyer dhe mbjellë nga kjo kastë politike e ngushtë, që qarkullon sa të njëra palë tek tjetra. Shqiptarët nuk na kanë borxh shthurjen e rendit, mungesën e ligjit dhe shërbimeve, pasi vetë politika i ka ushqyer me të gjithë mënyrat njerëzit e thjeshtë që të varen nga politika dhe të mos shikojnë mundësi të tjera që jep sistemi i demokracisë në një vend të lirë bujqësor, blegtoral dhe industrial.

Politika është futur në çdo qelizë dhe ka ndryshuar edhe ADN-në qelizore, që çdo gjë ta lidh me politikën, aq sa njerëzit zgjohen me politikë dhe flenë me politikë. Aq shumë ua kemi lodhur dhe zhgënjyer mendjen njerëzve.

Për interesin e saj, politika është në gjendje të bëjë ndryshime ligjore kushtetuese, siç është sistemi zgjedhor i propozuar në vitin 2009, i cili

nuk prodhoi cilësi, meritë dhe profesionalizëm, por rriti edhe më shumë mënyrën korruptive teksa votuesit shqiptarë nuk votonin individin, por subjektin, i cili nga ana e vetë ka sistem të mbyllur listash deputetësh. Në gjithë këto vite janë bërë qindra ligje, mijëra nene, amendime ligjesh, por pothuajse të gjitha ose një pjesë e madhe e tyre janë për t'u hedhur në kosh, sepse asgjë nuk zbatohet.

Ne, deputetëve, kuraja dhe vendimarrja për të hyrë në parlament na u nxit nga dëshira e brendshme për t'i shërbyer vendit, duke e parë këtë si mundësinë më të mirë për të qenë shërbëtorë të vendit. Kuraja dhe përgjegjësia intelektuale na shtynë t'i kërkojmë klasës politike të jetë e përgjegjshme për fatet e kombit.

Shumë flitet dhe bëhet, por pse opozita jashtë nuk qëndroi në këtë sallë që të kërkonte dhe punonte për të gjitha ligjet e reformës në drejtësi, nismat që duheshin për çeljen e negociatave me Bashkimin Europian, reformat në sistemin zgjedhor dhe pse pas 9 muajsh refuzon të marrë pjesë në zgjedhjet lokale? Kujt i shërben politika e rrugës? Kujt i duhen flakadanët dhe bombat molotov kundër institucioneve shtetërore? Kujt i duhet pasiguria e vendit dhe mungesa e stabilitetit? Si ka mundësi që opozita në Shqipëri ngre njerëzit kundër institucioneve shtetërore, e pakrahasueshme kjo me asnjë vend me demokraci, aq më tepër anëtar i NATO-s? Vetëm popullit i takon e drejta të djege dhe shkatërrojë institucionet dhe t'i vërë përpara përgjegjësisë politikanët e vendit të vet kur nuk i shërbejnë popullit, kur ky popull nëpërkëmbet, nuk i zgjidhen hallet, por ironizohet, etiketohet dhe përbuzet. Politika nuk mund të ushqejë luftën, vëllavrasjen dhe të vihet në krye të turmave për të djegur dhe shkatërruar. Ky është infantilizëm politik, papjekuri dhe primitivizëm.

Kujt ia kanë borxh shqiptarët varfërinë, vrasjen e shpresës për të ardhmen, pasigurinë, mungesën e investimeve, humbjet ekonomike nga turizmi duke mbjellë faturën e frikës së ardhjes së të huajve në Shqipëri?

Si mundet që politikanët shkojnë në zyrat e Brukselit dhe kudo në Europë dhe në vend që të përfaqësojnë Shqipërinë, të integrojnë vendin, të flasin me zërin e mirë të Shqipërisë, për faqe të zezë, zihen në sytë e tyre, për armiq të këtij vendi. Nuk mund ta imagjinoja këtë 30 vjet më

parë. Kjo ndodh vetëm me politikanë të këtij vendi dhe nuk ndodh në vende të tjera përreth.

Çfarë faji ju ka kombi? Kjo ndodh, sepse dikush aspirojnë të vijë në pushtet përmes krizave, pasigurisë, demonstratave të dhunshme, përmes sharjeve dhe shpifjeve. Kjo nuk është as politikë, as opozitë dhe as pozitë.

Ne jemi kundër bojkotit parlamentar, jemi kundër të bërit politikë në rrugë, me djegie, plagosje dhe vrasje djemsh dhe vajzash police, jemi kundër të bërtiturit, klithjeve fyese dhe sharjeve. Ky popull nuk na e ka borxh këtë. Boll ka derdhur gjak rinia dhe shqiptarët për demokraci. Tani për të mbajtur ose ardhur në pushtet duhen dëshmorë!? Kush është armiku ynë? Jemi për qetësi, mesazhe paqeje, bashkëpunimi, dialogu dhe negociimi, ulje në tryezë, bisedime dhe zgjidhje afatgjatë, që ky popull të mos vuajë më. Është klasa politike ajo që me çdo çmim djeg Shqipërinë, pengon integritetin europian të vendit, nxit urrejtjen, cenon sigurinë dhe rrit mungesën e stabilitetit. Kush e kërkon destabilizimin e Shqipërisë? Kush e kërkon që vendi të mos ketë investime, të ketë varfëri, pasiguri dhe stabilitet? Populli jo, Amerika jo, Anglia jo, Franca jo, Gjermania jo, vendet e KE-së jo, kurse politikanët po. Këta e duan Shqipërinë të varfër dhe të këputur. Kujt i dedikohet shprehja “nuk bëhemi”, apo “ky vend nuk bëhet”?

Politika nuk e lë këtë vend të qetë. “Shqipëria lindi nga Zoti, shpëtoi nga rastësia, do të vdesë nga politikanët”, ka thënë Konica 100 vjet më parë.

Edhe sot kur i kemi të gjitha mundësitë, sepse na i ka krijuar populli, sërish dalin politikanë në skenë për të vrarë këtë popull dhe ëndrrën e tij europiane.

Unë si deputet dëgjoj zërin e popullit, zërin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila ka më shumë se 100 vjet që investon për ta bërë Shqipërinë shtet me institucione dhe kombin më të fortë në Ballkan. Nëse jemi kundër popullit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, atëherë nuk jemi shqiptarë dhe nuk e duam këtë vend, pra, kemi marrë damkën e tradhtisë. Prandaj, le t'i hyjmë punës pa vonesë dhe në mënyrë emergjente të hartojmë çdo gjë që duhet për reformën në drejtësi, për çeljen e negociatave me BE-në, për një sistem zgjedhor me lista të hapura, konkurrencë të ndershme vlerash,

intelektualizëm, për t'i kthyer këtij vendi dhe Kuvendi parlamentarizmin e duhur, me diturinë, mençurinë, dinjitetin dhe dëshirën për të bërë më të mirën për atdheun dhe kombin tonë të shumëvujtur.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjalën e ka ministri Lleshaj.

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar deputetë,

Për fat të keq, Presidenti i Republikës ka dëshmuar në mënyrë krejt të veçantë një lexim ndryshe të Kushtetutës dhe të kuptimit për rolin e tij në sistemin tonë kushtetues dhe demokratik. Është krejt pa kuptim arsyetimi se çdolloj autoriteti mund të zhbëjë përmes anulimit apo zhdekretimit akte të nxjerra më parë prej tij. Sipas një logjike të tillë, një mësues mund ta zhdekretonte notën e dhënë dikur dhe të na degdiste në klasën e parë krejt papritur, një shitës mund ta zhdekretonte kontratën e shitjes së shtëpisë dhe të na nxirrte përsëri në rrugë, ndërsa Kuvendi mund ta zhdekretonte edhe vendimin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës dhe ta dërgonte përsëri atë tek partia e tij e kështu me radhë.

Zoti Meta ka dëshmuar vazhdimisht një oreks shumë të madh për kompetenca, të cilat, për fat të keq, Kushtetuta jonë nuk mund t'ia plotësojë. Këmbëngulja e tij për të marrë rol substancial në emërimin e ministrit të Brendshëm apo bllokada e tij e paprecedentë për të mos dekretuar ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme janë dëshmi e një kuptimi shumë të shtrembër, madje dhe të rrezikshëm për të marrë kompetenca, të cilat populli shqiptar nuk ia ka deleguar atij përmes Kushtetutës.

Sigurisht, janë mjaft problematike precedentët e krijuar me dekretimin e ministrave, por ajo që u tentua me zhdekretimin e zgjedhjeve ka një përmasë krejt të veçantë. Zgjedhjet janë institucioni më i epërm në një sistem demokratik dhe në një farë mënyre ato nuk caktohen, por thjesht vijnë. Pavarësisht dëshirave, planeve apo vullnetit të partive politike, ato vijnë në mënyrë të pashmangshme ashtu siç vjen mëngjesi, muaji, stina apo viti. Ato vijnë si vullnet dhe e drejtë e patjetërsueshme e popullit shqiptar.

E dimë se ardhja e mëngjesit nuk mund të shtyhet, sepse dikush dëshiron të flejë pak më

gjatë, ashtu sikundër ardhja e dimrit nuk mund të negociohet nga ata që nuk janë të përgatitur për ta pritur ashpërsinë e tij.

Nuk është arsye për anulimin apo shtyrjen e zgjedhjeve fakti që dikush, qoftë edhe parti politike, nuk i do apo nuk është i përgatitur për to, por në datën 10 qershor 2019, vetëm 20 ditë para zgjedhjeve, në mes të fushatës, shqiptarët u njohën me dekretin për anulimin e tyre, i cili shprehte vullnetin e vetëm një personi, pra Presidentit të Republikës sonë parlamentare.

Pas leximit të dokumentit presidencial me titull “Arsyet për shfuqizimin e dekretit”, rezultoi pak a shumë kjo narrativë: meqenëse kemi një tentativë për të marrë peng sistemin nga një grup i caktuar politik, atëherë le të dalim jashtë tij dhe të kërkojmë zgjidhje përtej Kushtetutës. Meqë jemi në kushtet e një pengëmarrjeje, atëherë le të negociojmë me pengmarrësit. Këtu vlen të mos harrohet një parim me shumë vlerë: “asnjëherë nuk lejohet shpërblimi i pengmarrësve”. Nëse kjo do të ndodhte sot, nesër do të na shfaqen shumë pengmarrës të tjerë të inkurajuar nga suksesi i të parëve.

Një ndër arsyet për shfuqizimin e dekretit, krahas të tjerash, sipas Presidentit, lidhet me sigurinë kombëtare. Citoj: “Presidenti, si kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, ka vënë re se sjellja e aktorëve politikë në vend ka krijuar një klimë të theksuar konflikti që rrezikon stabilitetin e rendit publik”.

Presidenti nuk është aty për të vënë re, por për të ushtruar përgjegjësi kushtetuese dhe institucionale. Në vend të vërejtjeve subjektive të Presidentit, publikut i duhen konkluzione të institucioneve që kanë përgjegjësi kushtetuese për sigurinë e vendit.

Përballë një rreziku kaq serioz të pretenduar nga Presidenti, do të duhej që ai si kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare ta kishte mbledhur Këshillin e Sigurisë Kombëtare për të analizuar gjendjen e sigurisë në vend, por, në vend të kësaj, ai thjesht ka konstatuar apo perceptuar në mënyrë subjektive vetë rrezikun dhe po vetë, në mënyrë të njëanshme, ka gjetur edhe përgjigjen ndaj tij duke shpërfilluar rolin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare apo institucioneve të tjera përgjegjëse në vend.

Tentativa për ta nxjerrë diskutimin për sigurinë kombëtare jashtë institucioneve

kushtetuese dhe për shndërrimin e kësaj teme në një argument të rëndomtë politik.

Duke parë që koha po vjen drejt fundit, do të them një fjali. Debati i sotëm është me rëndësi për demokracinë në vend dhe shtrohet çështja: a ka nevojë vendi sot për tolerancë? Nëse unë do t’i referohesha filozofit të madh, Karl Popper, do të thosha se toleranca në kushte të tilla është e dëmshme, madje e rrezikshme. Ai thotë: “Toleranca pa kufi na çon në zhdukjen e vet tolerancës. Nëse ne tregojmë tolerancë pa kufi edhe ndaj atyre që janë intolerantë, nëse ne nuk jemi në gjendje dhe të përgatitur ta bëjmë një shoqëri tolerante me bazë sulmin e intolerantëve, atëherë tolerantët do të shkatërrohen dhe bashkë me ta edhe vet toleranca”.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Lleshaj!

Fjalën e ka deputeti Kostaq Papa. Të përgatitet ministri Majko dhe më pas deputeti Ligoraq Karamelo.

Kostaq Papa – Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Motra dhe vëllezër,

Dy thënie populllore: “Çfarë mbjell, do të korrësh” dhe “Çfarë gatuan, do të hash” janë kuptimplote dhe u shkojnë për shtat episodeve të freskëta prej frigoriferit për telenovelën që ka zënë ekranet. Thirrëmi për ndihmë për shkokolepsjen e situatës kur ne nuk kemi pasur asnjë ndikim në çorbën e gatuar politike. E gatuar vetë. Gëlltiteni ose hidheni! Erdhi momenti të përplaseni me rivalësh, mes gladiatorësh të rremë, por fatin e gladiatorit e ka në kurriz populli. Hajini kokën njëri-tjetrit dhe mos kërkonin ndihmën tonë! Ne nuk ju ndihmojmë dot, sepse marrëzitë tuaja nuk janë vetëm një, nuk është vetëm kjo përballje, por janë 101, sikurse është gjendja e mjeruar e popullit, grabitja e madhe që u është bërë pasurive kombëtare, shitja e interesave kombëtare, importimi në Kosovë i politikave të gabuara të klasës politike të Tiranës, kapja e shtetit nga një grup apo klan oligarkësh e mafiozësh, politika pa vizion ndaj progresit të kombit, kriminalizimi dhe drogëzimi i çdo sektori të jetës në vend, krijimi i së keqes si simbolikë pozitive për të çarë në jetë përmes krimit, vjedhjes, drogës, prostitucionit, puthadorjes, dhunës, është të mosmenduarit për të ardhmen e vendit, të mosmenduarit për rininë,

për brezat. Na e latë atdheun pa rini dhe pa rini atdheu nuk ka kuptim. Na e latë atdheun vetëm me militantë të punësuar, por ky është përçudnim i atdheut, është një bastardim.

Populli, rinia studentore, të rinjtë, si forma kryesore e aftë për punë me ndryshim, nuk duan t'ia dinë si do të silleni ju me dekretin apo me dekretuesin, nuk duan t'ia dinë cilat ligje do të nxirrni ju kur atyre u mungon buka, puna, shkolla, ëndrra, dashuria, jeta. Erdhi koha e përplasjes mes jush për zotërimin e kolltukut, për zotërimin e tregut, për korrupsionin dhe vjedhjen e pamatë, për tradhtinë e madhe. Hajani kokën njëri-tjetrit, por Shqipërinë nuk do ta hani dot, sepse është shqiponjë me dy krena, një për të ngrënë kokat e atyre, që do t'ju shfaqen në derë për të marrë pjesën që ju keni shitur, dhe krena tjetër për t'ju ngrënë ju, faqezinjtë e kombit, ju, tradhtuesit e kombit. Hajani kokën njëri-tjetrit aty në kupolën, në strofkën e ujqërve, por Shqipërinë nuk do ta hani dot, sepse nuk ju lidh asgjë veç përfitimit, ndërsa për ne, që kemi dhe duam vetëm një atdhe, Shqipëria është gjithëka. Nuk ka në Shqipëri "Rroftë mbreti, poshtë mbreti!", por ka vetëm "Rroftë Shqipëria, rroftë kombi Shqiptar!".

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Papa!

Fjalën e ka ministri Majko.

Pandeli Majko – E nderuar kryetare e seancës,

Të nderuar deputetë,

Shqipëria po kalon një nga krizat më të rënda institucionale që nga miratimi i Kushtetutës në vitin 1998. Ky është një nga diskutimet më të vështira që kam mbajtur në këtë sallë të nderuar.

Sot dua të kontestoj në publik dikë me të cilin jam rritur në politikë. Dekreti i fundit i Presidentit të Republikës nuk mund të konsiderohet një shtyrje zgjedhjesh. Kërkesa për shtyrjen e zgjedhjeve 20 ditë para ditës së shpallur të zgjedhjeve është e paprecedentë. Dekreti, si i tillë, është kërkesë e mirëfilltë për të ndaluar procesin zgjedhor të nisur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Përpjekja e Presidentit nuk mund të dalë nga konteksti i krizës politike në vend. Ai ka arsyetuar se nuk mund të ketë zgjedhje kur një pjesë e opozitës nuk merr pjesë në to. Politikisht nuk e kontestoj, por juridikisht ky veprim i Presidentit do të kishte kuptim nëse

do të ndodhte më parë, në periudhën e regjistrimit të partive në zgjedhje. Presidenti ka ushtruar një të drejtë, të cilën nuk e gjen të shkruar në Kushtetutë. Çdo votues, që ka hedhur votën për të djathtën politike në Shqipëri, ka një anktë që duhet respektuar.

Errësira e vërtetë nuk është ajo që njohim, por bindja që krijohet se drita nuk do të vijë. Sot pak kush di të shpjegojë se si mund të plotësohen kërkesat e përfaqësuesve të opozitës, e cila ka dorëzuar mandatet e përfaqësimit në Kuvendin e Shqipërisë. Zgjedhjet lokale të 30 qershorit janë një detyrim dhe jo dëshirë e Partisë Socialiste. Opozita u largua nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimmarrjen e vet. Ajo e justifikoi këtë veprim me akuzën e manipulimit të zgjedhjeve politike të vitit 2017, afërsisht 2 vjet pas mbarimit të zgjedhjeve. Opozita kushtëzon negociatën politike me largimin e Partisë Socialiste nga qeverisja e vendit dhe krijimin e një qeverie transitore. Kuptimi i qeverisë transitore është dorëzimi i pushtetit në tavolinë. Aktualisht protesta e opozitës jashtëparlamentare është e një pale politike që di vetëm çfarë nuk do. Kriza politike nga bojkoti i zgjedhjeve lokale po zhvendoset në krizë të sistemit.

Kriza e krizës politike është se opozita aktualisht ka fokusuar politikën e saj me emrin e Edi Ramës. Në marrëdhënie me të opozita ka bërë një gabim. Ky është nënvlerësimi i tij. Ta trajtosh atë si një politikan të dështuar dhe të shpallësh se me të nuk hyn në zgjedhje, ka një kontradiktë domethënëse. Si rregull, përballë të dështuarit, fitohen zgjedhjet. Politikanët e opozitës nuk janë sot të mjaftueshëm me urrejtjen për Edi Ramën. Problemi qëndron me aftësinë e tij, i cili ua ktheu dialogun në dobësi.

Të nderuar kolegë,

Shqipëria rrezikon të bjerë në informalitet legal, në mungesë të zgjedhjeve. Teknikisht, zgjedhjet pa opozitën nuk mund të konsiderohen normale dhe ne rrezikojmë degradim në regjim. Kjo situatë, në fakt, nuk është produkt, por pasojë e vendimeve të opozitës jashtë Kuvendit. Ajo e vlerësoi bojkotin si mekanizëm për të shkuar në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme. Kriza aktuale është pasojë e një politike opozitare, që vepron sipas parimit "të gjitha ose asgjë". Ky është gabim i rëndë.

Arsyetimi se Shqipëria rrezikon një regjim antidemokratik, se sot nuk ka funksionale dy gjykatat kryesore të vendit, Kushtetuese dhe të Lartë, është e drejtë në atë pjesë që duket. Mungesa e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë është e përkohshme. Kjo situatë juridike erdhi nga vullneti i përbashkët i Kuvendit t'77 kaluar, i cili votoi unanimitisht ndryshimet kushtetuese për reformën në drejtësi. Reforma që u prodhua ishte sa strukturore, aq edhe dramatike. Ajo ka dhe do të ketë suportin e fortë të miqve tanë.

Të nderuar kolegë,

Partisë Socialiste i duhet të negociojë krizën aktuale edhe me trupën parlamentare, që ka hyrë në Kuvend nga listat zëvendësuese të opozitës. Çdo vendimmarrje në një republikë parlamentare duhet të kalojë nga votimi në Kuvendin e Shqipërisë. Sot politika, në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka mundësi legale të diskutojë si negociatë afatet e Kushtetues së Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet, por ky Kuvend ka të drejtë të ndryshojë Kushtetutën bazuar mbi këtë eksperiencë negative që po ndodh.

Grupi i opozitës në Kuvend duhet respektuar për propozimet e tij për ndryshimin e sistemit elektorale. Pavarësisht se janë deputetë të rinj, ata kanë të drejtë t'i japin historisë së këtij Kuvendi vendimet dhe vlerësimin publik për to. Dekreti i Presidentit duhet regjistruar si një akt jokushtetues dhe jam pro rezolutës së propozuar për këtë qëllim. Mendoj se Presidenti i Republikës ka gabuar. Ai ka krijuar një problem që vetëm ka pohuar krizën aktuale, por jo zgjedhjen e saj. Qëndrimi i Kuvendit sot ka rëndësi, pasi ne jemi republikë parlamentare dhe ai është institucioni më i lartë vendimmarrës. Ilir Meta është zgjedhur President nga Partia Socialiste. Ai është produkti ynë. Ky diskutim i sotëm është tregues i përgjegjësisë sonë ndaj publikut dhe vendit. Zgjedhja është te kutia e votimit dhe zbatimi i Kushtetutës. Nëse opozita do të fitonte te kutia e votimit, Partia Socialiste nuk ka pse të qëndrojë më në pushtet. Nga vota erdhëm, nga vota duhet të ikim.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Majko!

Fjalën e ka deputeti Ligoraq Karamelo. Të përgatitet deputeti Myslim Murri.

Ligoraq Karamelo – Zonja drejtues e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Zhdekretimi i datës 30 qershor, si datë kushtetuese e zgjedhjeve lokale, nga Presidenti i vendit, dëshmon intensifikimin e marrëzive që po shënon këtë vit jeta politike në vend. Ky veprim i paparë e i padëgjuar i Presidentit, që do të hyjë në histori si risi e devijimit flagrant nga detyrimi i zbatimit të Kushtetutës, për mendimin tim, nuk është i rastësishëm dhe i papritur. Nuk është i rastësishëm, sepse mënyra sesi është zgjedhur deri më sot Presidenti i Republikës nga Kuvendi në shumicën e rasteve është karakterizuar nga pazare politike, nga skenarë të përfolur, nga gjoja ruajtje të ekuilibrave politikë dhe për rrjedhojë tagri i personalitetit të tij është nëpërkëmbur dhe integriteti i postit më të lartë politik është përçmuar. Kjo maxhorancë ka një përgjegjësi të veçantë për zgjedhjen e Presidentit aktual dhe Kryeministri sot duhet t'i kishte kërkuar falje popullit për zgjedhjen e bërë, për shumë arsye, rrjedhojë e të cilave është edhe akti që nxiti këtë mocion. Ne me të drejtë sot flasim për shkelje të Kushtetutës, po sa pazare janë bërë nga Kryeministri e nga liderët e sotëm politikë në kurriz të Kushtetutës? Prandaj edhe sot kemi hendekun e thellë midis forcave politike dhe liderëve të tyre, nga njëra anë, dhe popullit, nga ana tjetër, të cilët e kanë humbur besimin te kjo klasë politike, pikërisht sepse ata mendojnë vetëm për pushtetin, për karriget e tyre dhe jo për problemet e hallet e njerëzve.

Veprimi i Presidentit nuk është i papritur, pasi ai nuk reagoi ashpër kur opozita dogji mandatet, nuk e përkrahu zëvendësimin e deputetëve nga listat, nuk e stimuloi atë, siç bëri komuniteti ndërkombëtar, nuk e dënoi bojkotimin e zgjedhjeve lokale, madje këtë Kuvend e quan “jofunksional”, dukuri që bie ndesh me parimet bazë të demokracisë. Pra, priti kohën e duhur për të sulmuar e siguruar gjahun e tij me kurthe e alibi, çka e ekspozon Presidentin tërësisht të njëanshëm.

Si mund ta etiketosh 30 qershorin për mungesë pluralizmi, kur askush nuk pengoi askënd të marrë pjesë në këto zgjedhje? Një filozof i lashtë grek, një nga etërit e demokracisë, ka thënë: “*I dimokratia ypostirizei ekeinous pou einai parontes*”, që do të thotë: “demokracia

mbështet ata që marrin pjesë, të tjerët i shpërfill”. Nuk mund ta shndërrosh dekretin e Presidentit në një lojë kungulleshkash për hatrin e qejfmbeturve politikë, ndaj Kushtetuta i shpreh qartë dhe i mbron fort rregullat e lojës politike. Si mund të thuash: “E zhdekretoj datën e zgjedhjeve për të ruajtur unitetin e popullit”, kur pas firmës së aktit demonstron simbole nacionaliste?! Zoti President, ke ofenduar minoritetin etnik grek dhe të gjitha minoritetet, që jetojnë në harmoni të plotë me shumicën. Me zhdekretim kërkon gjoja të shuash zjarrin e përplasjes civile, por në çast ndez zjarrin e urrejtjes etnike. Deklarove më tej, duke hedhur vellon patriotike, se “Do ta mbroj Kushtetutën me shqiptari”. Kushtetuta nuk mbrohet as me shqiptarizëm, as me helenizëm, as me amerikanizëm apo çdo izëm tjetër. Mbrojtja më e mirë dhe e vetme e Kushtetutës është zbatimi rigoroz i saj. Nëse ke plane të tjera për krijimin e institucioneve paralele, për mbivendosje datash zgjedhjesh, për stimulimin e anarkisë dhe zbehjen e reformës në drejtësi, bënë mirë të heqësh dore nga skenarë të tillë. Le të jetë kjo ...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Karamelo!

Fjalën e ka deputeti Myslim Murrizi. Të përgatitet ministria Besa Shahini.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Së pari, dua të sqaroj se nuk jam këtu për të bërë gjykatësin dhe të shpall Metën armik dhe as për të marrë përsipër rolin e avokatit dhe të bëj Metën viktimë apo hero për atë që ka bërë.

Së pari, dua të sqaroj qytetarët shqiptarë, që prej pesë ditësh mendojnë se kushedi çfarë po ndodh me rezolutën që u përgatit nga grupi i PS-së. Më lejoni të lexoj paragrafin përmbyllës të kësaj rezolute: “Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje Presidentit të Republikës të reflektojë duke e kthyer institucionin e Presidentit në kufijtë e kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe të mos ndërmarrë asnjë vendim tjetër në shkelje flagrante kushtetuese”. Kjo është përmbyllja e kësaj rezolute. Fjalë për fjalë, e përkthyer me atë që kemi parë gjatë 29 vjetëve të pluralizmit, nuk është as më shumë e as më pak se një farë fletërrufeje në emër të frontit ose një afat 24-48 orësh për Ilir Metën, siç i dha Byroja

Politike Mehmet Shehut para se të vriste veten. Nuk uroj të ndodhë akti i fundit me Presidentin e dalë nga kjo sallë me 71 vota të krahut të majtë, sepse krahu i djathtë ishte i dalë nga kjo sallë në vitin 2017.

E vërteta e hidhur e postkomunizmit në këta 29 vjet të politikës shqiptare, por kryesisht të elitave vendimmarrëse politike, ka qenë se këtë vend kurrë nuk e kanë qeverisur me ligje dhe me Kushtetutë, por me pazare të pista, të cilat kanë dashur t’jua paraqesin qytetarëve shqiptarë si marrëveshje. Kurrë nuk ka pasur marrëveshje për interes të qytetarëve shqiptarë, vetëm pazare në kurriz të tyre për të ndarë karriget që janë këtu pas dhe pas tyre taksat e qytetarëve shqiptarë, që këta këtu mbrapa kanë të drejtë të firmosin, të ndajnë për gjithsecilin nga ata që kanë pasur pushtet në këtë sallë. Ndarja e karrigeve të pushtetit është hall i madh edhe në këtë dekret të zhdekretimit të dekretit të datës 5 nëntor. Unë nuk e di pse është gjithë kjo sëkëlldi me ata që na dalin këtu e na bëjnë moral si antikomunistë, që e kanë kapërcyer 10 herë ylberin dhe me ata që mendojnë se do të fusin Metën në burg dhe ky është plumbi i fundit për armikun e pas kësaj Meta do të marrë fund. Kur Rama në këto tri javë i ka dërguar Bashës 7 letra mirëkuptimi, unë besoj se edhe Meta ka pasur të drejtë t’i dërgojë letër të atij lloj varianti Klement Zgurit. Fakti që në Kushtetutë nuk ka asnjë rresht që përmend fjalën “zhdekretim të dekretimit” quajeni si letër që i drejtohet Klement Zgurit. A e ka marrë në konsideratë Klementi? Aq sa ka marrë Basha 7 letrat e Ramës, ndaj nuk shoh se ka ndonjë qamet të madh rreth kësaj situate, e cila, më shumë sesa letra e firmosur nga Meta në emër të karriges së kryetarit të shtetit, shqetëson realisht klasën politike shqiptare.

Kur ju është dashur për të ndarë pushtetin dhe për të vjedhur taksat e qytetarëve shqiptarë, jeni marrë vesh aq mirë në këtë sallë sa ju kanë pasur zili edhe parlamente homologe të vendeve fqinje dhe të BE-së. E keni filluar në 91-shin kur bëtë qeveri mikse, komunistë të PS-së dhe komunistë të ardhur te PD-ja, pastaj u prishët, sepse diku cedoï pazari. E kemi parë në 97-ën me qeverinë që ia vumë emrin “pajtim kombëtar”. Kurrë kombi s’ka qenë i izoluar ndonjëherë përveçse politikanët u shitën përpara kombit si hipokritë sikur zemërohen fort, por

thjesht ngrenë pazarin e tyre të pistë për të marrë sa më shumë karrige pushteti dhe sa më shumë para nga paratë e taksapaguesve shqiptarë. Arritët te pazari i vitit 2002, kur në emër të zgjedhurve vutë President Alfred Moisiun. E shitët te shqiptarët si marrëveshje, se ikën nga puna Fatos Klosi dhe Arben Rakipi, pastaj erdhën dy zëvendësues të tjerë. Bëtë pazar në vitin 2007 pa pyetur për Kushtetutën që ishte miratuar vetëm nga ju në vitin 1998 me referendum, ku PD-ja nuk mori pjesë dhe qytetarët që ishin në mbështetës të saj nuk votuan.

Bëtë marrëveshje për të shtyrë çështjen e certifikatave, gjetët sebeb, sepse në 2007-ën Këshilli i Europës ju tha se që të hapet procesi i stabilizim-asocimit duhet të kalojnë 7 ligjet. Papritur, pasi u zemëruat në pamje të parë, pa kaluar dy muaj nga ai zemërimi për certifikatat, në këtë sallë, paratë e pazareve dhe takimet e dy apo tri individëve herë tek ura e Beshirit e herë tek ura e qafirit, u zgjodh një President që mori vota edhe këtej. Pse? Për hatër të asaj marrëveshjeje që gjithmonë është bërë nga 2-3 pronarë dhe padrino të politikës prej 29 vjetësh në këtë sallë. U zgjodh President Bamir Topi dhe nuk i kishte PD-ja votat.

Pastaj në muajin prill të vitit 2008 erdhët me pazarin, që realisht çfarë qelbi kemi parë në këto vite në tregun politik, është pasojë e plagës së 21 prillit të vitit 2008. Nuk u ndryshua Kushtetuta, por ishte atentat ndaj Kushtetutës, ishte sfumim i rolit të parlamentit, ku Presidenti i kthye në një kukull, dhe ai të cilin ju sot kërkon ta shpallni armik, ndërsa pjesa tjetër del rrugëve dhe e shpall hero, theu edhe vazot e luleve këtu. Ai ishte në greve urie, sepse nuk e pranoi atë ndryshim kushtetues. I erdhi koha pas 10 vjetësh. Halli ju solli që para dy vjetësh ju të zgjidhnit karrigen e Presidentit dhe ai që në vitin 2008 theu vazot e luleve, shkroi një letër për ta çuar deri në fund inatin e thyerjes së asaj vazoje lulesh. Në 2008-ën ka pasur të drejtë, edhe kur kërceu për të arritur tavolinën e zonjës Topalli, sepse ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 janë plane që e kanë shqetësuar realisht politikën shqiptare këta 11 vjet; kemi 11 vjet që qasemi teorikisht afër Europës dhe sa herë shkojmë në buzë të saj, do të shpiket se s'bën një sebeb që më vonë duhet të ketë pazare mbi kurrizin e qytetarëve shqiptarë dhe t'u shitet atyre si

konsensusi i madh për të shpëtuar kombin. Më thoni një marrëveshje të vetme që është bërë në interes të qytetarëve shqiptarë në këtë sallë për 29 vjet! Asnjë. Marrëveshjet është bërë sa herë që njëra palë e ka parë vetën ngushtë dhe i ka shtrirë për marrëveshje dorën palës tjetër jashtë kësaj salle dhe skutave.

Çfarë deklaroi Presidenti këto dy ditë? Deklaroi se ka takuar Ramën, Bashën, Berishën, kurse Monikën nuk ka nevojë ta thotë se e dimë që e takon çdo darkë. Në këta 13 vjet unë nuk di t'i keni lënë njëri-tjetrit "libër shtëpie" dhe familjarë pa përmendur në këtë foltore dhe nëpër konferenca shtypi. Në këtë situatë ku thoni se në datën 30 do të bëhet nami dhe do të vriten qytetarë, paskeni kaq relaks dhe qetësi sa të hani darka e dreka me njëri-tjetrin, duke ndenjur 1 ose 2 orë pasi keni përmendur "librin e shtëpisë" për të gjitha mëkatet që keni bërë në këta 29 vjet. Nuk e di sa të sinqertë jeni?! Te libri i shtëpisë apo te drekat e darkat që hani me njëri-tjetrin?

Unë e di mirë se pazaret që kërkon të bëni në kuadër të tensionimit të situatës në mënyrë artificiale janë hall i madh i përbashkët, janë halli i asaj reforme që nuk patët qejf ta votonit, as ju e as këta, por ju detyruan, ju thirrën një e nga një dhe ju kërcënuan se nuk do t'ju jepnin viza dhe votuan me pranga në duar edhe ata që lanë sallën, që erdhën këtu nga ndryshimet kushtetuese të vitit 2008, nga ligji bastard që ju e bëte qëllimisht për t'ua fshehur deputetin zgjedhësve. Kështu që sondazhet tregojnë se ka qytetarë që nuk e dinë se kë kanë deputet të zonës së vet. Është hera e parë në 29 vjet postkomunizëm që në këtë parlament votuan 140 deputetë njëzëri kur çifti i ambasadorëve puthej në lozhë.

Pas asaj u bëte pishman dhe do të gjenit 1001 arsye për të prishur atë pazar të detyruar, atë marrëveshje, për të cilën ju vunë litarin në fyt dhe jua futën të dyja këmbët në një këpucë për ta votuar. Pse? Se nuk ju pëlqente. Na thatë që do t'i bënit për 6 muaj vetëgënjim, reformën në drejtësi dhe se do t'i ngrinit shpejt organet në këmbë. Që atëherë kanë kaluar plot tre vjet dhe vendi sot është pa Gjykatën Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë, pa BKH, pa SPAK dhe o burra të gjeni një sebeb për mustaqet e Çelos, që ishallah ta prishim atë që u votua nën lakun e ambasadës amerikane dhe nga BE-ja me 140 vota, duke shpresuar të sillnit atë drejtësi ku një

palë dreqërisht të sjellin ca dreqër të tjerë këtu dhe të bëjmë atë dreq institucioni siç ka qenë, që, kur t'ju vijë radha për të shkuar, të shpëtoni si dreqër, siç keni shpëtuar në këta 29 vjet.

Këto ditë dëgjoj shpesh nëpër medie disa juristë të thonë që procedura shpëtoi Bashën, disa të tjerë që shpëtoi Metën, por se sa ka shpëtuar procedura nga ky krah në këta 29 vjet e dini ju, sepse në atë sistem drejtësie që prej vitit '97 me Fehmi Abdiun e deri më sot ish-hetues, ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë të regjimit komunist kanë qenë në majat më të larta të drejtësisë shqiptare.

Ndaj u bëj thirrje kolegëve, por më shumë qytetarëve, të mos e marrin seriozisht hallin e përbashkët që kanë të gjithë ata që i kanë grabitur për 29 vjet paratë e taksapaguesve shqiptarë në emër të pazareve të pista dhe që ua kanë shitur qytetarëve shqiptarë si marrëveshje. Nuk ka pasur kurrë marrëveshje.

Unë besoj se do të ketë prapë pazare, por nuk e di se çfarë dhe kujt ia kanë vënë syrin këtë herë për ta ndarë dhe shqyer si të uritur, që mos u ngopshin kurrë, se kanë 29 vjet që nuk dinë të ngopen, në këtë valë apo amulli, që kërkojnë të ngrenë, duke na thënë se këtu do të bëhet qameti, se do të vijnë serbët, rusët apo kinezët, se indianët erdhën dhe i pajisën me pasaporta diplomatike, madje i bënë edhe konsuj nderi.

Unë nuk besoj që edhe zoti Meta ta ketë seriozisht në atë dekret për zhdukimin e dekretit të parë. Në Kushtetutën e vitit 2008 ai ka thjesht rolin e arbitrit, por edhe arbitri me këtë teknologjinë e re e sheh VAR-in brenda një minute, unë nuk besoj që arbitri i këtij kombi ta shohë VAR-in pas 7 apo 8 muajsh dhe të anulojë atë që ka ndodhur në atë kohë. Po u krijua ky precedent, besoj se do të kenë të drejtën e Zotit si Nishani, Topi, Mejdani, ashtu dhe Moisiu t'i thonë: meqë je aty shiko edhe njëherë çfarë kemi bërë gabim në vitet që kemi qenë dhe futi të gjitha llumet, që të rrimë rehat, se mbase e drejta e drejtësisë mund të na kthehet të na shohë se çfarë kemi dhënë *offsite*.

Qytetarëve shqiptarë duhet t'u krijoni mundësinë me ligj, po të keni kurajë, po nuk e keni realisht frikë drejtësinë, siç kërkon ta shisni para shqiptarëve, pra hajdeni ta ndryshojmë Kushtetutën dhe të bëjmë një sistem zgjedhor që t'u hyjë në punë qytetarëve, me qëllim që në këtë sallë të mos hyjnë njerëz ilegalë, trafikantë, të

cilët i përzutë enkas me ligjin e dekriminalizimit nga kjo sallë, por të vijnë ata që votohen nga qytetarët shqiptarë.

Le t'i ndryshojmë edhe kompetencat që ka Presidenti, se vetëm jep dekorata dhe bën e zhbën dekrete, madje edhe amnistinë ia keni hequr. Po të keni realisht vullnetin dhe po të mos e keni frikë drejtësinë e re, të cilën po e trumbetoni me të madhe, unë besoj se konsensusin e 39 deputetëve këtej e keni, sepse secili prej tyre, jo unë, jua ka thënë nga kjo foltore, që kemi ardhur këtu për ta prishur këtë sistem, që ka sjellë tre bajraktarë që nga viti 2008, të cilët janë pronarë të 140 karrigeve, tre sekretarë të parë, Edi Ramën, Lulzim Bashën dhe Monika Kryemadhin.

Kjo sallë i përket sovranit dhe ejani ta ndryshojmë! Keni 123 vota në këtë sallë po të jetë se keni kurajën dhe dëshirën për ta ndryshuar Kushtetutën dhe ta vëmë dorën realisht në plagë. Gafa, atentati, pazari i pistë i 21 prillit të vitit 2008 është pasojë e të gjithë katrahurës, edhe e bilbilfryrësve të vitit 2011, edhe e çadrave verore të vitit 2010, edhe e çadrës së lirisë së vitit 2017, edhe e mbylljes së zyrës së Enver Hoxhës dhe daljes me pazar "më jep gjysmën e qeverisë, që të të kontrolloj ty, pastaj shohim e bëjmë".

Ndaj ju bëj thirrje ta merrni ashtu siç ju thoshte kur e kishit këtu "me qetësi dhe me dashuri" edhe letrën, që, në emër të karriges së kryetarit të shtetit, i ka dërguar Klementit, megjithëse Klementi u mërzi, nuk e lexoi letrën deri në fund dhe iku, edhe këtë gjyqin fletërrufe që kërkon t'i bëni, kohën që ia keni dhënë (jeni të mrekullueshëm në reflektim). Ishallah nuk ndodh ajo që ndodhi në 81-shin!

10 apo 15 mijë militantë që kërkojnë të zënë karriget e 10-15 mijë militantëve tuaj atje, janë ata që vijnë vërdallë duke thënë: "Do ta rrëzojmë më 16 janar ose më 16 shkurt, më 13 mars apo më 14 prill" dhe kanë 5 muaj rresht që nuk e di se si kanë kurajë ata që i marrin përsipër t'i gënjejnë çdo ditë, duke u thënë: "Hajdeni se do ta hedhim sot ose nesër". Se nga ku do ta hedhin nuk e di. Një të hedhur ka kjo elitë politike, me votën e qytetarëve shqiptarë, si për ne si për ju, si për ata që kanë 29 vjet këtu.

Le t'u japim mundësinë qytetarëve të votojnë dhe të dinë se kë zgjedhin. Po të keni këllqe dhe kurajë, bujrum, po nuk patët,

fletërrufe të Organizatës së Bashkimeve Profesionale apo të Byrosë Politike apo ku e di unë çfarë keni vendosur ju për t'i dhënë kohë Mehmetit se çfarë do të bëjë, janë letra bakalli njëlloj si zhdekretimi i dekretit të datës 5 nëntor.

Mendoj se qytetarët na e kanë pirë lëngun prej vitesh, pasi e shohin që ne nuk kemi ardhur në këtë sallë nga vota e qytetarëve.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Murrizi!

Fjalën e ka ministrja, Besa Shahini.

Të përgatitet deputeti Ervis Meço dhe më pas ministrja Belinda Balluku.

Të nderuar kolegë, kjo është lista e diskutantëve, ju lutem, zini vendet se do të kalojmë në votim!

Faleminderit!

Besa Shahini – Kohët e fundit kam kaluar shumë kohë nëpër shkolla dhe universitete, me nxënës që ndjekin maturën, me mësues që merren me portalin “Mësues për Shqipërinë”, me studentë që po përgatiten për provimet e semestrit dhe të gjithë, pa përjashtim, janë të paafektuar nga drama e opozitës jashtëparlamentare në Shqipëri. Kjo më bën përshtypje, sepse jashtë Shqipërisë, në kryeqytetet që do të vendosin për të ardhmen europiane të Shqipërisë, fotografitë e dhunës së shfrenuar të opozitës kanë krijuar përshtypjen se Shqipëria po kalon një krizë politike e sociale dhe është në prag të ndonjë lufte civile. Ka vendimmarrës ksenofobë atje që mendojnë se shqiptarët duhen mbajtur larg BE-së dhe ata po ushqehen nga imazhet e stisura të opozitës. Opozita shqiptare joparlamentare do të ishte e pakonceptueshme në një realitet normal. Studentët protestuan në dhjetor dhe një opozitë normale do t'u dilte krah në betejën e tyre për transformimin e universitetit. Por, jo, ish-deputetët opozitarë vendosën të bëjnë të paimagjinueshmen, u vetëpërgjashtuan nga parlamenti, që të mos përfaqësojnë as votuesit e tyre e jo më studentët. U vetëpërgjashtuan nga zgjedhjet lokale dhe Presidenti iu bashkëngjiti, duke shpikur çdo dekret për zgjedhje, duke nënvizuar se ai i takon grupit të politikëbërësve, të cilët refuzojnë të respektojnë institucionet e shtetit dhe i trajtojnë ato si vegla fleksibile në shërbim të interesave të veta të ngushta. Dhe është pikërisht ky mosrespekt ndaj institucioneve, që e ka mbajtur Shqipërinë

kokëfortësisht në tranzicion dhe pikërisht këtë mosrespekt duhet ta luftojmë pa mëshirë.

Sot nuk mund të rrija anash, të merresha me reformën në arsim teksa Presidenti i shtetit, me vendime antikushetuese, të bashkërenduara me dhunën huligane në rrugët e Tiranës, cenon mirëfunksionim e institucioneve dhe rrezikon të ardhmen e brezave që po përpiqemi t'i mirarsimojmë. Nuk mund të rrija anash teksa përpjekja jonë për t'u ofruar fëmijëve shkollat që meritojnë po përballet me përpjekjen e opozitës për t'i nxjerrë këta fëmijë në rrugë, duke i keqpërdorur e traumatizuar nën tymin e bombave “Molotov”. Nuk mund të rri indiferente teksa shoh tentimet për të suspenduar zgjedhjet e lira dhe demokracinë. Sot nuk kemi të bëjmë me një përplasje të zakonshme mes maxhorancës dhe opozitës, sot përplasjet Shqipëria e re e reformuar me Shqipërinë e vjetër jodemokratike dhe është bërë e qartë që e vjetra po synon të kthehet me dhunë, pikërisht pse me paqe nuk ka shans të kthehet.

E përmendëm '97-n këto ditë, sepse gjuha shkon aty ku dhemb dhëmbi. Po, ata e kanë shkaktuar '97-n dhe nuk mbajtën përgjegjësinë që duhej për këtë. Unë isha 15 vjeçe atëherë, e rritur nën tryshninë e represionit jugosllav fillimisht e pastaj atij serb. Si të gjithë fëmijët e tjerë rreth meje, shikonim nga Shqipëria për ndihmë dhe përkrahje, por pafundësisht të mërzhitur dhe zemërthyer për përçarjen, keqkeqverisjen dhe dhunën që ndodhte këtu në kohën kur Shqipëria i duhej Kosovës e fortë dhe stabile, në kohën kur shqiptarët në Ballkan për herë të parë kishin rastin që, të bashkuar, të thoshin fjalën e tyre e të ndërtonin një të ardhme më të përbashkët më të mirë.

Sot jemi 22 vjet nga '97-ta dhe Kosovës prapë i duhet Shqipëria, sepse edhe sot si atëherë po përcaktohet e ardhmja e shqiptarëve në rajon, por, fatkeqësisht, edhe sot si atëherë po të njëjtët njerëz përçojnë mesazhe jo stabiliteti dhe tërheqin vëmendjen nga ngjarje të rëndësishme në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Unë nuk jam përfaqësuese në parlament, ndaj po ju drejtohem juve që të mos tërhiqeni para shkelësve të Kushtetutës, të votoni rezolutën që keni para dhe të vijojmë bashkërisht drejt zgjedhjeve të 30 qershorit.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shahini!

Fjalën e ka deputeti Meço.

Ervis Meço – Jemi përballë një refreni të frikshëm. Zgjedhje apo vëllavrasje, do të fitojë Shqipëria apo partitë?

Të dashur qytetarë,

Ky precedent, që ka kapluar vendin, nuk është gjë tjetër veçse një ankand zbavitës, i mbajtur në fuqi nga tre frone: presidencë, parlament dhe opozita e bashkuar. Kjo tragjikomedi më kujton historinë biblike ku Jezu Krishti i djeshëm i ngjan sot sovranit, të cilin e ka sfilltur katërçipërisht kjo klasë politike në 28 vjet.

Pyetja që natyrshëm lind është se kush është sot Ponc Pilati? Po mbreti Herod? Po farisenjtë ligjvënës fanatikë, që janë partizanë të së drejtës dhe së vërtetës së madhe? Pse vallë ky ankand, të nderuar deputetë?

Nervozizmi nuk është gjë tjetër veçse një kënaqësi egoiste dhe një tatëpjetë e frikshme karakteriale. Kur dhe cili nga tre fronet mbretërore do të kryqëzojë sot e në vijim Shqipërinë tonë të dashur?

Në emër të dinjitetit njerëzor, në emër të Shqipërisë, në sajë të çeljes së negociatave, kur do të mbyllet ky ankand i paprecedentë? Cila do të jetë fatura e Shqipërisë së Ismail Qemalit, të Sulejman Delvinës, e Shqipërisë së rilindësve, e dinjitetit kombëtar dhe aspiratës rinore të vendit?

Të nderuar deputetë, reflektoni! Shqipëria dhe e drejta për të votuar nuk janë *video game* i askujt.

Ju ftoj të jemi pro Kushtetutës, pro zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, pro qytetarit, pro ambasadës amerikane, pro OSBE-ODIHR-it dhe të gjithë partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilët na shikojnë në çdo detaj dhe lëvizje tonën për të arritur pjekurinë politike të këtij vendi. Le të ecim në sinkronë me rregullat e shenjta të një demokracie solide dhe jo hibride.

Në mbyllje të fjalës sime, kam një thirrje: zoti President, zoti Kryeministër, zoti kryetar i opozitës së bashkuar, vijojeni në komoditetin tuaj mbretërinë, por mos e kryqëzoni Shqipërinë. Ky popull meriton më shumë se kurrë të hyjë në Bashkimin Europian. Mos u bëni pengesë për dinjitetin tonë kombëtar!

Zoti ju ndriçoftë drejt rrugës së konsensusit!

Zoti e bekoftë Shqipërinë!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Meço!

Fjalën e ka ministrja Belinda Balluku.

Belinda Balluku – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Ministrave,

Seanca e sotme parlamentare dhe debati që po zhvillojmë, vijnë në një moment të veçantë dhe historik për vendin, për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe realizimin e ëndrrës së kahershme të qytetarëve shqiptarë, që është integrimi i vendit në familjen e madhe europiane. Sapo kemi marrë rekomandimin pa kushte të Komisionit Europian për çeljen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ky rekomandim vjen si rezultat i një punë të gjatë dhe shumë të vështirë për të plotësuar kriteret dhe detyrat e dhëna nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Reforma në drejtësi, një nga reformat më të thella në rajon, por edhe më gjerë në Europë, ka nisur të japë rezultatet e para dhe, pas ngritjes së organeve të reja të drejtësisë, tashmë jemi në prag të ngritjes së Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale, që do të hetojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar deri në nivelet e larta të administratës dhe politikës. Këto rezultate, përveçse janë përcjellë me entuziazëm të madh nga partnerët tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian, janë pritur me shumë vlerësim nga ana e qytetarëve shqiptarë, të cilët prej dekadash kanë vuajtur mungesën e një sistemi drejtësie të pavarur, efikas dhe të pakorruptuar.

Reformat shtetformuese të ndërmarra në vitet e para të mandatit tonë qeverisës, pavarësisht vështirësive të para në implementimin e tyre, tashmë janë në rrugë të mbarë dhe po prodhojnë rezultate të prekshme për qytetarët, veçanërisht në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike për ta.

Në fushën e infrastrukturës një sërë veprash të rëndësishme, si Rruga e Arbrit apo bajpaset tjera, që janë drejt përfundimit, po ecin me ritme të shpejta dhe parashikohet të përfundojnë para afateve të caktuara. Ndërkohë, disa vepra mjaft komplekse, të lëna në mes nga ish-qeveritë e

mëparshme, janë gati për t'u përfunduar dhe për t'u dorëzuar qytetarëve.

Zhvillimet e tjera shumë pozitive, pothuajse në të gjitha fushat, janë të shumta dhe nuk dua të ndalem për t'i renditur. Pikërisht në këtë situatë shumë të favorshme për zhvillimin e vendit dhe procesin e integritetit evropian, kur të gjithë sytë e Europës janë drejtuar nga ne dhe presin hapat e tjerë vendimtarë të konsolidimit të shtetit demokratik, ne rikthehemi para një situatë që i ngjan një *deja vu-je*, e cila përsëritet sa herë që opozitën e zgjon nga gjumi data e zgjedhjeve. Këtë situatë e përjetuam para 2 vjetësh, por ajo është rikthyer tashmë edhe më e dhunshme, jo në kuptimin figurativ të fjalës, por në atë fizik, me veprime ekstreme, siç ishte djegia e mandateve parlamentare dhe protesta, të cilat qartësisht tejkalojnë të gjitha caqet e protestave paqësore dhe të ligjshme, që ne në Partinë Socialiste i njohim shumë mirë se si bëhen. Si për të mos mjaftuar e gjithë kjo rrëmujë, që po përpiket të shkaktojë kjo opozitë tekanjoze, tashmë joparlamentare, dhe balta që po i hedh imazhit të vendit, në këtë vorbull paligjshmërie po shihet ai, që duhej të ishte mbrojtësi i kushtetutës dhe i ligjit, përfaqësuesi i unitetit të kombit: institucioni i Presidentit.

Në një akt të paprecedentë Presidenti u heq të drejtën legjitime qytetarëve të zgjedhin drejtuesit e tyre të pushtetit vendor thjesht se opozita "rrugore" ka frikë të shkojë në zgjedhje dhe kërkon pushtet në tavolinë. Në 30 vjet sistem demokratik Shqipëria ka pasur presidentë të zgjedhur dhe të lidhur fort me partitë respektive, por, pavarësisht qëndrimeve, shpeshherë të diskutueshme dhe të njëanshme, asnjë prej tyre nuk ka marrë vendimin t'u mohojë shtetasve të tij të drejtën e votës së lirë, për të cilën aq shumë shqiptarë kanë sakrifikuar, madje kanë dhënë edhe jetën. Për fatin e mirë, Shqipëria nuk është një republikë presidenciale dhe, si e tillë, nuk ka asnjë pasojë juridike dhe ligjore. Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor nuk ia njohin Presidentit të drejtën për të anuluar zgjedhjet, rrjedhimisht dekreti për zhdukimin e zgjedhjeve nuk mund të prodhojë pasojë ligjore.

Shqiptarët janë në të drejtën legjitime që t'i zgjedhin me votë të lirë përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor, ndërsa qeveria dhe institucionet kushtetuese kanë detyrimin t'u garantojnë qytetarëve këtë të drejtë themelore

dhe ne do të bëjmë pikërisht atë, që kanë të drejtë dhe dëshirojnë shqiptarët. Zgjedhjet e pushtetit vendor do të zhvillohen, ashtu siç e parashikon ligji, më 30 qershor dhe shqiptarët do të jenë dëshmitarë të një procesi model.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Balluku!

Këtu përfundon lista e diskutantëve dhe mbyllet debati lidhur me projektrezolutën.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Uluni, se do t'jua jap fjalën!

Grupet parlamentare dhe deputetët të bëhen gati për votim.

Urdhëroni!

Për çfarë do të flasësh?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zotëri, këtu u mbyll debati!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Nuk e ndërpres unë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Nuk jam unë i zoti i kësaj pune.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zoti deputet, ky është një debat, i cili është përcaktuar me kohë. Koha është përcaktuar nga vetë grupet parlamentare dhe emrat e diskutantëve regjistruan 2 orë para se të fillojë seanca, pra këto janë rregullat dhe nuk i vendos unë. Tani është fiksuar të zhvillohen 5 orë debat; u regjistruan emrat me kohën përkatëse, sipas Rregullores. Debati përfundoi. Kështu që mësoni rregullin, lexojeni nenin përkatës dhe...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Si propagandë?! Kjo nuk është propagandë!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ore, ti mund të jesh shumë i madh, por nuk i di rregullat e parlamentit. Mësojini rregullat e parlamentit!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Unë nuk kam asnjë problem, problemi është yti, i dashur!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zotërinj kryetarë të grupeve, kur jeni gati për votim?

Bëhuni gati për votim!

Bëjmë 5 minuta pushim.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 QERSHOR 2019

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi - Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë 108 deputetë prezentë.

Fillojmë votimin e projektrezolutës “Mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10 928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores.

Projektrezoluta kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim. Projektrezolutën e keni të gjithë mbi tavolinat e punës.

Procedura e votimit është një votim me elektronikë, votim i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 100 vota pro, 7 kundër, 2 abstenim. 1 deputet nuk ka marrë pjesë në votim.

Miratohet projektrezoluta.

Mbyllem këtu seancën e ditës së sotme.

Seanca tjetër do të jetë ditën e hënë në orën 10:00.

(Seanca u mbyll në orën 16:30.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**